


RAPORT VLERËSIMI TË NDIKIMIT NË MJEDIS



**Furnizimi me uje i plazheve Durres-Kavaje nga
pushpimet e Çermes, Loti I**

ECA
STUDIO MJEDISORE

ECA Studio Mjedisore
Rr. "Kajo Karafili", Pall. Bimbashi 8/2
Shk.2, Ap. 2B, Kati II-te, Tirane - Albania
Tel & Fax: 042 23 20 98
e-mail: eca.studio@yahoo.com

TIRANE 2015



Furnizimi me uje i plazheve Durres-Kavaje nga pusshpimet e Çermes, Loti I, Dublimi i pusshpimeve ekzistuese, rikonstruksion i stacionit qendror dhe ndertim i rezervuarit 1000 m³, linjat e ujesjellesit pusshpime-stacion qendror, linjat e ujesjellesit stacion qendror deri ne Rrogozhine Pik 426, rikonstruksion i linjave elektrike

Korrik, 2015

PREGATITI:

ECA STUDIO MJEDISORE
Rr."Kajo Karafili", Pall. Bimbashi 8/2
Shk.2, Kati II-te, Tirane

Tel & Fax: 042 23 20 98
e-mail: eca.studio@yahoo.com
arben_lici@yahoo.com



TE DHENAT KRYESORE TE PROJEKTIT

Investitori:

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve

Zbatues i punimeve:

J.V. "CURRI" Sh.p.k. & "GECI" Sh.p.k.

Emertimi: Furnizimi me uje i plazheve Durres-Kavaje nga pusshpimet e Çermes, Loti I, Dublimi i pusshpimeve ekzistuese, rikonstrukcion i stacionit qendror dhe ndertim i rezervuarit 1000 m³, linjat e ujesjellesit pusshpime-stacion qendror, linjat e ujesjellesit stacion qendror deri ne Rogozhine Pik 426, rikonstrukcion i linjave elektrike

Vendndodhja: Plazhi Durres, Plazhi Golem, Shkozet, Kavajë, Rogozhinë

Elementet përbëres:

- 1. Hapja e puseve te reja $\Phi 508\text{mm}$, H=44ml**
- 2. Rikonstrukcion i stacionit prane pusit 282**
- 3. Stacione te reja prane puseve 281, 283, 284, 285**
- 4. Linjat per grumbullimin e ujit te puseve prane stacionit qendror**
- 5. Rikonstrukcion i stacionit qendror ekzistues**

6. Ndertim i nje depoje te re 1000m³ prane stacionit qendror
7. Linja e ujesjellesit nga stacioni qendror deri ne takim me Lotin 2, me gjatesi 1592 ml
8. Ndertim i pasareles per kalimin e lumit shkumbin 80ml
9. Linja e degezimit nga loti 3 per ne depon e re e Maskuri 996ml tub gize sferoidale
10. Ndertim i depos se re 4000m³ Maskuri (2*2000m³)
11. Lidhja e depos Maskuri me rrjetin ekzistues ne kete zone L352 ml, tub gize D 500mm

Kapaciteti:

- Projekti siguron nje furnizim me uje 250 l/sek
- Per qytetin e Kavajes furnizimi do te jete 80 l/sek
- Per Plazhin e Durresit furnizimi do te jete 170 l/sek

Kodi veprimtarise:

- Ligji Nr.10440, date 07.07.2011 "Per VNM-en", i ndyshuar Shtojca II – Projekte qe i nenshtohen procedures Paraprake te VNM-es

Pika 10-g) – Instalime te kanaleve ujites/akuadoteve ne distanca te largeta

Pika 10-h) – Nxjerrja e ujitnentesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujerave nentesore qe nuk jane perfshire ne shtojcen I.

1. HYRJE

Uji ka një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe sigurimi i tij është kthyer në një nga sfidat më të mëdha botërore. Ai nënkupton pastërti, energji, por mbi të gjitha, dicka të sigurt për të pirë. Sipas shifrave, është vlerësuar se rreth 2.6 miliardë njerëz në botë nuk kanë ujë higjienik dhe rreth 900 milionë të tjerë nuk konsumojnë ujë të sigurt. Sipas OBSH-së, 88% e sëmundjeve të diarresë shkaktohen nga konsumimi i këtij lloj uji. Gjithmonë uji ka qenë faktor vendimtar në zhvendosjen e popullsive nga një vend në një tjetër, sepse ai është kushti themelor për një jetë të sigurt e të shëndetshme.

Nga ky këndvështrim, Shqipëria mund të quhet një vend i bekuar. Për sasinë e burimeve që gëzojnë, qytetarët e Shqipërisë duhet të ishin të fundit që t'i mbanin sytë nga ora e të kontrollonin çezmën nëse kanë apo jo ujë. E megjithatë, ende një pjese të mirë të popullatës nuk i ofrohet shërbimi i ujit, ndërkohë që edhe më fatlumët janë subjekt i ardhjes së ujit sipas orareve të caktuara.

Më shumë se 70% e trupit tonë përbëhet nga uji, dhe ai është i një rëndësie jetike për të gjitha format e jetës. Ai vë në punë motorin e trupit tonë dhe për këtë arsye jeta jonë është ngushtësisht e lidhur me praninë e tij. Uji mbulon 70% të sipërfaqes së tokës, por vetëm 0.03% e tij është në dispozicion për njeriu.

Shqipëria ka burime të shumta natyrore të njohura për ujin e tyre të pastër dhe të shëndetshëm, që gjenden si në zonat veriore dhe ato jugore. Duhet përmendur që pak prej këtyre burimeve arrijnë të përdoren nga popullsia e qyteteve të mëdha dhe akoma më pak nga zonat rurale. Sasira të mëdha uji shkojnë dëm si psh. uji në Syrin e Kaltër, Bisticës, të cilët derdhen në det. Gryka e Kërlycyrës ka me dhjetëra burime natyrore uji që derdhen në lumin e Vjosës dhe vetë Vjosa derdhet në det. Burimet më të njohura të ujit janë në zonën e Thethit (në veri të Shqipërisë), Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet dhe në malin e Dajtit.

Statistikat europiane për ujin e vendosin Shqipërinë përkras vendeve kryesore të pasura me burime natyrore dhe i vlerësojnë ato si dhurata jonë më e çmuar natyrore. Mungesa e një menaxhimi dhe trajtimi të mirë të ujit shkakton probleme serioze në furnizimin e popullsisë dhe ndotje masive të ujit.

Problemi i mosfurnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm në disa zona të kryeqytetit, madje edhe në disa qytete të tjera është mjaft aktual. Megjithëse janë kryer përpjekje për përmirësimin e kësaj situatë, ato janë me rendiment mjaft të ulët dhe ndryshimi është mjaft i largët. Analiza të vazhdueshme të ujit të pishëm, të ujit të rubinetit, apo të deteve kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik, dhe rezultateve i duhet kushtuar vëmendje e veçantë si psh nivelit të klorit të pranishëm, nivelit të botës mikrobike, të lëndëve toksike etj. Këto rezultate duhet të jenë brenda parametrave të lejuara dhe të përcaktuara nga OBSH dhe Komuniteti Europian. Nuk janë të pakta rastet ku uji, jo vetëm ai i pijshëm por dhe ai në dete, ka qenë shkak i epidemisë. Kështu që këshillohet që paraprakisht të zjehet uji i pijshëm dhe të vizitohen ato plazhe ku rezultatet e analizave kanë qenë brënda normave të lejuara. Asnjë nuk ka më siguri jo vetëm për ujin e rubinetave, por as për ujin e ambalazhuar, pasi një pjesë e subjekteve që tregtojnë ujë të pijshëm punon jashtë standarteve të përcaktuara

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, burimet e tona natyrore të ujit janë një pasuri kombëtare, kështu që do të ishte e përshtatshme të kryheshin përpjekje për një menaxhim dhe trajtim të mirë të tij. Kjo do të ishte një mënyrë e mirë për të zvogëluar mungesën e furnizimit me ujë në shumë familje shqiptare dhe për t'i dhënë fund kësaj situatë ironike. Alarmi i reduktimit të burimeve të ujit në dispozicion për njeriun është në rritje gjithmonë e më shumë, kështu që ne duhet të rrisim ndërgjegjësimin tonë për situatën e tanishme të tij.

Ambalazhimi dhe tregtia e ujit është një sektor, ku sipërmarrësit në garë janë shumëfishuar në vetëm pak vite, ndërsa rritja e kërkesës konsumatore ka nivele të ulëta dhe mundësia për eksport e ujit shqiptar është shumë e pakët.

Vitin e kaluar, për prodhimin, ambalazhimin dhe tregtimin e ujit mineral numëroheshin rreth 60 stabilimente të licencuara, ndërsa pesë vite më parë, numri i tyre ishte më pak se 30. Për të njëjtën kohë, konsumi në treg është rritur në masën 50%, sipas të dhënave të prodhimit dhe tregtisë së jashtme.

Por, ndërsa tregu shqiptar po duket gjithnjë e më i vogël për kompanitë që operojnë në këtë sektor, shumë pak prej tyre kanë hedhur sytë nga eksporti, pasi janë pothuajse të sigurt që nuk janë konkurrues në tregjet e huaja, për shkak të kostos së lartë të prodhimit dhe transportit. Pengesë për eksportin është edhe mungesa e unifikimit të standardit të cilësisë së sigurimit ushqimor me tregun e Bashkimit Europian. Deri më tani, hapat e ndërmarrë nga qeveria shqiptare janë për përafrimin e standardeve të cilësisë në këtë sektor, por sipas operatorëve më të mëdhenj në treg, nevojitet vendosja e standardeve të njëjta.

Por vështirësitë e konkurrencës gjenden mbi të gjitha në tregun e brendshëm. Investitorët kryesorë në prodhimin e tregtimin e ujit mineral ankohen për mungesën e një konkurrence të drejtë në treg. Sipas tyre, problem mbetet marrja e ujit në burime jo të autorizuara dhe nxjerrja e produkteve të palicencuara.

2. Qellimi e objektivat e VNM dhe konteksti ligjor

2.1 Qellimi dhe objektivat e VNM

Qellimi kryesor i VNM eshte te percaktoje dhe vleresojte ndikimet qe do te kete ne mjedis veprimtarite e propozuara per trajtimin e mbetjeve spitalore infektive qe gjenerohen nga veprimtarite e saj e sallat operatore dhe nga ambientet ku ofrohet ky sherbim dhe dezinfektimi i tyre, per te informuar dhe ndihmuar vendimarrjesit dhe zhvilluesin e projektit ne marrjen e vendimeve perkatese.

Ky Vleresim i Ndikimit ne Mjedis (VNM) eshte financuar nga bashkimi i operatoreve ekonomike "CURRI" Sh.p.k. dhe "GECI" Sh.p.k., dhe hartohet ne perputhje me kerkesat e lgjislacionit shqiptar dhe direktivat e Bashkimit European per Vleresimin Mjedisor.

Ligji Nr.10431, date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", parashtrohet aspektet me te rendesishme ligjore per mbrojtjen dhe ndikimin ne mjedis. Ky ligj eshte plotesuar me ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" i cili sistemon vleresimet e ndikimit ne mjedis. Kerkesat e ketyre dy ligjeve si dhe parimet e kompanive "CURRI" Sh.p.k. dhe "GECI" Sh.p.k.,, per shendetin, mjedisin dhe sigurine ne pune jane marre ne konsiderate ne kete VNM.

Ky raport i VNM e pajis shoqerine me nje instrument menaxherial per te zbatuar ne kryerjen e punimeve te parashikuara, te gjitha kerkesat ndaj mjedisit per te minimizuar ndikimet mbetese ne mjedis, individe dhe ne komunitet ne zonen ku do te zbatohet projekti i furnizimit me uje te zoneve te Plazhir Durres dhe Qytetit te Kavajes.

Ky raport paraqet nje pershkrim te projektit, gjendjen egzistuese te mjedisit dhe jep nje vleresim te ndikimit. Ne perfundim te projektit do te behet vleresimi i pajtuesmerise me Planin e Menxhimit Mjedisor (PMM) e nese do te jete e nevojshme per vleresime shtese dhe veprime te metejshme per zvogelimin e ndikimit.

2.2 Qellimi i Raportit te VNM

Vleresimi Ndikimit ne Mjedis eshte nje proces sistematik qe synon te siguroje se jane identifikuar dhe jane marre ne konsiderate te gjitha pasojat mjedisore dhe social-ekonomike te zhvillimit te propozimeve per aktivitetin, si gjate fazes se përgatitjes se tij dhe pas zbatimit.

Synimi kryesor i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikohen ndërthurjet e mundshme të projektit me mjedisin fizik e social dhe me politikat e mbrojtjes së mjedisit për zonat ku do të zhvillohet aktiviteti. Më konkretisht, ky dokument ka për qëllim:

- Të evidentojë pikëprerjet dhe bashkërendimin e aktivitetit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Të përshkruajë vlerat natyrore dhe mjedisore në zonën ku do të zhvillohet aktiviteti dhe të identifikojë statusin mbrojtës të saj;
- Të identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime;
- Të lehtësojë vendimmarrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin
- Te kontribuojë ne nje permiresimin e menaxhimit te ndikimeve ne mjedisi duke perfshire publikun dhe aktoret e tjere vendimmarres;
- Te identifikojë kufizimet, mundesite dhe resurset cilat do te influencojne mbi menyren se si duhet te hartohen propozimet per zhvillimin e ketij projekti
- Te fokusojë problemet mjedisore si kyce per planifikimin e zhvillimit e projektit duke promovuar kuptimin me mire te marrëdhënieve ndërmjet masave për mbrojtjen dhe infrastruktures specifike si dhe mjedisit dhe komunitetit përreth.
- Te harmonizojë ndikimet dhe perfitimet, pra efektet e kombinuara te propozimeve te ndryshme per zhvillimin e veprimtarise se propozuara me veprimtarite ekzistuese.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje vleresim i ndikimeve te mundshme-pozitive ose negative-qe nje projekt apo aktivitet mund te kete mbi mjedisin; perfshire aspektet natyrore, sociale dhe ekonomike. Qellimi I ketij vleresimi eshte te siguroje qe vendimmarresit marrin ne konsiderate ndikimet ne mjedis perpara se te miratojne projektin. Vleresimi I ndikimit ne mjedis ne Shqiperi bazohet ne ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis".

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat:

- për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit ose veprimtarisë në mjedisin ku do të zbatohen;
- për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti, të propozuar në variante të tjera, të mundshme, që përmbajnë ndryshime:
 - a) në vendin ku do të zbatohet projekti;
 - b) në përmasat dhe kapacitetet e tij;
 - c) në teknologji;
 - d) në krahasimet me gjendjen e mjedisit, nëse nuk do të zbatohet projekti;
 - e) në përcaktimin e masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis
- për të siguruar shqyrtim cilësor teknik, profesional, juridik dhe administrativ të kërkesës dhe të marrjes së vendimit nga organet përkatëse
- Autoriteti përgjegjës për dhenien e lejes mjedisore bazuar ne raportin te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte Ministria e Mjedisit, me Agjencine Kombetare te Mjedisit

2.3 Legjislacioni Shqiptar per mjedisin dhe politikat e Ministrise se Mjedisit

Shqiperia, ka nje kuader ligjor mjedisor qe gradualisht eshte duke u pershtatur legjislacionit te Bashkimit European. Gjithashtu, Shqiperia, ka ngritur dhe ka organizmat dhe institucionet kombetare qe hartojne dhe zbatojne politikat mjedisore.

Idea e ndarjes se pergjegjesive per administrimin e mjedisit, eshte e misheluar ne Kushtetute, e cila percakton tre objektiva ne lidhje me qendrueshmerine:

- nje mjedis te shendetshem dhe te pershtashem nga ana ekologjike per brezat e tashem dhe te ardhshem; (neni 59.1 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise)
- shfrytezim racional te pyjeve, ujerave, kullotave dhe burimeve te tjera natyrore, bazuar ne parimin e zhvillimit te qendrueshem; (neni 59.1 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise)
- cdokush ka te drejten te jete i informuar ne lidhje me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij (neni 56 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise)

Nje pjese e madhe e legjislacionit, perfshi Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit, eshte pershtatur tashme, per te ndihmuar ne arritjen e ketyre objektivave. Institucionet jane organizuar ose po organizohen per te zbatuar, monitoruar dhe zbatuar ligjet, por ka ende nje rruge te gjate per te bere, drejt arritjes se qendrueshmerise

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) u krijua si ristrukturim i Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve ne mbeshtetje, te ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e Mjedisit" dhe VKM-se nr 47, date 29.01.2014 "Per Percaktimin e Rregullave per Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencise Kombetare te Mjedisit e te Agjencive Rajonale te Mjedisit". Agjencia Kombetare e Mjedisit eshte nje institucion qendror publik ne varesi te ministrit, qe ushtron juridiksionin e vet ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore te AKM dhe degëve rajonale në qarqe, te cilat jane Drejtorite Rajonale të Mjedisit. Ne mbeshtetje te Urdherit te Kryeministrit Nr.55 date 13.02.2014 eshte miratuar struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të Drejtorive Rajonale te Mjedisit te cilat jane ne varesi te AKM.

2.4 Dokumentet kryesore strategjike ne fushen e mjedisit

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2007, është dokumenti bazë që parashton politikën shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi përfundimtar i hartimit, miratimit dhe zbatimit të tij është plotësimi i detyrimit kushtetues ndaj shtetasve që gëzojnë të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik, zhvillimit të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet përdorimit racional të pasurive natyrore, ruajtjes së tyre nga ndotja dhe degradimi, si dhe promovimit të vlerave mjedisore për t'i kthyer ato në asete të rëndësishme të rritjes së mëtejshme ekonomike të vëndit.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) është pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo duhet parë në kontekstin e politikës kombëtare. Shumë nga politikat dhe masat e kësaj strategjie, mbështeten nga programet dhe veprimet të përcaktuara në strategjitë ndërsektoriale, siç janë turizmi, energjia dhe bujqësia etj.

Mjedisi si sektor kërkoi hartimin e një strategjie "ndërsektoriale". Kuadri ndërsektorial afron një trajtim modern dhe të integruar të sektorit mjedisor dhe sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj. Ky konceptim pranon vendosmërisht përgjegjësinë e ndarë

midis shumë institucioneve qeverisëse, të nivelit qendror apo vëndor, për mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të vëndit.

Strategji Ndersektoriale për Mjedisin bashkon elementët më të rëndësishëm të këtyre veprimeve në një tërësi të vetme dhe bashkëkohore.

2.5 Legjislacioni mjedisor dhe Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis

Aspektet ligjore mjedisore ne Shqiperi jane permbledhur ne Ligjin “Per Mbrojtjen e Mjedisit” Nr. 10431, date 09.06.2011. Ky ligj rregullon parimet lokale dhe kombetare ne mbrojtjen e mjedisit, percakton kerkesat per pergatitjen e VNM, vleresimet strategjike mjedisore, kerkesat per lejimin e aktiviteteve qe kane ndikime ne mjedis, parandalimin e reduktimin e ndotjeve, normat mjedisore e standartet, kontrollin e monitorimin mjedisor, detyrat e autoriteteve, rolin e publikut dhe sanksionet ne rastet e shkeljes se ligjit.

Kuadri ligjor per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis perbehet nga nje sere ligjesh dhe aktesh nenligjore:

1. Ligjit Nr. 10431, date 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”
2. Ligji Nr.10448, date 17.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”
3. Ligjit Nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”,.
4. VKM Nr.249, date 24.04.2003 “Per miratimin e dokumentacionit per leje mjedisore dhe te elementeve te lejes mjedisore”.
5. Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin e zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit"
6. Konventa e AARHUS “Per te drejten e publikut per informim mjedisor, pjesmarrjen e publikut ne vendimmarrje dhe per t’ju drejtuar gjykates per çeshtje mjedisore”

Procedura përfshin gjithashtu: a) konsultime me autoritetet relevante, dhe b) debate publike mes përfaqësuesve të ministrisë që licencen propozimin, organeve për rregullimin e territorit dhe turizmit, organeve të qeverisjes vendore, personave të interesuar, OJQ-ve për mjedisin, dhe propozuesit.

Ne shkalle kombetare, ky VNM ka marre ne konsiderate dhe eshte mbeshtetur ne dokumentet startegjike si:

- Plani Kombetar per zbatimin e Marreveshjes se Stabilizim Associmit.
- Plani Kombetar i Veprimit ne Mjedis
- Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit
- Strategjia dhe Plani i Veprimit per Biodiversitetin
- Strategjia per Zhvillimine Pyjeve dhe te Kullotave
- Plani dhe Studimi per Menaxhimin e Integruar Bregdetar.
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Zhvillimin e Turizmin Kulturor dhe Mjedisor
- Strategjia Kombetare per Zhvillim e Intergrim

Hartimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) eshte nje kerkese e legjislacionit shqiptar dhe atij europian. Kuadri ligjor per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis perbehet nga nje sere ligjesh dhe aktesh nenligjore.

Ligjin Nr. 10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” i ndyshuar përcakton detyrimet per Pajisjen me Leje Mjedisore te subjekteve fizike dhe juridike qe kerkojne te ushtrojne nje veprimtari qe ka

ndikime ne mjedis. Kreu IV i këtij ligji “Leja per veprimtarite qe ndikojne ne mjedis” Nenet 35-48 percaktojne modalitetet e marrjes se lejes mjedisore.

Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”.

Ky ligj rregullon marrëdhëniet midis njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. Ky ligj është plotësisht i perafuar me Direktiven 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Keshillit, date 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësitë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve të mjedisit” të ndryshuar”

Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”. Ne kete ligj jane percaktuar aktivitetet qe kerkojne pergatitjen e VNM e VSM dhe cila do te jete permbajtja e ketij vleresimi dhe procedurat e miratimit. Ky ligj percakton dy lloje te VNM ne vartesi te natyres se aktivitetit te pasqyruar ne shtojcat 1 dhe 2 te tij.

Ligji Nr. 10448, date 14.07.2011 « Per lejet e mjedisit » Ky ligj percakton rregullat per lejimin e zhvillimit te disa veprimtarive qe shkaktojne ndotje ne mjedis ne Republiken e Shqiperise si dhe masat e parashikuara per parandalimin e kesaj ndotje dhe, kur kjo nuk eshte e mundur, masat per pakesimin e shkarkimeve te tyre te gazta, te lengeta e te ngurta ne ajer, uje e toke.

Shtojca 1, permban ato projekte qe kane ndikime mbetese ne mjedis e kerkohet nje VNM i detajuar dhe i thelluar. Ndersa ne shtojcen 2 perfshihen projektet qe kane me pak ndikim ne mjedis e keta projekte kerkojne nje VNM te permbledhur.

Ky ligj eshte perafuar plotesisht me Direktivat:

7. 2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 15 janarit 2008 “Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar te ndotjes”, e ndryshuar
8. Direktiven 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 23 Tetorit 2001 “Mbi kufizimin e shkarkimeve te disa ndotesve ne ajer nga instalimet e medha me djegie”

Ne zbatim te ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 «Per lejet e mjedisit», doli VKM Nr.419, date 25.06.2014 « Per Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri”, i cili percakton dhe rregullon procedurat per dhe dokumentacionin e nevojshme per marrjen dhe transefrimin e Lejeve te Mjedisit te tipit A, B, C.

2.6 Legjislacioni mjedisor i nderlidhur me veprimtarine ne mjedis

- **Mbi funksionimin institucional**
- VKM Nr.46, date 29.01.2014 “Per krijimin dhe menyren e organizimit e te funksionimit te inspektoriatit shtetror te mjedisit, pyjeve dhe ujrave”

- VKM nr.47, datë 29.1.2014 "Për percaktimin e rregullave per organizimin dhe funksionimin e Agjencise Kombatare te Mjedisit e te Agjencive Rajonale"";
- Per pyjet dhe sherbimin pyor
- Ligji Nr.9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyor", i ndyshuar me ligjin Nr.36/2013
- Ligji Nr.10120, date 23.04.2009 "Per mbrojtjen e fondit te bimeve mjekesore, eterovajore e tanifere natyrore"
- Ligji Nr. 9663, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor i ndyshuar"
- Zonat e Mbrojtura dhe Biodiversiteti
- Ligji nr. 9587, date 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndyshuar me ligjin Nr.68/2014
- Ligji nr.8906, date 06.06.2002 "Per zonat e mbrojtura", i ndyshuar me Ligjin Nr.9868, date 04.02.2008
- Ligji Nr.10253, date 11.03.2010 "per gjuetine", i ndyshuar me Ligjin Nr.43/2013
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër";
- Mbi te drejten e Informimit te Publikut te Ndikuar
- Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 ""Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit";
- VKM nr. 16 datë 4.1.2012 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor";
- Ligji nr. 9334, datë 16.12.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike";
- VKM nr. 1553, datë 26.11.2008 "Krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos".
- Legjislacion tjetër i lidhur me proceduar e aplikimet per leje dhe licencat
- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton një "one-stop shop" për të gjitha licencat, autorizimet dhe lejet që lëshohen për personat fizikë ose juridikë për kryerjen e një aktiviteti me interes publik ose përdorimin e një objekti publik.
- Ligji nr. 10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i cili pasqyron ndryshimet në legjislacionin ekzistues të fushave specifike të prekura nga ligji nr. 10081, datë 23.02.2009.
- VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".
- Ligji 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndyshuar me ligjin Nr.156, date 10.10.2003
- VKM nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre.
- VKM Nr.418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim"

- VKM Nr.175, date 19.01.2011 “Per miratimin e strategjise kombater te menaxhimit te mbetjeve dhe planit kombetar te meanxhimit te mbetjeve.”
- VKM Nr.13, date 04.01.2013 “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis.

2.7 Procedura e hartimit te Raportit te VNM

Gjate kesaj faze fillimisht u shqyrtua informacioni i disponueshem dhe u percaktuan drejtimet e punes mbi bazen e kuadrit te politikave te percaktuara per sektorin e ujit dhe mjedisit. Gjithashtu ne kete faze u hartua edhe nje strukture per per kryerjen e vleresimit, identifikimin e alternativave fillestare dhe percaktohet se c'fare informacion plotësues do të ishte i nevojshem. U percaktua fokusi i procesit te vleresimit dhe u lane menjane e disa çështjeve. Ne kete proces pune jane marre parasysh edhe mendimet e atyre personave me të cilët u kryen konsultime.

U kerkua dhe identifikua informacioni ekzistues per kete zone dhe studime, plane, projekte apo programe. Ne rastin e ketij studimi u identifikua që në fillim të procesit veshtiresi ne marrjen e informacionit baze, i cili ishte i domosdoshem si per berjen e vleresimit ose mungesa e sistemimit dhe organizimit te ketij informacioni. Sidoqofte ne ndihme te hartimit te ketij raporti na erdhen disa studime te meparshme me te cilat jemi konsultuar dhe kemi marre ne konsiderate konkluzionet e tyre, si:

- EPTIZA, Manual Guide per Planifikimin Hapsinor te Rajoneve ne Shqiperi
- Kuadri i Politikave Mjedisore ne Administrimin e Tokes dhe Menaxhimi i Projekteve, Banka Boterore
- Strategjia Rajonale e Zhvillimit – Objektivat e Zhvillimit te Mijevjeçarit, Qarku Durres dhe Tirane.
- Planet Lokale te Veprimit ne Mjedis

Direktiva e BE-se kërkon që pasojat e pritshme mbi mjedisin, si pasoje e nderhyrjeve te parashikuara nga zhvilluesi, duhet të mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh mjedisore. Fokusi kryesor i punes duhet te perqendrohet ne te kuptuarit e situates ekzistuese te mjedisit dhe planifikimin e pasojave mbi te ne lidhje me:

- Biodiversitetin (habitatet, dhe speciet e florës dhe faunës)
- Aspektet njerëzore – shëndeti, jetesa dhe mirëqenia (shoqërore-ekonomike dhe ekonomike)
- Ajri – permiresimi i cilesise se ajrit
- Tokën – në veçanti e lidhur me erozionin dhe erozionin bregdetar
- Ujin – mbrojtja e cilësisë së ujit dhe burimeve ujore, dhe rreziku i përmytjeve
- Faktorët klimaterike – njohja e rritjes së rrezikut të erozionit bregdetar
- Vlerat materiale – infrastruktura, ndërtimet, burimet natyrore, mineralet, etj.
- Trashëgimia kulturore
- Pejzazhi

Ne kete proces përfshiret edhe identifikimi i pasojave te rendesishme dhe dytesore, kumulative, me efekte bashkëvepruese (sinergjike), afat-shkurtër, afat-mesem e afat-gjate, të përhershme dhe të përkohshme, positive dhe negative.

▪ *Konsultimi*

Si pjesë perberese e punes per pergatitjen e ketij aktiviteti jane ndermarre konsultime me banoret e zones. Konsultimet kryesore te kryera përfshijnë:

- Takimin me te kryeplakun e fshatit, ku shtrihet aktiviteti
- Takimin me banore e zones perreth ku shtrihet aktiviteti

Përgjigjet e marra gjatë procesit te konsultimeve me grupet e interesit ne nivel lokal, rajonale dhe kombëtare u përdoren për të formuluar me mire zhvillimin e metejshem te ketij aktiviteti.

▪ *Konteksti i Studimit*

Marrja parasysh e analizave të politikave dhe planeve e programeve te rendesishme si dhe identifikimi i objektivave për mbrojtjen e mjedisit të vendosura në nivel Ndërkombëtar, nivelin e BE-se apo Shtetit Anëtar ne BE.

Ekziston nje hierarki politikash dhe planesh duke filluar që nga konventat ndërkombëtare, strategjitë Evropiane, strategjitë kombëtare e deri tek strategjite rajonale apo lokale, te cilat duhen pasur ne konsiderate.

Tabela më poshtë tregon listën e strategjive dhe planeve kryesore të marra parasysh gjate hartimit te Raportit te Vleresimit Ndikimit ne Mjedis.

Angazhimet Ndërkombëtare	
Deklarata e Johaneshburgut për një Zhvillim të Qëndrueshëm	Politikat ndërkombëtare dhe Evropiane kanë ofruar parimet udherrefyese, në veçanti ato në lidhje me zhvillimin e rëndueshëm, vlerësimin e natyrës dhe mbrojtjes së habitateve e specieve.
Konventa mbi Diversitetin Biologjik	
Konventa për Mbrojtjen e Specieve Migratore të Botës së Egër	
Konventa për ligatinat e një rëndësie ndërkombëtare veçanërisht habitatet e shpendëve te ujit (Ramsar)	
Konventa për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Botës së egër të Mjedisit Natyror në Evropë	
Konventa për mbrojtjen nga Ndotja te Detit Mesdhe (Barcelona)	
Konventa për Mbrojtjen e Kulturës Botërore dhe Trashëgimisë Natyrore	
Konventa për ruajtjen e botës së egër dhe habitateve natyrore Evropiane	
Mundësi për Informacion, Pjesmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Mundësi për t'ju drejtuar Drejtësisë per Çështjet Mjedisore (Aarhus)	
Strategjia Evropiane për Zhvillim të Qëndrueshëm	
Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor	
Strategjia Evropiane për Biodiversitetin	
Programi i BE-se per Gjashte Veprimet ne Mjedis	
Dokumente Strategjike Kombetare	
Strategjia NdfersKombëtare e Mjedisit (draft)	Jane marre parasysh parimet e përgjithshme të zhvilluara në Strategjinë

	Kombëtare të Mjedisit.
Drafti i dokumentat të MSA	Drejtimi mbi prioritetet dhe marrja parasysh e angazhimit karshi Bashkimit Europian për procesin e harmonizimit (me legjislacionin, etj.).
Strategjitë sektoriale duke përfshirë ato për administrimin e ujërave, transportit, energjisë, bujqësisë	Eshtë kryer vlerësimi i strategjive sektoriale përkatëse, megjithëse ato ndryshojnë në mënyrën sesi janë të përfshira parimet për një mjedis të qëndrueshëm
Strategjia e Turizmit	Keto janë dokumenta politike të rëndësishme që paraqesin një këndvështrim në nivel kombëtar.
Plani i Veprimit dhe Strategji e Biodiversitetit	
Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis	

- *Analizimi* i gjendjes aktuale të mjedisit duke përfshirë edhe identifikimin e problemeve egzistuese në lidhje me aktivitetin e prodhimit të pijeve alkoolike.
- *Vlerësimi i alternativave* dhe identifikimi i pasojave të rëndësishme mbi mjedisin dhe masat e nevojshme për t'i zvogëluar ato.
- *Propozime për monitorimin* e zbatimit të veprimtarisë.
- *Leja Mjedisore* se si ka ndikuar VNM për hartimin e propozimeve përfundimtare të zhvilluesit të aktivitetit

2.8 Tarifa e shërbimit

Për zhvillimin dhe shqyrtimin e procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe pajisjen e Deklaratës Mjedisore, autoriteti që ka këtë të drejtë, Minsitria e Mjedisit, ka vendosur tarifën për këtë shërbim që kryen.

Mbeshtetur në Udhezimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit Nr.7938, datë 17.07.2014 dhe Ministrisë së Financave Nr.10442/1, datë 31.07.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-es, pika 2)a- Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Paraprak, dhe megjithatë siç përcaktohet këtu, aktiviteti i propozuar nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "CURRI" Sh.p.k. & "GECI" Sh.p.k., i përket shtojcës 2 të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar:

Pika 10-g) – Instalime të kanaleve ujëtare/akuadoteve në distanca të largëta

Pika 10-h) – Nxjerrja e ujit nëntokësor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujërave nëntokësore që nuk janë përfshirë në shtojcën I.

tarifa që do të paguhet për Ministrinë e Mjedisit, është përcaktuar të jetë 30.000 leke.

3. Sektori i ujit në Shqipëri

3.1. Pershkrim i pergjithshem

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një burim madhor për vendin. Sasia mesatare e ujit të pijshëm për frymë është 8,700 metra kub në vit, një ndër më të lartat në Evropë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, të lumenjve, të liqeneve dhe të ujëmbledhësve të ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burimet natyrore dhe burimet ujore nëntokësore, përveç zonës metropolitane të Tiranës e cila një pjesë të furnizimit e merr nga burimet ujore malore që janë devijuar për të krijuar një rezervuar sipërfaqësor furnizimi me ujë që rrjedhimisht duhet trajtuar.

Burimet ujore në Shqipëri janë të shpërndara në mënyrë hidrografike në gjashtë (6) basene ujore, të cilat rrjedhin të gjitha në drejtim perëndimor ose veriperëndimor në të gjithë vendin dhe që kanë sistemet e tyre kryesore nga veriu në jug si vijon: lumenjtë Drini-Buna, lumi Mat, lumenjtë Ishëm dhe Erzen, lumi Shkumbin, lumi Seman dhe lumi Vjosë. Është e rëndësishme të theksohet se këto sisteme lumenjsh kullojnë jo vetëm tokën në Shqipëri, por edhe pjesë të mëdha zonash të banuara të Maqedonisë, Kosovës dhe të Malit të Zi.

Prodhimi dhe shitja e ujit janë treguesit që përcaktojnë më së miri nevojat e prodhimit për të plotësuar kërkesën totale të popullsisë për furnizim me ujë të pijshëm. Për vitin 2010, Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues raportoi se prodhimi mesatar i ujit ishte 301 litra për frymë në ditë (292 milion metra kub në vit) dhe shitja mesatare e ujit ishte 110 litra për frymë në ditë (107.5 milion metra kub në vit).

Diferenca mes këtyre dy shifrave tregon qartë masën e "ujit të pafaturuar" sipas kërkesës, dhe përfaqëson sasinë e ujit "që prodhohet por nuk faturohet" për çdo person të furnizuar.

Shifrat e mësipërme tregojnë se uji i pafaturuar për vitin 2010 ishte 63.2%. Megjithatë, nuk duhet supozuar se 63.2% e ujit është ujë i humbur. Është fakt se shumë sisteme transmetimi dhe shpërndarjeje kanë një numër të konsiderueshëm lidhjesh "të paligjshme" apo "të paregjistruara", që do të thotë se një pjesë e këtij 63.2% përdoret dhe jep një shërbim të nevojshëm. Po kështu, vendosja e matësve mbetet shumë e ulët (44.6% e klientëve kanë matës dhe 46.3% e ujit të shitur është i matur); kjo do të thotë se nuk ka informacion të qartë në shkallë kombëtare për të arritur në një shifër reale të kërkesës.

Kapaciteti mesatar vjetor i burimeve të furnizimit me ujë në Shqipëri për vitin 2010 përlogaritej se ishte rreth 654 milion meter kub në vit, ndërkohë që kërkesa totale për ujë, duke e vlerësuar me një normë prej 150 litrash për frymë në ditë (norma e kërkesës që aplikohet në Shqipëri) dhe një tolerancë prej 20% humbje teknike uji, është vlerësuar se ka qenë 197 milion metra kub në vit për popullsinë e shërbyer, dhe 240 milion metra kub në vit për popullsinë në total në zonën e shërbimit. Kjo tregon se burimet totale në përdorim janë pothuaj sa 3-fishi i kërkesës së pritshme për të gjithë popullsinë, të shërbyer e të pashërbyer, në zonat nën administrimin e ndërmarrjeve. Kjo nuk do të thotë se të gjitha zonat kanë furnizim të bollshëm. Disa zona specifike kanë nevojë për investime në prodhimin e ujit për të plotësuar nevojat e kërkesës vendore. Këto shifra dëshmojnë që problemi në Shqipëri nuk është se duhet prodhuar më tepër ujë, por menaxhimi i kërkesës për ujin e prodhuar.

3.2. Uji i ambalazhuar ne Shqiperi

Uji i ambalazhuar u krijua si një praktikë komerciale kryesisht në Evropën Perëndimore, ku, për konsumatorët, ka qenë pjesë e ritualit të tyre të përditshëm të konsumit. Por tani është një pije e vërtetë globale deri në qoshtet më të largëta të globit. Disa tregje aziatike kanë arritur rritje të fuqishme duke u bërë tregjet kryesore gjatë viteve 2000 me 200 miliardë litra prodhim vjetor sipas Global Market. Vetëm në 2008 ky u rrit me 5,6 përqind në krahasim me një vit më parë. Kjo ka ardhur në vendet në zhvillim, edhe si përparim ekonomik e rritje të mirëqënies, si të paktën një zgjidhje e pjesëshme për problemin e ujit që mungon në shumë vende ose është i papërshtatshëm, por dhe si rezultat i presionit të biznesit. Sigurisht, konsumi për banor varet sipas rajoneve por ndryshon për vendet e varfra, shpesh në mënyrë dramatike, nga mesatarja globale. Për shembull, disa vende të Europës Perëndimore kanë nivele konsumi për frymë shumë 7-10 herë më të larta se shumë vende të Afrikës apo Azisë.

Ambalazhimi dhe tregtia e ujit është një sektor, ku sipërmarrësit në garë janë shumëfishuar në vetëm pak vite, ndërsa rritja e kërkesës konsumatore ka nivele të ulëta dhe mundësia për eksport e ujit shqiptar është shumë e pakët.

Vitin e kaluar, për prodhimin, ambalazhimin dhe tregtimin e ujit mineral numëroheshin rreth 60 stabilimente të licencuara, ndërsa pesë vite më parë, numri i tyre ishte më pak se 30. Për të njëjtën kohë, konsumi në treg është rritur në masën 50%, sipas të dhënave të prodhimit dhe tregtisë së jashtme.

Por, ndërsa tregu shqiptar po duket gjithnjë e më i vogël për kompanitë që operojnë në këtë sektor, shumë pak prej tyre kanë hedhur sytë nga eksporti, pasi janë pothuajse të sigurt që nuk janë konkurrues në tregjet e huaja, për shkak të kostos së lartë të prodhimit dhe transportit. Pengesë për eksportin është edhe mungesa e unifikimit të standardit të cilësisë së sigurimit ushqimor me tregun e Bashkimit European. Deri më tani, hapat e ndërmarrë nga qeveria shqiptare janë për përafrimin e standardeve të cilësisë në këtë sektor, por sipas operatorëve më të mëdhenj në treg, nevojitet vendosja e standardeve të njëjta.

Por vështirësitë e konkurrencës gjenden mbi të gjitha në tregun e brendshëm. Investitorët kryesorë në prodhimin e tregtimin e ujit mineral ankohen për mungesën e një konkurrence të drejtë në treg. Sipas tyre, problem mbetet marrja e ujit në burime jo të autorizuara dhe nxjerrja e produkteve të palicencuara.

Shtimi i numrit të operatorëve, por as efektet e krizës ekonomike globale nuk i kanë penguar kompanitë të rrisin prodhimin.

Disa prej operatorëve kryesorë në treg shprehen se vjet e rritën prodhimin krahasuar me një vit më parë, ndonëse jo në masën e duhur.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në vitin 2009 janë prodhuar rreth 712 mijë hektolitra ujë në fabrikat shqiptare me një vlerë të përafërt prej rreth 1.3 miliardë lekësh. Siç vërehet edhe nga grafiku, rritja e prodhimit përkon me periudhën kur në treg janë futur investitorë të rinj. Vitin e kaluar “Harri Lena Group” hodhi në treg ujin “Trebeshina”, duke bërë investimin e fundit më të madh në këtë sektor prej 5 milionë eurosh. Ndërkohë, një nismë e fortë marketingu u zhvillua nga “Agra Group”, për të pozicionuar mirë në treg ujin “Spring”.

Së bashku me importin, tregu shqiptar ka konsumuar pak më shumë se 1.2 miliardë hektolitra ujë, ose rreth 4.4 miliardë lekë.

Të dhënat zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit tregojnë se sasia e prodhimit të ujit të ambalazhuar vitin e kaluar u rrit me rreth 8.9% krahasuar me një vit më parë. Por, në këtë rritje, sipas operatorëve në treg ka dhënë ndikim kryesor shtimi i numrit të stabilimenteve të ujit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sasia e prodhuar gjate vitit 2011 ishte 1 milion hektolitra uje i ambalazhuar.

Nga të dhënat e tregut, rezulton se sasia e importit po ruan të njëjtat nivele këto tre vitet e fundit. Rritja me mbi 4% e tregtisë së ujit vitin e kaluar krahasuar me një vit më parë, është pasojë e rritjes së prodhimit

vendas. Konsumi i ujit mineral llogarit në rreth 21,5 litra ujë në vit për frymë, nivel shumë më i ulët se në tregjet e Europës Perëndimore, ku konsumi i kalon 100 litra ujë për frymë në vit.

3.3. Gjendja ne sektorin e ujesjelles kanalizimeve ne Shqiperi

Aktualisht janë 58 shoqëri në sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, që janë të evidentuara nga ERRU, 31 prej të cilave i ofrojnë të dy shërbimet. Një pjesë e madhe e tyre është përgjegjëse për zona me më pak se 50,000 banorë, 9 prej tyre ofrojnë shërbim për zona me më pak se 5,000 banorë; më e madhja me një përqindje të konsiderueshme është Tirana me afërsisht 1 milionë banorë. Sot ofrojnë shërbimet 56 operatorë me licencë të ERRU dhe 44 zbatojnë tarifa të miratuara nga ERRU. Këto shoqëri mbulojnë me shërbimin e furnizimit me ujë rreth 80% të popullsisë duke lënë pas shërbimin e largimit të ujërave të ndotura rreth 67% në total. Në shumë njësi administrative kryesisht komuna shërbimet ofrohen nga vetë njësitë e qeverisjes vendore - të palicencuar - të cilët kujdesen edhe për shërbimin e kanalizimeve, kur ato nuk ofrohen nga shoqëria. Duke pasur parasysh se vetëm dy shoqëri e ofrojnë shërbimin e trajtimit të ujërave dhe shërbimet e kanalizimeve konsistojnë kryesisht në grumbullim dhe shpërndarjen e ujërave të ndotura.

Duke qënë që Shqipëria është një vend i pasur me burime natyrore ujore, kërkesa për ujë për sa i përket sasisë mund të plotësohet. Shoqëritë po punojnë për të përmirësuar shërbimet e tyre në drejtim të disponibilitetit dhe cilësisë së shërbimit. Shërbimet kanalizime pritet të zhvillohen më tej duke qënë, që në një të ardhme të afërt do të bëhen funksionale pesë impiante trajtimi të ujërave të ndotura dhe impiante të tjera trajtimi parashikohen të bëhen funksionale në periudhë afatgjatë.

Arritja e qëndrueshmërisë financiare në sektor është një nga sfidat kryesore për shoqëritë, klientët dhe ERRU. Shqetësim kryesor përbëjnë niveli shumë i lartë mesatar dhe i papranueshëm i ujit pa të ardhura, por progres i dukshëm po bëhet në rritjen e përqindjes së shërbimeve të matura dhe në rritjen e kapacitetit menaxherial. Shoqëritë ujësjellës kanalizime me performance të mirë si Korça, Pogradeci dhe Librazhdi kanë vërtetuar që një shërbim efikas, financiarisht (pothuaj) i vetë qëndrueshëm me furnizim 24-orë është i mundshëm në Shqipëri, dhe kjo është ajo çka mezi po e presin aktorët në sektor.

Në Shtator 2011, Këshilli i Ministrave miratoi "Strategjinë e Kombëtare të Sektorit të Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime", që qartëson objektivat prioritare, përgjegjësitë.

3.4. Strategjia e sektorit te shërbimeve te Ujesjelles Kanalizimeve

Rritja e numrit të popullsisë që kanë akses për ujë të bollshëm e të sigurt dhe kanalizime si për popullsinë që jeton në zonat urbane ashtu dhe për ato që jetojnë në zona rurale është një ndër objektivat e Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura e cila po punon që deri në vitin 2017 të rrisë mundësitë e furnizimit me ujë në shkallë vendi 98% për zonat urbane dhe 85 % për zonat rurale. Gjithashtu qëllimi i të gjitha investimeve në sektorin e kanalizimeve kanë për qëllim lidhjen me sistemin e kanalizimeve 87% e zonave urbane dhe 45% zonat rurale, ndërsa shkalla e trajtimit të ujera të ndotura urbane të jete gati 40%. Prioritet e sektorit janë detajuar në Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011 – 2017 si:

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve,
- Orientimi i shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove,
- Përmirësimi drejtimit dhe rregullimit të sektorit,
- Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit,
- Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat e BE-së për Ujin.

Hartimi i planit të përgjithshëm të investimeve kapitale për ujësjellës-kanalizime përfshin një periudhë 25-30 vjeçare të ndarë në tre faza: afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Aktualisht, falë bashkëpunimit me Qeverinë Gjermane përmes KfW, ka përfunduar hartimi i Master Planit të përgjithshëm për investime kapitale në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Ky plan bazohet në mbërritjen e standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Ky plan i detajuar do të bashkëngjitet dokumentit të strategjisë së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

3.4.1. Rajonizimi

Një tjetër iniciativë e Qeverisë Shqiptare është rajonalizimit ose agregimi i shoqërive të vogla në një shoqëri më të madhe, i cili ka qëllim të përmirësojë efektshmërinë operative dhe të kapitaleve që shoqëritë të mund të jenë me vetëfinancim, të kenë një plan afatgjatë dhe të qëndrueshëm, me qëllim përmirësimin e treguesve të punës dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj konsumatorit me një kosto të përballueshme e me të lire si dhe të garantojnë mbrojtjen e mjedisit. Kjo reformë është në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit të Bashkimit Evropian. Rajonalizimi është përcaktuar në dokumentin e Strategjisë Sektoriale për Ujësjetës Kanalizimeve dhe ai synon të inkurajojë bashkimin e shoqërive UK dhe sfida e viteve në vazhdim është që nga 58 shoqëri sot të kemi 26 deri në fund të vitit 2017.

MTI, Zyra e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe Komisioni Evropian për Shqipërinë, kanë filluar zbatimin e programit “Mbështetje Teknike për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri”, (WASSP). Objektivi kryesor i këtij programi është zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore që kontribuojnë në të gjithë sektorin UK për të bërë të mundur përmirësimin dhe rritjen e ndjeshme të aksesit

dhe efikasitetit për shërbime cilësore, të sigurta e të qëndrueshme të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri.

3.4.2. Standardet teknike te projektimit dhe zbatimit

Në vitin 1978 në sektor ka qënë vetëm një libër mbi normat teknike të projektimit dhe zbatimit në fushën e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, ndërsa tani MTI në bashkëpunim me Ambasadën Franceze ka përgatitur tete libra teknik, në shqip dhe anglisht, dhe po punohet nga DPUK për saktësimin e terminologjisë teknike në gjuhën shqipe për të vazhduar më tej me procedurat për miratimin e tyre.

Janë plot 62 standarde të Bashkimit Evropian të cilat janë integruar për hartimin e 8 librave te standardeve shqiptare te projektimit, operimit dhe mirëmbajtjes zbatimit. Standardet e Furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve, se bashku me EUROKODET për ndërtimin dhe standardet teknike te projektimit dhe zbatimit te RRUGËVE, kane bere qe Shqipëria te jete nga te parat vende ne Ballkan drejt përshtatshmërisë se standardeve kombëtare te projektimit dhe zbatimit me ato evropian, te cilat janë:

Standarde teknike te projektimit zbatimit dhe operimit dhe mirëmbajtjes:

1. Punimet e tokës,
2. Sistemet e pompimit.

Projektimi, zbatimi, operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve te furnizimit me ujë :

3. Prodhimi ujit,
4. Rezervuarët,
5. Rrjeti shpërndarës.

Projektimi, zbatimi, operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve te Kanalizimeve:

6. Sistemi i kanalizimeve
7. Impiante te trajtimit te ujit te ndotur te kanalizimeve mbi 50 banore

Trajtimi i ujit te ndotur te familjeve individuale

8. Trajtimi i ujit ne vendin e gjenerimit te tij, Gropat septike

3.5. Kuadri ligjor dhe organizimi institucional sektorial i ujit

Sektori i shërbimeve Ujesjelles Kanalizimeve është ndoshta sektori i vetëm në Shqipëri që nuk ka një ligj bazë i cili të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij, por aktualisht funksionon mbi bazën e disa akteve ligjore e nënligjore direkte (mbi 10 ligje e akte nënligjore që merren me problemet e menaxhimit të ujërave) dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore të cilat ndikojnë indirekt në sektor.

Ky sektor ka nevojë per krijimin e një kuadri të plotë ligjor në sektor i cili do të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë si dhe të institucioneve publike të përfshirë në këtë sektor, modelin e tregut, rregullat e funksionimit të tij, etj, do të ishte i nevojshëm krijimi i një ligji specifik për sektorin.

Një praktike e tillë ndiqet dhe në shumë vende të tjera europiane, po jo vetëm. Sektorë të tjerë në Shqipëri si psh ai i energjisë, komunikimeve elektronike, shërbimi postar, shërbimi bankar, etj, kanë një ligj specifik për sektorin, ku pjesë e tij është dhe kuadri rregullator. Ky ligj do të integronte dhe do të harmonizonte të gjitha aktet e shpërndara në kohë dhe do të shmangë paqartësitë, dykuptimësitë dhe interpretimet e ndryshme.

- Ligji Nr.8103, datë 28.03.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.8306 datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”.
- Ligji Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- Ligji Nr.7926 datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar.
- Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në Njesitë e Qeverisjes Vendore”.
- Ligji Nr. 8102, datë 28.03.1996 ndryshuar me Ligjin Nr.9915, datë 23.03.2005 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura”.
- Ligji Nr. 8975, datë 21.11.2002 ndryshuar me Ligjin Nr. 9286, datë 30.09.2004 “Për trajtimin e Faturave Tatimore të ujit të pijshëm si Titull Ekzekutiv”.
- Ligji Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” me ndryshime.
- Ligji Nr. 111/2012 datë 15.12.2012 “Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, që hyn në fuqi një vit pas botimit në fletoren zyrtare, d.m.th në fund të vitit.
- Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.
- Ligji 8743, date 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.
- Ligji nr. 9803, date 13.02.2007 “Per faljen e kamatvonesave të pagesave të papaguara të konsumit të ujit të pijshëm, që konsumatorët familjare dhe jofamiljare kanë ndaj ndërmarrjeve dhe shoqërive, me kapital tërësisht shtetëror, të ujësjellës kanalizimeve”.
- VKM Nr. 236, datë 10.05.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë” ndryshuar me VKM Nr.96, datë 21.02.2007 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.236, datë 10.05.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë”, dhe Udhëzim Nr. 3, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”.
- VKM Nr. 145, datë 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores Higjeno-Shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.
- VKM Nr.479, datë 29.07.1998 “Për liberalizimin e tarifave të ujit të pijshëm”.

- VKM nr.660 “Për transferimin e shoqërive ujësjellës kanalizime pranë njësive të qeverisjes vendore”.
- VKM nr. 677, date 3.10.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM. Nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave për Këshillat Mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore”.
- VKM nr.678, date 3.10.2007 “Për një shtesë në VKM nr.271, datë 9.05.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.
- VKM Nr.643, date 14.9.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve”.
- VKM Nr.1304, date 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve, sh.a””.
- Udhëzimi i METE-s Nr.965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e VKM “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore”.

3.6. Performanca e sektorit te ujit


Në një përpjekje për të përmirësuar performancën e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të ujërave të zeza, Qeveria ka hartuar reforma të caktuara duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Sigurimi i këtyre shërbimeve i është besuar njësive të qeverisjes vendore për të rregulluar më mirë stimujt dhe përmirësuar mbikëqyrjen në nivel vendor. Qeveria ka zgjedhur mënyrën e organizimit të kompanive të ujësjellësit si shoqëri aksionere në mënyrë që të ofrojë mundësinë e një menaxhimi më të mirë të tyre si korporata. Përveç kësaj, Qeveria ka ngritur dhe Entin Rregullator të Ujit, një agjenci e pavarur me mandat rregullator të cilësisë së shërbimit dhe tarifave të tij. Në përfundim, reforma në sektor është mbështetur edhe me fonde të konsiderueshme investimesh dhe subvencione vjetore operacionale.

Aktualisht, sektori i ujësjellës-kanalizimeve e realizon funksionin e tij nga ndërveprimi i Entit Rregullator të Ujësjellës Kanalizimeve (ERRU), Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures. Njësive përkatëse të Qeverisjes Vendore dhe shoqërive që realizojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujrave të ndotur. Deri në vitin 2010, në këtë sektor operonin 56 kompani, nga të cilat 43 janë të licencuara, 5 iu

kishte mbaruar afati


Licensimi i operatorëve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve



Kompanitë shqiptare të ujësjellësit furnizojnë me ujë 90 përqind të konsumatorëve në qytete dhe vetëm 58 përqind në zonat rurale. Shërbimi i mbledhjes së ujërave të zeza është në nivele akoma më të ulëta, veçanërisht në zonat rurale. Shërbimi i furnizimit me ujë është i kufizuar në një mesatare prej 11 orësh në ditë. E njëjta gjë mund të thuhet për eficiencën, përderisa një

pjesë e rëndësishme e asaj që siguron sistemi nuk sjell të ardhura, pjesërisht për shkak se më pak se gjysma e lidhjeve të konsumatorëve janë të pajisura me matësa. Megjithatë qëllimi i decentralizimit është të nxisë përgjegjshmërinë ndaj nevojave të qytetarëve dhe të promovojë një performancë më të mirë, *de facto* zbatimi i tij nuk ka mundur të arrijë plotësisht qëllimet e planifikuara të këtij transferimi. Ndërkohë që ka shqetësime lidhur me kapacitetet vendore për të siguruar, menaxhuar dhe monitoruar këto shërbime, ekzistojnë dhe boshllëqe të dukshme mes kalimit të përgjegjësive funksionale, autoritetit menaxhues, apo resurseve financiare për të realizuar e ushtruar ato.

Bazuar në të dhënat e vitit 2010, në zonën e juridiksionit të shoqërive ujësjellës kanalizimeve të përfshira në programin e monitorimit për këtë vit, jetojnë 3,3 milion banorë nga të cilët 2,66 milion furnizohen nga sistemet e ujësjellësit në administrim të shoqërive UK. Bazuar në këto të dhëna, treguesi i mbulimit me ujësjellës është realizuar në masën 80.3%. Pjesa dërrmuese e banorëve të shërbyer ose 95% e tyre, e ka shërbimin me lidhje direkte në banesë, ndërsa pjesa tjetër shërbehet nëpërmjet furnizimit me çesma publike.



Nga popullsia totale që furnizohet me ujë, 78% e tyre jetojnë në qytet dhe vetëm 22% jetojnë në fshat. Nëse bëhet një krahasim në raportin furnizohet/nuk furnizohet me ujë për zonat rurale dhe urbane, do të vihej re se: 9.2% e popullsisë që jetojnë në zonat urbane dhe 43% e popullsisë që jetojnë në zonat rurale nuk furnizohet me ujë të pijshëm. Pra, fshati vazhdon të jetë ende i diskriminuar, shumë larg plotësisht të kushteve për sigurimin e ujit, e akoma më larg ujit 24 orë. Duhet theksuar se studimet e rendisin lehtësimin e sigurimit të ujit si një ndër indikatorët më të rëndësishëm për të vlerësuar kushtet e jetesës në një vend dhe për të shpjeguar arsyet e lëvizjes së popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane.

Megjithatë, lidhur me pjesën e popullsisë që shfaqet pa shërbimin e ujit nuk duhet lënë pa përmendur fakti se ajo mund ta sigurojë ujin nëpërmjet puseve individuale (gjë që nuk e lehtëson jetesën e tyre) ose mund ta përdori ujin në mënyrë të paligjshme nga sistemet e ujësjellësit të shoqërive që e ofrojnë këtë shërbim, por duke qenë se nuk janë të deklaruar, firmat i klasifikojnë si popullsi e pashërbyer.

Gjithsesi, një gjë është e sigurt, se plotësimi i objektivit që pas vitit 2015, 83% e zonave rurale të furnizohen me ujë, kur ende në vitin 2010, vetëm 43% e tyre e kanë këtë shërbim, do të jetë një sfidë shumë e madhe jo vetëm për qeverinë, por edhe për Buxhetin e Shtetit.

Sipas të dhënave të vitit 2010, është prodhuar nga të dy llojet e sistemeve 292 milion m³ ujë dhe është shitur 107 milion m³ për të gjitha kategoritë e klientëve. Humbjet e përgjithshme ose shprehur ndryshe, uji që nuk sjell të ardhura në shkallë vendi është llogaritur 63%. Një pjesë e ujit të humbur është real dhe vjen si rezultat i konfi gurimit apo mënyrës së funksionimit të sistemit. Përgjithësisht këto lloj humbjesh pranohen deri në një normë rreth 20-25% e volumit të ujit të prodhuar.

Niveli i lartë i humbjeve, jep ndikim negative në situatën fi nanciare të shoqërisë pasi rriten kostot duke qenë se prodhohet ujë më tepër së nevojat. Njëkohësisht, nuk identifikohen burime potenciale të të ardhurave, për shkak të përdoruesve që nuk u faturohet ujë, pasi nuk janë të paisur me kontrata nga operatorët e shërbimeve. Nga ana tjetër është shumë serioz fakti që humbje në nivele të tilla, çojnë në shpërdorim të burimeve ujore të vendit.

Prodhimi dhe shitja e ujit, shprehur në litër për frymë në ditë, llogaritet si raport i volumeve respektive të ujit të prodhuar/faturuar, me numrin e ditëve të vitit dhe numrin e popullsisë së shërbyer.

Këta dy tregues na lejojnë të vlerësojmë masën e ujit të pafaturuar (ujit pa të ardhura), nga këndvështrimi i kërkesës për ujë. Diferenca ndërmjet tyre sugjeron se sa ujë “humbet” mesatarisht për frymë në ditë.

Referuar treguesve të performancës, rezulton se gjatë vitit 2010 është prodhuar mesatarisht 301 litër/frymë/ditë ose dyfi shi i normës së agreguar të kërkesës për ujë dhe është shitur 110 litër/ frymë/ditë një sasi krejtësisht e pranueshme krahasuar me normativën.

Bazuar në këto rezultate, është i qartë fakti se me prodhimin aktual, është krejtësisht e mundshme, të plotësohen kërkesat për ujë të pijshëm, për një popullsi rreth 5.5 milion banorë.

Uji i pijshëm është mall që prodhohet për t’ju shitur përdoruesve të lidhur në sistemin e furnizimit, kundrejt tarifave të përcaktuara. Për vendosjen e raporteve krejtësisht të drejta ndërmjet prodhuesit/shitësit të ujit dhe konsumatorëve si përdorues të tij, duhet që faturimi të bazohet në njësi volumetrike të matura. Kur përdoruesit faturohen mbi bazën e konsumit të matur, përvoja ka treguar se kërkesa për ujë reduktohet në masë të ndjeshme duke ndikuar në reduktimin e humbjeve.

Niveli i matjes së konsumit mund të shprehet si numër lidhjesh të matura ose si volum i ujit të shitur të matur, kundrejt totalit të lidhjeve apo totalit të ujit të shitur. Për vitin 2010 janë të evidentuara 574 408 lidhje (klientë) nga të cilat 91% janë klientë familjarë, 8.3% janë klientë private dhe 0.7% janë institucione shtetërore. Treguesi i nivelit të matjes së konsumit i shprehur nëpërmjet numrit të lidhjeve, rezulton 44.5% dhe si volum i ujit të shitur të matur rezulton 46.3%.

4. Gjendjes mjedisore e social ekonomike e zones

4.1. Te pergjithshme

Mjedisi është bazamenti mbi të cilin realizohet procesi i zhvillimit ekonomik dhe social në një territor të caktuar. Prandaj mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i qëndrueshem i burimeve dhe pasurive natyrore, që gjenden në këto mjedis, përbën një element kyç në krijimin e një standarti të mirë jetese për popullsinë aktuale dhe një garanci për brezat e ardhshme. Në qarkun e Tiranës, situata mjedisore është e pare në kuadër të zhvillimeve që kanë ndodhur në dekadën e fundit. Larmishmeria e ndryshimeve të ndodhura në këto qark, kanë lënë gjurmët e tyre në të gjithë komponentet e mjedisit si tek toka, biodiversiteti, ajri dhe uji.

Infrastruktura dhe shërbimet që ofrohen nëpërmjet saj përbëjnë një element themelor në zhvillimin e një vendi. Infrastruktura fizike si rrjeti rrugor, energjia elektrike dhe transporti, pengojnë ose lehtësojnë aktivitetin ekonomik në një zonë të caktuar. Kapitulet, krahu i punës dhe kompanitë / bizneset kanë tendencë të levizin në vendet që ofrojnë infrastrukture lehtësuese dhe institucione që i mbështesin ato në aktivitetin e tyre.

Rajoni Tirane – Durrës, tërë Zhvillimi është i përqendruar Në rajonin Tirane---Durrës dhe në hapësirën metropolitane dhe rurale rreth këtij rajoni

Ekzistenca e burimeve, shërbimeve (sidomos ato administrative, shëndetësore dhe arsimit të lartë) dhe aktiviteteve (funksioneve) në qendër ka bërë që popullsia të lëvizë drejt trekëndëshit Tirane--Durrës. Meqë në vite 1/3 e popullsisë së Shqipërisë është vendosur në këtë zonë, po këtu kanë vijuar edhe investimet në infrastrukture.

4.2. Qarku Durres



Pozicionimi dhe organizimi Administrativ

Qarku i Durresit ndodhet ne pjesen qendrore te rafshnaltes perendimore te Shqipërisë dhe është i perbere nga dy rrethe, Durresit dhe Kruja, te cilet perfshijne 6 njesi te qeverisjes vendore (Bashki, Komuna) dhe 104 fshatra. Qendra administrative e Qarkut është qyteti i Durresit.

Qarku Durres zë një sipërfaqe prej 76.000 ha dhe shtrihet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë Qendrore, me kufi j gjeografi kë meridianët 19°25' - 19°55' dhe paralelet 41°16' - 41° 37'. Laget nga deti Adriatik përgjatë rreth 62 km të kufi rit të tij perëndimor, me distancë 102 milje nga porti i Barit (Itali).

Ndarja administrative

Qarku përfshin dy rrethe, Durres dhe Krujë, një ndarje administrative që mbahet ende për efekt të mbledhjes së taksave. sigurisë etj. Strukturat e tyre përmbajnë 6 Bashki, të cilat janë qytete ose qendra të banuara, dhe 10 Komuna të cilat janë bashkimi i fshatrave përreth. Bashkitë dhe Komunat janë gjithashtu dhe territoret që i korrespondojnë qeverisjes lokale me atributet e tyre të vendimmarrjes. Ato janë të pavarura, por të gjitha përfaqësohen në Këshillin e Qarkut Durres, i cili luan rolin e një qeverisje vendore koordinuese.


4.2 Demografia

Sipas regjistrimeve te 1945 Durresit kishte 15032 banore, ndersa ne 1989 Durresit u regjistruan 82 719 banore. Ne fund te shekullit te 20- te (2000) komuna e Durresit kishte 142540 banore, ndersa qyteti durresit ne 200 l-in kishte 99546 banore.

Qarku u Durresit ka 351,899 banore dhe 90,939 familje me 495 banore per km². Popullsia e Qarkut te Durresit ne vitin 2003, perfaqeson 12% te popullsisë totale te Shqipërisë. Rreth 75% e popullsisë është peqendruar ne rrethin e Durresit.

Durresit ka qene porti kryesor i emigrimit nderkombetar per ne vendet e perendimit dhe destinacion pe migrimin e brendshem nga rajonet e varfera, kryesisht pjesa verilindore e vendit.

Ndryshimet demografike jane me te dukshme ne rrethin e Durresit dhe vecanerisht ne qytetin e Durresit, Bashkine e Sukthit, dhe komunat Rrashbull, Xhafzotaj dhe Katund i Ri. Ne janar 2010,



Qarku i Durresit raporton me nje popullsi prej 310.499 banore, ku 181.790 ose 58% banojne ne zonen urbane, dhe 128.709 ose 42% banojne ne zonen rurale (burimi INSTAT).

Rajoni i Durresit shtrihet ne qender te Ultersires Perendimore te Shqiperise, perbehet nga dy rrethe: Durresi dhe Kruja, eshte i organizuar ne 6 bashki dhe 10 komuna. Siperfaqja: 766 km² Popullsia :389.283 banore Dendesia e popullise: 507.9 banore /km²

Institucione shendetesore: 370 (41 neper bashki dhe 329 ne komuna) Shkolla:196 (73 kopshte, 95 shkolla 9-vjecare, 28 shkolla te mesme)

Qarku i Durresit pershkohet nga keto lumenj: Erzen, Ishem, Terkuze, Zeza, Droja. Ne te ndodhet vargu malor Kruje-Dajt (Kruje, Brret, Rodhes, Gamit,), vargu malor Skenderbeu dhe mali i Durresit.

Qarku i Durresit ka keta tregues demografike per periudhen 2005-2009

Popullsia Familjet										
	<i>Popullsia</i>					<i>Familje</i>				
	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009
Qarku Gjithsej	389283	392264	402943	409058	414892	94656	96296	96751	100616	102243
Durres	312656	314684	324616	329603	334871	76053	77480	77734	81360	82838
Kruje	76627	77580	78327	79455	80021	18603	18816	19017	19256	19405

Sipas rretheve, bashkive dhe komunave perkatese rezulton shperndarja e popullise si vijon:

Popullsia Familjet										
	<i>Popullsia</i>					<i>Familje</i>				
	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009
Qarku Gjithsej	389283	392264	402943	409058	414892	94656	96296	96751	100616	102243
Durres	312656	314684	324616	329603	334871	76053	77480	77734	81360	82838
Kruje	76627	77580	78327	79455	80021	18603	18816	19017	19256	19405
Rrethi Durres gjithsej	312656	314684	324616	329603	334871	76053	77480	77734	81360	82838
Bashkia Durres	189648	189648	197699	200311	203547	45915	46617	46119	48433	49290
Bashkia Shijak	12698	12698	12840	12893	12902	4344	4354	4373	4375	4381
Bashkia Sukth	23350	24139	24598	25139	25767	5451	5720	5934	6367	6508
Bashkia Manze	10377	10555	10757	10952	11002	1900	1922	1941	2203	2313
Komuna Katundi i Ri	15604	15480	15488	15665	15613	3986	4161	4260	4380	4421
Komuna Rrashbull	25143	25642	26099	26903	27645	5904	5983	6187	6462	6594
Komuna Gjepalaj	5823	5850	5849	5892	5924	1344	1360	1359	1413	1435
Komuna Xhafzotaj	15586	15988	16387	16723	17120	3725	3825	3984	4025	4089
Komuna Ishem	7955	8105	8201	8317	8428	1955	2004	2024	2142	2229
Komuna Maminas	6472	6579	6698	6808	6923	1529	1534	1553	1560	1578
Rrethi Kruje	76627	77580	78327	79455	80021	18603	18816	19017	19256	19405
Bashkia Kruje	15657	15753	15829	16020	16051	4121	4131	4155	4246	4251
Bashkia F-Kruje	22898	23277	23671	24122	24519	5684	5804	5951	6107	6225
Komuna Bubq	7760	7840	7918	8020	8142	1831	1833	1868	1870	1881
Komuna Nikel	10035	10334	10499	10772	10921	1958	1967	2087	2087	2121
Komuna Thumane	16472	16612	16784	16945	16954	3955	3959	3977	3977	3984
Komuna Cudhi	3805	3764	3626	3576	3434	1054	1122	979	969	943

4.3. Pozicioni Gjeostrategjik

Porti i Durrësit, një ndër më të rëndësishmit e brigjeve të Adriatikut Lindor, ndodhet në Gjirin me të njëjtin emër. Ai, sigurisht nxjerr në pah të gjitha vlerat e vendodhjes gjeo- strategjike të Shqipërisë, si një nga urat lidhëse të Ballkanit që lehtëson lëvizjen e pasagjerëve dhe mallrave drejt dhe nga kontinentit European. Në fakt, në këtë port kryqëzohen të gjitha rrugët tokësore, hekurudhore dhe detare nga Shqipëria drejt vendeve fqinje padalje në det, përkatësisht, Kosova dhe Maqedonia.

Korridorit 8, i cili do të përfundojë brenda vitit 2028, lidh rajonet Adriatiko Joniane me vendet e Ballkanit dhe në Detit të Zi. Ai është një sistem transporti multi-modal përgjatë aksit Lindje-Perëndim duke përfshirë porte detare dhe lumore, aeroporte, rrugët tokësore e hekurudhore në një zgjatje totale prej 1270 km hekurudhë dhe 960 km rrugë tokësore. Itinerari kryesor i ndjekur prej tij është aksi Bari-Brindisi-Durrës-Tiranë-Shkup- Burgas- Varna. (Ka gjithashtu degë që të çojnë në Greqi dhe nëpërmjet Korridorit 4 në Turqi). Në ditët e sotme, një rrugë ekzistuese në kushte të mira, lidh Durrësin me Shkupin.

Rruga e Arbërit do të lidhë Tiranën dhe portin e Durrësit me vendet lindore të Shqipërisë, si Peshkopi, Dibër e Mat, e gjithashtu me vendet fqinje si Maqedoni, Bullgari, etj. E konsideruar si një alternative ose degë e Korridorit 8, ajo tashmë është një nga prioritetet e sektorit rrugor të Qeverisë shqiptare.

Rruga Durrës-Morinë, a mbaruar në verë të vitit 2010, rrit në mënyrë të konsiderueshme shkëmbimet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, veçanërisht në fushën e turizmit dhe tregtisë. Kjo rrugë, e lidhur me Korridorin 10 në Nish, hap një mundësi të re edhe për lëvizjen e mallrave drejt nga Rumania e Bullgaria.

Korridorit Veri-Jug i Shqipërisë, në gjatësinë 405 km nga Hani i Hotit në Kakavijë, kalon nëpër Durrës. Ai sigurisht lidh Portin e tij me vendet e Greqisë, Malit të Zi si dhe vendet e tjera të Europës Lindore-Qendrore.

Lidhjet hekurudhore

Stacioni Qendror Hekurudhor i Shqipërisë ndodhet pranë Portit të Durrësit dhe ka një lidhje direkte me të. Duke vazhduar nga Porti, hekurudha arrin në Mal të Zi dhe nga atje në Rrjetin Hekurudhor European. Përveç lidhjes hekurudhore ndërmjet porteve të Durrësit dhe Vlorës, është dhe një degë tjetër që përshkon hapësirën ndërmjet Durrësit dhe Shkupit. Mungon vetëm njëgjatësi rreth 30 km në anën maqedonase për të kompletuar lidhjen hekurudhore ndërmjet këtyre dy qyteteve.

Sikurse e tregon dhe tabela e distancave, Porti i Durrësit ka shanse të mira për të kapur një pjesë në rritje të tregut të Kosovës dhe Maqedonisë në shkëmbimet me Europën, në garën ndërmjet tre porteve me të afërt nga këto dy vende.

PORTI <i>PORT</i>	SHKUP <i>SKOPJE</i>	PRISHTINE <i>PRISTINA</i>
DURRËS <i>DURRES</i>	me tren -120 km - by rail me tokë - 200 km - by road	me tren - 220 km - by rail me tokë - 230 km - by road

SELANIK <i>THESSALONIKI</i>	me tren - 225 km - by rail	310 km me tren / 310 km by rail
BAR <i>BAR</i>	me tren - 715 km - by rail	me tren - 630 km - by rail

c) Linja trageti

Ka katër linja tragetesh, të cilat lidhin Portin e Durrësit me Portet e Barit, Ankonës, Triestes (Itali) dhe Koperit (Slloveni). Ato transportojnë kamionë, konteniere, makina dhe njerëz, nga dhe në Shqipëri, dhe mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të trafi kut total nëpërmjet Portit. Në të ardhmen e afërt pritet të hapen linja të reja, që do të lidhin *Portin me Brindisin (Itali), Stambollin (Turqi), Rijeka (Kroaci), Bar (Mal i Zi)* dhe ndonjë tjetër.

Karakteristikat kryesore / Main carateristics-features			
Pozicioni -41° 19' N / 19° 27' E - Position E		Thellesia e kalates -6.6-11.15 m - Quay depth	
Hapësira tokësore -1,200,000 m² - Land	area	Gjatesia max e anijes -220 m	-Maximal ship length
Akuariumi 670,000 m² - Aquarium		Zhytja max e anijes -8.5 m	-Maximal ship dive
Kalata funksionale - 11 - Operational quays		Kapaciteti i siloseve te grurit -1,500 ton -Grain silos capacity	
Gjatesia e kalatave -2.2 km	Quays' length	Magazinat - 15.000 m²	-Depos

a) Porti i Durrësit përfaqëson kontaktin më të madh të tregtisë ndërkombëtare shqiptare. Nga aty nisen anije me ngarkesë të lëngshme dhe të thatë, në sasi të mëdha dhe të shumëllojshme. Ai është gjithashtu i hapur ndaj kontenierëve, anijeve roll-on, roll-off dhe të pasagjerëve. Fuqia e tij punëtore është e aftë të operojë çdo lloj ngarkese, me një kosto më të ulët se portet e tjera konkurruese.

Porti tashmë mbulon 77% të importeve dhe 89% të eksporteve shqiptare; kjo është e barabartë me 78% e tregtisë totale detare në nivel kombëtar. Ndërkohë, Durrësi është kryesisht i orientuar nga importi, ku qarkullimi i brendshëm zë 91% të vlerës totale.

b) Mallrat kryesore të importit janë: gruri, mielli, sheqeri, çimento, klinkeri, ngarkesat e kontejnerizueshme, nafta, vajguri, benzina, materialet e ndërtimit dhe kimikatet. Partnerët kryesorë të importit janë: Italia, Greqia, Libani, Turqia, Kroacia, Rusia, Ukraina, Spanja, etj.

c) Mallrat kryesore të eksportit janë: ferrokromi, mineralet e kromit, skrapi dhe ngarkesa të tjera të ndryshme. Partnerët kryesorë të eksportit janë: Italia, Greqia, Rusia, Kina, Ukraina, Suedia, Spanja, etj. Kompania Royal Haskoning ka skicuar tashmë Master Planin e Portit të Durrësit. Sipas këtij projekti, në vitin 2020, Porti i Durrësit do të qarkullojë 8.2 milion ton mallra, 1.9 milion pasagjerë, 140 mijë kamionë dhe 350 mijë autovetura.

Këto parashikime përfshijnë edhe disa ndryshime të reja të performancës së tij për dy vitet e ardhshme:

- ◆ Një vendosje dhe përdorim mjaft i përmirësuar i të gjithë asetëve ekzistuese të portit.
- ◆ Thellimi i basenit dhe i kanalit hyrës për anije deri 30000 GTW
- ◆ Ndërtimi i Terminalit të Pasagjerëve.
- ◆ Investime të konsiderueshme nga kompani private, të cilat do të marrin me koncesion të gjitha shërbimet portuale.

(Qyteti) Durrës shtrihet në pjesën perëndimore të Rrethit të Durrësit (33 km në perëndim të kryeqytetit Tiranë) në koordinatat e mëposhtme 41° e 18' e 40' gjerësi gjeografike veriore dhe 19° e 26' e 21' gjatësi gjeografike lindore duke mbuluar një sipërfaqe prej 1,626 hektarë.

Vija e përgjithshme kufitare është 121,3km (52,4 km kufinj tokësorë, 61,8 km kufinjë detarë dhe 7,1 kufinjë lumorë). Kufizohet me Tiranën e Krujën në lindje e verilindje e Kavajën në jug e juglindje e me Detin Adriatik në perëndim.

Durrësi, me një popullsi mbi 200 mijë banorë, është qendra e Qarkut më të njëjtin emër, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 740 km², ku banojnë e punojnë mbi 400 mijë banorë. Ai krijon hapësirë veprimi për rreth 10,000 sipërmarrje private, të cilat tradicionalisht vërtiten rreth 3 T-ve, Tregti-Transport-Turizëm.

Por është i ndjeshëm edhe kontributi i sektorit të ndërtimeve urbane, tregtare, industriale e turistike, i prodhimit industrial dhe agroushqimor, ai i peshkimit me flotiljen më të madhe në vend, si dhe i shërbimeve të tjera. Qarku i Durrësit, me një klimë të favorshme biznesi për këdo, arrin të japë mbi 10 % të PBB të gjithë vendit.

Ju, që dëshironi të investoni në Durrës, duhet të dini se zhvillimi ekonomik i ardhshëm i tij mbështetet në tri pikat e forta të tij: vendndodhja gjeo-strategjike, vija bregdetare dhe trashëgimia kulturore.

Përgjithësisht vendndodhja gjeostrategjike e Shqipërisë vlerësohet si një nga kryeurat ballkanike të komunikimit të Lindjes me Perëndimin e anasjelltas.

Dhe, me siguri, rajoni i Durrësit, përfaqëson thelbin e saj. Ai është pjesë e metropolit më të madh shqiptar, zona Tiranë-Durrës, ku jetojnë dhe operojnë afro 1 milion banorë. Me aeroportin "Nënë Tereza" dhe Portin e tij në territorin e tij, Qarku i Durrësit është pikërisht kryqëzimi i të gjitha rrugëve tokësore, hekurudhore dhe detare, të cilat mundësojnë lidhjen e tij me të gjithë pjesët e tjera të vendit, me vendet fqinje, si dhe me pjesën tjetër të botës.

Vlen të përmendim këtu rrugën Durrës- Prishtinë. Kjo rrugë do të sjellë zhvillime të rëndësishme për turizmin dhe shkëmbimet tregtare. Lidhja e saj me Korridorin 10 në Nish dhe më tej në Rumani, Bullgari, e gjetkë, e bën këtë arter, mjaft tërheqës dhe me perspektivë për Kosovën, për Shqipërinë dhe vetë rajonin e Europës Juglindore.



Vija bregdetare me gjatësi 62 km ofron plazhe të shumta si dhe disa vende natyrale për porte. Plazhi i Durrësit, me gjatësi 7 km, i shtrirë nga Ura e Dalanit deri tek Prroi i Agait, përfaqëson sot destinacionin më të rëndësishëm të turizmit për Shqipërinë. Me rërën e butë e të bardhë, thellësinë graduale të detit, me mbi 100 hotele të cilësisë si dhe qindra apartamente, ai arrin të presë rreth 150 mijë pushues, vendas e të huaj, në ditët e pikut të tij.

Dy zona të virgjëra bregdetare presin zhvillime të reja: zona Kallmet- Porto

Romano, rreth 5 km e gjatë dhe ajo e Ishmit, rreth 15 km. Studimet e bëshmerisë së këtyre zonave kanë ngjallur interesin e investitorëve vendas dhe të huaj, të prirë ndaj turizmit të klasit të mesëm dhe atij elitari.

Në gjirin e Durrësit ndodhet Porti, një nga më të rëndësishmit e bregut të Adriatikut Lindor. Me një lëvrim të 3.5 milion ton mallrave konvencionale në vitin 2007, ai ka mbuluar 77% të importeve dhe 89% të

eksporteve shqiptare. Po në këtë vit, rreth 770 mijë pasagjerë, 170 mijë vetura dhe 63,5 mijë kamionë kanë lëvizur nëpër të me anë të trageteve. Së afërmi, kompanitë private *do të marrin në koncesion* të gjitha shërbimet, do të përfundojë *Terminali i Pasagjerëve* dhe *Sheshi i Kontejnerëve* do të ketë një zgjerim të konsiderueshëm.

Zhvillime të reja dhe tepër ambicioze janë projektuar në Durrësin Verior, të cilat investitorët potencialë, vendas dhe të huaj, duhet t'i njohin:

- Terminali i produkteve të naftës, i volitshëm për tankera deri 20.000 ton, me kapacitet vjetor 140.000 m³ produkte naftë dhe 14.000 m³ gaz i lëngshëm. Përfundon në fillim të vitit 2009.



- Parku Energjistik, i miratuar nga Qeveria në një sipërfaqe prej 550 ha, ku pritet të ngrihen prodhues të energjisë elektrike si dhe përpunues të produkteve të naftës.

- Parku Industrial, i miratuar në një sipërfaqe prej 850 ha, ku do të zhvillohen veprimtari industriale, tregtare e logjistike.

Porti i Ri, i cili është akoma në studim, parashikohet të ndërtohet në Gjirin e Ishmit. Me një shtrirje bregdetare deri në 5 km, ai do të ketë një kapacitet lëvrimi të mallrave konvencionale rreth 3 herë me të madh se ai i Portit Durrës, ekzistues. Ndërtimi i tij hap perspektiva krejt të reja edhe për transportin me kontenerë, si dhe krijimin në Portin ekzistues të bankinave të reja të lira për anijet e lundrimit sportiv.

Historia

4.4. Arsimi

- Arsimi Parashkollor Te dhenat tregojne se ne Qarkun e Durresit ka mesatarisht 5.5 kopshte per çdo bashki dhe 6.3 kopshte per çdo komune, duke mbuluar jo vetem qendrat e komunave por edhe pjesen dermuese te fshatrave. Ne arsimin parashkollor mbizoteron ai publik, i cili aktualisht mbulon 93.2% te numrit te pergjithshem te kopshteve ne te cilet edukohen 95.7% e gjithe femijeve qe i frekuentojne ato. Femijet ne keto kopshte edukohen nga 276 edukatore, nga te cilet 138 jane me arsim te larte, dhe mesatarisht per çdo 20 femije sherben nje edukatore.
- Arsimi 9 vjeçar Ne shkollat 9 vjeçare, te shtrira ne gjithe Qarkun e Durresit, mesojne 43193 nxenes. Ne dispozicion te nxenesve jane 2210 mesues, pra mesatarisht 1 mesues per çdo 19-20 nxenes. dhe 1655 klasa mesimore. Theksojme se me pak se 5% e nxenesve ndjekin arsimin 9 vjeçar jopublik, pra mbi 95 % e nxenesve ndjekin ate publik.
- Arsimi i mesem

Ne sistemin e arsimit te mesem jane te regjistruar 13395 nxenes, nga te cilet 1123 ne 11 shkollat jo publike, qe jane te perqendruara ne Bashkine e Durresit, ndersa 12272 ne 22 shkollat publike qe shtrihen ne te gjitha qarkun. 10257 nxenes ndjekin arsimin e mesem te pergjithshem, ndersa pjesa tjeter ate profesional. Ne dispozicion te 13395 nxenesve jane 615 mesues, pra mesatarisht 1 mesues per çdo 21-22 nxenes.

- Arsimi i larte Ne Universitetin A.Moisiu çdo vit regjistrohet nje numer gjithnje e ne rritje i studenteve qe vijne jo vetem nga Qarku i Durresit.

4.5. Sherbimi shendetesor

Ne Qarkun e Durresit sherbimi shendetesor eshte i shtrire ne te gjitha komunitat e bashkites. Ne pasqyrat ne vijim jepen te dhena per numrin e qendrave shendetesore, ambulancave, konsultoreve, spitaleve e materniteteve si dhe numrin e vizitave dhe personelit mjekesor qe sherben ne to.

Numri i institucioneve shendetesore publike per vitin 2011				
		Rrethi	Nga:	numer
Nr	Emertimi	gjithsej	Bashki	Komune
1	Numri institucioneve gjithsej	290	33	257
	- Qendra shendetesore	46	15	31
	- Ambulanca	87	0	87
	- Poliklinika	3	3	0
	- Konsultori i gruas	118	6	112
	- Konsultori i femijes	127	15	112
2	Numri i vizitave gjithsej	662555	442389	220166
	- Qendra shendetesore	299414	215340	84074
	- Ambulanca	101726	38890	62836
	- Poliklinika	97192	85370	11822
	- Konsultori i gruas	25245	12960	12285
	- Konsultori i femijes	121868	89829	32039
3	Personel mjekesor	1135	820	315
	- Mjeke	165	154	11
	- Mjeke te familjes	170	104	66
	- Infermier e mami	800	562	238

4.6. Trashegimi kulturore

Në Durrës kryqëzohet historia e gjithë Shqipërisë. Disa paketa të operatorëve turistikë ofrojnë shëtitje të guiduara në Durrës dhe Krujë, me anë të cilave vizitori mund të shohë monumente dhe dëshmi të shumta të trashëgimisë kulturore të periudhave pellazgjike, ilire, greke, romane, të mesjetës e të kohëve të reja.

I njohur si një “muze i hapur”, Durrësi është tashmë një destinacion i pashmangshëm për të gjitha nivelet e interesit ndaj turizmit kulturor në Shqipëri.



Durrësi është qyteti më i lashtë i Shqipërisë. U themelua mbi një vendbanim prehistorik të fi sit ilir të Taulantëve, nga dy mbreterit ilirë Dyrrah dhe Epidamn, me emrat e të cilëve është njohur dhe vetë qyteti gjatë gjithë kohës antike, shek.VIII-I p.e.s. Emri Dyrrah përfaqëson limanin e parë, ndërsa Epidamn qytetin e sipërm, Akropolin.

Qyteti mbijetoi gjatë shek VIII-II p.e.s. me emrin ilir Dyrrah, si kryeqendër e mbretërve Glaukia, Monun, Mytil, me një lulëzim të gjithanshëm të kulturës qytetare ilire.

Gjatë periudhës romake (shek.I-IV pas.e.s.) merr emrin Dyrrachium. Ndërhyrjet e perandoreve, si Trajan (97-117) dhe Adrian (117-138) i dhanë atij një fi zionomi të ngjashme me qytetet romake. Ndërtimet me karakter mbrojtës, ndërtesat shoqërore dhe ato të kultit u pasuan me amfi teatrin, teatrin, bibliotekën, odeonin, gjimnazin, termat, stadiumin, ujësjellësin, rrugën Egnatia, kanalizimet.

Nuk mungonin dhe objektet mbivarrore (stele, altare dhe sarkofage), ndërsa godinat private zbukuroheshin me dysheme të shtruara me mozaik, bardhë e zi dhe polikrom.

Feja e krishterë përqafohet herët në qytet, që me predikimet e Shën Palit.

Njihet dhe martiri i parë, Shën Asti, i ekzekutuar në kohën e Trajanit.

Dyrrahu bëhet kryeqendra e Provincës e Epirit të Ri, duke qenë një qytet i rëndësishëm dhe një nga portet më në zë të Perandorisë Bizantine. Fuqi të madhe arriti qyteti në kohën e perandorëve Anastas I (491-518), me origjinë nga ky qytet, si dhe Justinian I (527-565). Qendër e rëndësishme administrative, politike, ushtarake dhe kishtarë, ai dallohej për sistemin mbrojtës, rrethuar me tri radhë muresh dhe për ndërtesa madhështore private apo social-kulturore. Qyteti, me disa punishte shtetërore për prodhimin e armatimit, me një kantier të fuqishëm ndërtimi anijesh, kishte të gjitha tiparet e një qendre të zhvilluar zejtaro-tregtare. Dallohej për një rrjet të përsosur kanalizimesh, ndërsa kishte dhe një hipodrom, tregues i qyteteve të mëdha të kohës.

Bazilika e Shën Mëhillit në Arapaj, me një mozaik shumë të bukur, është një dëshmi e fuqizimit të fesë së krishterë. Në vitin 1392, Durrësi pushtohet nga Venediku, i cili e zotëroi qytetin për gati 109 vjet. Për Republikën e San Markut, Durrësi ishte një pikë strategjike me rëndësi për kontrollin e tregtisë së saj në detin Adriatik, për fuqinë ekonomike që kishte porti i tij, si dhe për kriporet e pasura.

Të shumta qenë konsullatat e huaja në qytet. Presioni i qytetit autonom, i mësuar të gëzonte statusin “Komunë e lirë qytetare” dhe rreziku i dukshëm i turqve e detyroi Venedikun të marrë masa për sistemin mbrojtës të qytetit. Të tilla janë ndërtimi i Torrës Veneciane dhe fortifi kimet e kështjellës së sipërme. Interesante është kërkesa e vendasve, e vitit 1471, që qyteti të kthehet në ishull, për të rritur tashmë sigurinë e qytetit. Figurë e njohur e kësaj periudhe është peshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli, një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Skënderbeut, i zgjedhur prej tij anëtar i Këshillit të Lartë dhe i ngarkuari i misioneve diplomatike.



shqiptarësh.


Personalitet laik e fetar, ai ka meritën e formulës së pagëzimit në gjuhën shqipe (1462), që u lehtësonte prindërve të pagëzonin fëmijët e tyre të porsalindur, në rast mungesë të priftit.

Në gusht 1501 qyteti u pushtua nga Turqit, të cilët rënien e Durrësit e kanë quajtur si një *Kostandinopojë të dytë*. Por, ata e ngushtuan qytetin e dikurshëm, duke e kthyer në një garnizon ushtarak, në një fortesë strategjike. Nga një qytet me 60 mijë banorë para pushtimit, ai u zvogëluar në një qendër të mjeruar me jo më shumë se 2 mijë banorë. Shumë prej tyre morën rrugën e emigrimit, përtej Adriatikut, si në Kroaci, Slloveni, Itali, etj, ku krijuan ngulime të reja

Vetëm pas dy shekujsh Durrësi e rimori veten, duke konkuruar me porte në zë si Selaniku dhe Ragusa. Në magazinat tranzite të tij grumbulloheshin mallra nga Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria e Serbia, për t'u dërguar më pas përtej Adriatikut, në Venedik, Mesinë, Ankona. Ishte e natyrshme të shihje të ankoruara në skelën e Durrësit anije të Francës, Holandës, Raguzës, Venedikut, Anglisë, etj., e për pasojë të hapeshin në qytetin e Durrësit zyrat konsullore të këtyre vendeve. Ndër të parat që Republika e Shën Markut (Venediku). Nga fundi i shek.XVIII, skela e Durrësit frekuentohej nga 694 anije të huaja, me një tonazh të përgjithshëm afro 280 mijë ton. Që në këtë kohë Durrësi kishte edhe Rregjistrin Detar. Në fillim të shek.XX Durrësi ishte një qendër e rëndësishme e Lëvizjes Patriotike, që ka si moment kulmor ngritjen e fl amurit kombëtar më 26 Nëntor 1912, datë pararendëse e shpalljes së pavarësisë së gjithë Shqipërisë.

Në periudhën mars-shtator 1914 Durrësi bëhet kryeqytet i Mbretërisë Shqiptare, me në krye Princ Vidin, të caktuar nga Fuqitë e Mëdha. Kjo është koha e njohjes de jure të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare. Gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut, Durrësi njohu disa përparësi zhvillimi ekonomik, si dhe investime të konsiderueshme vendase dhe të huaja. Shumë nga ndërtimet e kësaj periudhe ndodhen në ditët e sotme në pjesën "Qyteti i Vjetër".

Në teatrin e Luftës së Dytë Botërore Shqipëria u rradhit në anën e shteteve të Koalicionit Antifashist. Qyteti i Durrësit ka dëshmorët e tij në këtë luftë, ndërsa 14 Nëntor 1944 është dita e çlirimit të tij. Edhe në periudhën e diktaturës komuniste, Durrësi ka qenë qyteti i dytë më i zhvilluar i vendit dhe porti më i rëndësishëm i tij.




4.7. Qarku Tirane

Qarku i Tiranës ofron mundesi dhe burime te ndryshme për qytetaret e tij, qe ata te arrijne nje standart jetese dhe mireqenie te caktuar. Ky nivel jetese, ne kete qark, ne baze te treguesve te ndryshem është krahasimisht me i mire se ne shume nga qarqet e tjera te vendit. Mundesite e ofruara, ne qarkun e Tiranës, krijojne lehtesi ne aksesin e vendeve te punes, ne krijimin e te ardhurave financiare, ne edukim dhe mundesite për kualifikim, si dhe ne pjesemarrjen ne rrjetet dhe aktivitetet sociale. Dimensioni social ne qarkun e Tiranës shprehet edhe me mundesite qe ekzistojne ne kete qark për te ofruar kushte te mira jetese edhe për shtresat dhe grupet e ndryshme shoqerore

Në territorin e qarkut të Tiranës bëjnë pjesë 29 njësi vendore, nga të cilat 5 janë bashki dhe 24 komuna.

Bashki	Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë
Komuna	Bërshull, Baldushk, Bërzhit, Kashar, Ndroq, Paskuqan, Prezë, Pezë, Petrelë, Farkë, Shëngjergj, Zall-Herr, Zall-Bastar, Dajt, Krrabë, Vaqarr, Golem, Gosë, H elmës, Kreyvidh, Lekaj, Luz i Vogël, Sinaballaj, Synej

Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë dhe njëkohesisht përfaqeson bashkinë më të madhe në vend, përta i takon numrit të popullsisë




4.7.1 Karkarakteristikat natyrore

Qarku i Tiranës shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë në një lartësi që varion nga disa metra mbi nivelin e detit deri në 1,828 metër, që përfaqësohet nga maja më e lartë e Malit me Gropa. Qarku ka një territor prej 1,652 km² (165,200 ha tokë) dhe renditet i dhjeti, përta i takon madhësisë së sipërfaqes, në listën e 12 qarqeve të Shqipërisë.

Qarku i Tiranës, në pjesën e tij përfundimtare, ka një vijë bregdetare me detin Adriatik, me gjatësi 33 km, ndërsa në veri kufizohet me qarkun e Durrësit, në verilindje me Dibërën, në juglindje me Elbasanin dhe në jug me qarkun e Fierit. Relievi i qarkut të Tiranës është një kombinim i larmishëm i zonës malore me zonat

e ulëta fushore dhe zonat bregdetare. Duke ju referuar shtrirjes gjeografike, zona malore e Tiranës është e vendosur kryesisht, në verilindje, në kufi me qarkun e Dibrës dhe në pjesën juglindore, që kufizohet me qarkun Elbasan. Në këtë pjesë gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit. Ky park është i vendosur në lindje të kryeqytetit, në distancën 23 km larg dhe zë një sipërfaqe prej 3,300 hektarësh. Maja më e lartë e Dajtit arrin në lartësinë 1,612 metra mbi nivelin e detit. Në Parkun Kombëtar të Dajtit, në shpatin përendimor të malit, gjendet pjesa e quajtur Ballkoni i Tiranës që shtrihet në lartësinë 1,000 metra mbi nivelin e detit dhe është e gjatë 2 km.



Po në lartësinë 1,000 metra mbi nivelin e detit gjendet edhe rrafshina e Bizës e cila është pjesë e Malit me Gropa (1,828 m). Në këtë zonë gjenden formacione / gropa karstike që krijojnë peisazhe të mrekullueshme. Në pjesën e parkut kombëtar shtrihet edhe Mali i Priskës (1,353 m) që së bashku me Malin e Dajtit mbulojnë një zonë prej 29,216 hektarë. Në zonën malore të qarkut të Tiranës gjenden edhe qafa e Priskës me lartësi 850 m dhe qafa e Kërrabës me lartësi 933 metra mbi nivelin e detit.

Zona fushore e qarkut të Tiranës shtrihet në pjesën jugore dhe jugpërendimore të tij, në kufi me qarkun e Fierit dhe atë të Durrësit. Kjo zonë ndodhet kryesisht në territorin e bashkisë së Vorës, Kavajës, Rogozhinës si dhe në komunat që janë vendosur rreth këtyre bashkive. Ndërsa zona bregdetare fillon nga Golemi dhe vazhdon deri në fshatin e Spillesë, që gjendet në komunën e Kryevidhit.

Në territorin e qarkut të Tiranës gjenden edhe disa lumenjë dhe liqene. Lumenjtë kryesor që përshkojnë territorin e qarkut janë Lumi Erzen, Ishëm, Shkumbin dhe Lumi i Tiranës, i cili gjatë rrjedhës së tij përshkon edhe qytetin e Tiranës me degën e tij të quajtur Lumi i Lanës. Lumi Erzen buron nga Mali me Gropa, prapa vargmalit të Dajtit. Në pjesën e sipërme të rrjedhës së tij, që kalon nëpër Shëngjergj dhe më tej në zonën e Pëllumbasit ai ndërpret shkëmbinjtë karbonatikë dhe krijon një luginë të thellë e shumë piktoreske me

kanione shumë të ngushta. Ndërsa Lumi i Ishmit krijohet nga bashkimi i Lumit të Tiranës dhe ai i Tërkuzës dhe së bashku me Erzenin përbejnë Basenin uhor Ishëm – Erzen me një sipërfaqe prej 2,200 km².

Në qarkun e Tiranës liqenet janë liqene artificiale të krijuara nga njeriu: Liqeni artificial i Tiranës, Liqeni në Kodër-Kamëz, Liqeni i Farkës, Liqeni i Tufinës. Liqenet dhe lumenjtë krijojnë një peisazh të larmishëm dhe përbejnë një potencial për të krijuar ambiente pushimi dhe argëtimi, për qytetarët e qarkut të Tiranës dhe më gjerë.

4.7.2. Zhvillimi Demografik

Popullsia e Shqipërise nga censusi i vitit 2011 rezultoi 2,800,138 banorë. Në qarkun e Tiranës jetojnë 763,634 qytetarë, që përbëjnë rreth 26,96 % të popullsisë së vendit. (INSTAT, Censusi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2011, f 17). Raporti gjinor është pothuajse i barabartë me një vlerë pak më të madhe për femrat, rreth 50,3 % femra dhe 49,7 % meshkuj.

Viti	2001	2008	2011
Popullsia	597,899	793,037	736,634

Gjatë dekadës së fundit, situata demografike në qarkun e Tiranës, ka ndjekur një drejtim të caktuar dhe mjaft të dukshëm, rritjen e vazhdueshme të popullsisë. Bazuar në shifrat e marra nga institucione të ndryshme si INSTAT dhe njësite vendore, komuna dhe bashki të këtij qarku është evidente se rreth 1/3 e popullsisë së Shqipërisë jeton në territorin e qarkut të Tiranës. Krahas rritjes natyrore, faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e popullsisë së qarkut të Tiranës është migrimi i brendshëm, ardhja e banorëve nga të gjitha zonat e vendit dhe vendosja e tyre në këtë qark. Ritmet e rritjes së popullsisë kanë qënë më të larta nga viti 2001 deri në 2006 dhe ka një ulje të këtij ritmi nga 2007 deri 2009. Pas këtij viti, ka patur një stabilitet në lëvizjen e popullsisë dhe vendosjen e tyre në qarkun e Tiranës. Përqindja më e lartë e të ardhurve në komunat

dhe bashkitë e qarkut të Tiranës janë kryesisht nga zonat verilindore si Dibra, Kukësi, Librazhdi, por ka edhe nga Berati, Skrapari, Mallakastër, Përmeti dhe pjesë të tjera të Shqipërisë.

4.7.3. Ekonomia

Ne qarkun e Tiranës sektori që ka peshe më të madhe në ekonomine e qarkut është sektori i shërbimeve dhe tregëtisë, me pas vjen ndertimi dhe transporti.

Ne nivel vendi, numri më i madh, 38,7% e ndërmarrjeve aktive operojnë në qarkun e Tiranës, kjo sipas buletinit të METE (2010, fq 39). Me pas vjen qarku i Durrësit me 11,8% të ndërmarrjeve dhe në vendin e tretë ndodhet qarku i Fierit me 8,9% të ndërmarrjeve. Qarku i Tiranës zë vendin e parë, në nivel kombëtar përse ai takon numrit të ndërmarrjeve jo bujqësore aktive në të gjitha sektorët me përjashtim në Bujqësi dhe Peshkim. Në këto sektorë Tirana zë vendin e tretë pas qarkut të Durrësit dhe të Shkodrës.

Numri më i madh i ndërmarrjeve aktive që operojnë në qarkun e Tiranës është në sektorin e shërbimeve me 41% të ndërmarrjeve që operojnë në të gjithë vendin. Sektori i dytë me numrin më të lartë të ndërmarrjeve është sektori i ndertimit me 39,5 % të ndërmarrjeve dhe sektori i tretë është prodhimi me 33,3% të numrit të ndërmarrjeve në nivel vendi.

Në nivel qarku, numrin më të madh të bizneseve e ka bashkia e Tiranës me 29,490 biznese ose 72% të të gjithë bizneseve që operojnë në qarkun e Tiranës. Po kështu në bashkitë e tjera të qarkut janë të përqëndruar një numër i konsiderueshëm i bizneseve si në bashkinë Kamzës me 1,800 biznese, bashkinë e Kavajës 828 biznese, dhe bashkinë e Vorës 749 biznese (Pyetesoret e njësiteve vendore, 2012).

4.7.4. Punesimi

Qarku i Tiranës ofron mundësi të shumta punësimi në krahasim me qarqet e tjera të vendit. Megjithatë për shkak të numrit të madh të popullsisë, niveli i papunësisë është relativisht i lartë. Kështu në këto qark në

tremujorin e pare te 2012, niveli i papunesise ishte 15,5 % ndersa ne nivel kombetar ishte dhe 13,8% (INSTAT, Buletini Statistikor Tremujor 2012, fq 10).

Bujqesia dhe zhvillimi Rural

Bujqesia është një sektor i rëndësishëm për ekonominë e qarkut të Tiranës dhe për zhvillimin rural të kësaj zone. Për të theksuar rëndësinë e këtij sektori mjafton të përmendim faktin që, në nivel qarku 56,9% e të punësuarve janë në sektorin bujqësor, shifer kjo që është relativisht më e lartë se niveli kombëtar i cili është 43,7% (INSTAT, Anketa e Forcave të Punës, fq 3).

Qarku i Tiranës renditet i dhjetë përta i takon sipërfaqes që ze në nivel vendi me 165,200 ha. Nga gjithë sipërfaqja, toka bujqësore është 56,609 ha, e shprehur në përqindje është 34,2% (MBUMK, Vjetari statistikor 2010, fq 14). Në nivel vendi 24% e tokës është klasifikuar si toke bujqësore, ndersa pjesa tjetër është e ndarë përkatsisht në 36% pyje, 15% kullota dhe 25% të tjera (INSTAT, 2010, Shqipëria në Shifra, fq. 48). Megjithatë qarku i Tiranës nga sipërfaqja e përgjithshme ze vendin e dhjetë, nga sipërfaqja e tokës bujqësore ze vendin e pestë, pas Fierit, Korçës, Elbasanit dhe Vlores. Ky fakt tregon për potencialin e lartë që ka qarku i Tiranës për zhvillimin dhe intensifikimin e sektorit të bujqësisë.

Qarku i Tiranës ka toke bujqësore 56,609 ha ose 34,2% nga 165,200 ha që ka gjithsej. Përta i takon sipërfaqes të tokës bujqësore qarku i Tiranës ze vendin e pestë pas qarkut të Fierit, Korçës, Elbasanit dhe Vlores. Në nivel kombëtar toka bujqësore ze një sipërfaqe prej 696,000 ha ose 24% kurse totali (bujqësore dhe jo bujqësore – pyje, kullota etj) është 2.875.000 ha.

Qarku i Tiranës ka një kapacitet të lartë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Kështu në këtë qark përpunohet 56% e sasisë së qumështit në nivel vendi, 15 % e gjalpinit dhe 70% e sallamit. Ky qark përben edhe tregun më të madh të konsumit të këtyre produkteve si rezultat i numrit të madh të popullsisë që jeton në këtë zonë.

4.8. Bashkia Kavaje

4.8.1. Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Kavaja kufizohet në veri nga bashkia Durrës, në lindje nga bashkia Tiranë, në jug nga bashkia Rrogoshinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kavajës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Kavaja numëron një popullsi prej 40,094 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 79,445 banorë. Me sipërfaqe prej 198.81 km², ajo ka densitet prej 201 banorë/km² sipas censurit dhe 400 banorë/km² sipas regjistrimit civil.



Bashkia e re përbëhet nga pesë njësi administrative të cilat janë: Kavaja, Synej, Luz i Vogël Golem dhe Helmas. Të gjitha janë pjesë e Rrethit Kavajë të Qarkut Tiranë. Bashkia e re ka një qytet dhe 32 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë	40,094	79,556	198.81
		Synej	Fshatrat; Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago			
		Luz i Vogël	Fshatrat; Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj			
		Golem	Fshatrat; Golem, Kryemëdhej, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qeret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i ri			
		Helmas	Fshatrat; Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Çetë, Momël, Habilaj, Çollakaj, Kryezi, Cikallesh			

4.8.2 Profili Bashkisë

Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore përreth qytetit të Kavajës deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Qyteti i Kavajës zë gjysmën e popullsisë së njësisë së re ndërsa njëra nga dy njësitë administrative bregdetare, Golemi, është ndërtuar gjatë viteve të fundit për shërbime turistike duke u larguar nga bujqësia. Komuna Synej e ka bregun e detit në përgjithësi ende pa ndërtime.

Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare i cili e mori statutin e Kasabasë (ekuivalentin e titullit qytet) në vitin 1867). Popullsia e tij u shtua gjatë kohës së komunizmit në përgjithësi e përqendruar rreth traditës zejtare të qytetit, përfshirë prodhimin e enëve të baltës, prodhimin të qilimave si dhe industrive të reja si fabrika e qelqit apo Uzina e Gozhdëve dhe Bullonave. Aktiviteti industrial i qytetit është reduktuar ndjeshëm pas rënies së komunizmit duke sjellë edhe emigrim të konsiderueshëm.

4.8.3. Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet janë të ndërtuara në qytetin e Kavajës por një problem i vazhdueshëm dhe me pasoja të rënda negative për njësinë administrative të Golemit, ku uji i pijshëm është shumë i paktë dhe ujërat e zeza derdhen në det duke reduktuar potencialin turistik të zonës.

Shqetësimi kryesor i banorëve të zonës bujqësore është mosmirëmbajtja periodike dhe rrjedhimisht, mosfunksionimi për periudha të gjata kohore të një kanali vaditës që merr ujë nga Shkumbini deri në Kavajë. Objekti ka filluar të ndërtohet që në vitet 1930 dhe është mirëmbajtur me hope përgjatë 25 viteve të fundit duke reduktuar potencialin prodhues së bujqësisë së zonës.

Për zonën kodrinore të Helmësit, e cila ka edhe numrin më të vogël të popullsisë nga njësitë administrative përbërëse të Kavajës ka vështirësi me mirëmbajtjen e rrugëve.

Hartimi i një plani zhvillimor urbanistik për qytetin e Kavajës si dhe veçanërisht për zonën bregdetare mund të sjellë zhvillim të konsiderueshëm të zonës të orientuar nga bujqësia dhe turizmi. Mirëmbajtja e infrastrukturës bujqësore, veçanërisht i sistemit të vaditjes mund të rrisë prodhimin bujqësor në territorin e kësaj bashkie.

Pastrimi i vijës bregdetare dhe zgjidhja e problemit të ujërave të zeza veçanërisht në zonën e Golemit e cila sakaq është e ndërtuar dendur mund të shërbejë për të zhvilluar turizmin.

Banorët e ish-komunave kanë shqetësim mungesën e një sistemi të transportit publik të integruar nga Kavaja deri në Durrës pasi aktualisht transporti publik ofrohet nga disa kompani në segmente të kufizuara, gjë që vështirëson qarkullimin e njerëzve, veçanërisht të nxënësve.

Marrëdhëniet mes qytetit të Kavajës dhe njësive administrative përbërëse mund të jenë problematik për shkak se shumica e votave në bashkinë e re janë përqendruar në qytetin e Kavajës gjë që redukton ndjeshëm peshën e votave të zonave rurale.

4.9. Mjedisi dhe burimet natyrore ne qarkun Tirane

4.9.1. Pyjet dhe Biodiversiteti

Nga sipërfaqja totale prej 165.200 ha ne Qarkun e Tiranës, pyjet mbulojnë rreth 32 % te kesaj sipërfaqeje. Ndersa ne nivel vendi pyjet zene rreth 36 % te territorit (MBUMK, Vjetari statistikor 2010). Gjendja ne pyjet e qarkut te Tiranës ne përgjithesi është e mire. Ne përmiresimin e situates ka ndikuar edhe kthimi i sipërfaqeve pyjore ne pronesi komunale. Njesite vendore si komuna Shengjergj, Dajt, Farke, Berzhite, Peze, Petrele, Zall – Bastar, dhe Kryevidh te cilat kane ne territorin e tyre sipërfaqe te konsiderueshme pyjore jane kryesisht te vendosura ne zonen kodrinore - malore te qarkut. Te ardhurat vendore nga pyjet jane shume te limituara dhe nuk përbejne ndonje burim te rendesishem për ekonomine lokale. Prandaj me te drejte thuhet nga autoritet vendore te disa komunave se keto njesi jane ‘te pasura me pyje por te varfra me te ardhura.

Nje pjese e rendesioshme e fondit pyjor ne qarkun e Tiranës perbehet nga zonaq e kane statusin e zonave te mbrojtura. Keto zona te mbrojtura perbehen nga pyjet e Parkut te Dajtit, te Bizes dhe te Bredhit qe zene nje sipërfaqe prej 27,820 ha. Parku Kombetar i Dajtit qe përben ballkonin natyror te qytetit te Tiranës ndodhet ne lindje te ketij qyteti me nje distance prej 23 km. Nder problemet qe vihen re ne zonen e mbrojtur te Dajtit jane zjarret qe bien gjate veres dhe shfrytezimi i guroreve. Keto probleme kane krijuar premisa për demtimin e Parkut Kombetar te Dajtit qe është pasuri jo vetem e qarkut te Tiranës por gjithashtu edhe pasuri kombetare.

Ne zonen e Bizes dhe Berdhetit qe shtrihen mbi lartesine 1,600 metra mbi nivelin e detit, vihet re nje larmishmeri e madhe si ne boten bimore ashtu edhe ate shtazore. Mbizoterojne kryesisht ahu, pisha dhe bredhi. Te dy keto zona kane potenciale te larta për zhvillimin e turizmit. Ndryshe nga Parku i Dajtit aksesi ne keto zona është me i veshtire për shkak te infrastruktures rrugore te dobet.

Ne territorin e qarkut te Tiranës gjendet nje shumellojshmeri e bimeve dhe kafsheve te egra qe formojne habitatet e tyre natyrore. Vegjetacioni është i larmishem dhe fillon qe nga zonat bregdetare dhe deri ne majat me te larta te maleve te ketij qarku. Ne zonen bregdetare mbizoteron bimesia mesdhetare me shkurret e dafines, mersinat dhe mare. Struktura pyjore përbehet nga Pisha e eger, Pisha e bute, Plepi, Selvia, Akacia dhe shkurret e Makias. Mbi lartesine 1,000 metra mbi nivelin e detit mbizoteron zona e lisit. Me ngjitjen me lart se zona e lisit fillon zona e ahut dhe me tej ndodhet zona e haloreve. Ne majen e maleve te qarkut te Tiranës shtrihen livadhet alpine ose nuk ka fare bimesi. Ne zonat pyjore te qarkut jetojne kafshe te ndryshme si ujku, dhelpra, derri i eger, ariu i murrme, lepuri i eger, macja e eger dhe nje numer i shumte shpendesh (Blue Agency & GTZ, 2009, Albanian green Line). Habitatet natyrore ne qarkun e Tiranës jane nje pasuri e paçmuar qe ndikon ne cilesine e mjedisit te ketij qarku. Prandaj mbrojtja e biodiversitetit te zones përben nje prioritet dhe është e kushtezuar drejtpërdrejt nga ruajtja e habitateve natyrore te kesaj zone

4.9.2. Burimet ujore dhe cilesia e tyre

Cilesia e ujrave varet nga niveli i mbrojtjes se tyre nga ndotja. Ndotsit kryesore te ujrave jane shkarkimet urbane, industriale, bujqesore si dhe përdorimi i pesticideve dhe kimikateve. Ne qarkun e Tiranës si rezultat i nje aktiviteti te larte urban, industrial dhe bujqesor ka nje depozitim te konsiderueshem te ndotesve te ndryshem. Ujrat e qarkut te Tiranës jane te përfshira ne Basenin ujqor te Ishem – Erzenit. Vleresimi i cilesise se ujrave te ketij baseni behet duke matur disa parametra. Disa nga keto parametra jane (1) Përmbytja e oksigjenit te tretur, (2) Përmbytja e nitrateve, (3) Përmbytja e fosforit. Keshtu matja e ketyre tre treguesve, për ujrat e lumit te Erzenit, është bere ne tre stacione ne lbe, Ndroq dhe Sallmone. Për parametrin e pare, cilesia është e mire ne lbe dhe vjen duke u ulur ne Ndroq dhe ne Sallmone. Pra ujrat jane te pasura me oksigjen

ne lbe dhe sasia e oksigjenit vjen duke u ulur gjate rrjedhes se ujrave për ne Ndroq dhe Sallmone. Prania e nitrateve, e treguesit te dyte, lidhet me shtimin e ndotesve nga shkarkimet urbane. Tek ujrat e Erzenit rezultati është i tille, sa me poshte rrjedhes se lumit aq me e larte është përmbytja e nitrateve, pra aq me shume ulet cilesia e ujrave. Për treguesin e trete ujrat e Erzenit klasifikohen si ujra te cilesise se keqe për shkak te përmbytje se larte te fosfateve (MMPAU, 2010, Raporti për gjendjen e mjedisit, fq 41).

Ujrat e lumit Ishem jane ne nje presion mjaft te larte urban. Kjo gje duket qarte edhe nga matja e parametrave te ujrave te ketij lumi. Vlerat e oksigjenit te tretur jane te uleta sidomos tek zona e Lanes dhe ne Rinas, gje qe deshmon për derdhjen e nje sasie te madhe te mbetjeve urbane. Ne baze te treguesve për nitratet dhe fosfatet ujrat e Ishmit jane klasifikuar si ujra te nje cilesie te keqe dhe ne zonen e Lanes si ujra me cilesi shume te keqe. Keshtuqë ne kete zone përmbytja e fosfateve dhe nitrateve është shume here me e larte se vlerat limite te lejuara nga BE (ibid. fq 42).



Ujrat e Shkumbinit ne zonen e Rrogozhines klasifikohen si ujra te nje cilesie te keqe duke ju referuar vleres se tre treguesve te mesipërm, vlere e tyre është me larte se vlere limit e lejuar nga BE. Kjo shkaktohet si rezultat e derdhjeve urbane dhe kalimi i ketyre ujrave neper zonen bujqesore te qytetit (ibid. Fq 47).

Cilesia e ujrave bregdetare te qarkut te Tiranës qe përfshin zonen e plazhit nga Golemi deri ne Spille është renditur si zona me e ndotur ne Shqipëri pas ujrave te plazhit te Durrësit (MMPAU, 2010, Raporti për gjendjen e mjedisit, fq 81). Gjendja është me e rende ne Golem, ndersa ne Qerret dhe ne Spille ujrat jane klasifikuar si ujra me cilesi te mire.

4.9.3. Cilesia e ajrit

Cilesia e ajrit është nje faktor qe influencon drejtpërdrejt ne shendetin e qytetareve. Gjithashtu cilesia e ajrit ka nje rendesi te madhe edhe për ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e zones se ozonit. Ndotsit e ajrit jane kimikate, grimca pluhuri dhe materiale biologjike qe shkaktojne demtime tek njerezit dhe organizmat e tjere te gjalle. Ndotsit kryesore qe ndikojne ne cilisine e ajrit jane NO₂, SO₂, CO, dhe PM₁₀ 1) qe emetohen gjate djegies se lendeve djegese. Ne qarkun e Tiranës, situata me e renduar përse i takon ndotjes se ajrit është ne zonen urbane te tij. Treguesit me negative gjenden ne bashkine e Tiranës. Kjo situatë është krijuar nga shkalla e larte e aktivitetit urban e ushtruar nga numri i madh i banoreve qe jetojne ne kete qytet.

Ne Qarkun e Tiranës, dhe vëncanerisht ne Bashkinë e Tiranës, bazuar ne monitorimin qe ka bere MM per vlerat e ndotesve te ajrit ka nje tendence pozitive persa i takon vlerave te pluhurit total dhe te pluhurit te respirueshem. Gjate 2-3 viteve te fundit ka nje ulje ne vlere te permbajtjes se ketyre ndotesve ne ajer. Permiresim ka edhe ne vlerat e gazeve SO₂ dhe NO₂. Vlera e ketyre dy tregueseve ka ardhur duke u permiresuar ne krahasim me vitin 2006, vit ne te cilin keto tregues kishin vlera me te larta se vlera limit e BE. Ndersa vlerat e plumbit dhe te monoksidit te karbonit jane akoma larg vleres limit te caktuar nga BE. Megjithate rritja e numrit te automjete, si rezultat i rritjes se nivelit te jetes, ndikon ne cilesine e ajrit dhe është e domosdoshme te mbahen ne kontroll te vazhdueshem keto vlera me qellim qe te parandalohet ndikimi negativ i tyre ne shendetin e qytetareve.

4.9.4. Menaxhimi i mbeturinave

Ne qarkun e Tiranës rritja e popullsisë dhe zhvillimi i infrastruktures dhe ndertimeve kane ndikuar ne menyre te konsiderueshme ne rritjen e sasise se mbeturinave urbane dhe te mbetjeve qe vijne nga ndertimet. Keshtu qarku i Tiranës gjeneron 38% te mbeturinave urbane dhe 49% te mbetjeve inerte ne Shqipëri. Sasia e mbeturinave te gjeneruara për banore ne vit ne qarkun e Tiranës është 294 kg ndersa mesatarja ne nivel kombetar është 229 kg/vit.

Duke ju referuar matjeve te bera nga MMPAU vihet re qe nga viti 2006 e ne vazhdim gjenerimi i mbeturinave ne total ka patur nje tendence rritjeje ne te gjithë vendin. Kjo gje është veçanerisht e dukshme ne qarkun e Tiranës. Ne kete qark sasia e mbetjeve urbane është rritur nga viti ne vit për shkak te rritjes se popullsisë dhe zhvillimit ekonomik. Ndersa sasia e mbetjeve inerte ka shenuar nje renie gjate viteve te fundit.

Sistemi i menaxhimit te mbeturinave ne qarkun e Tiranës akoma është ne nje nivel te ulet. Kjo vjen si rezultat i mbledhjes jo te plote te mbeturinave ne zona te ndryshme te qarkut si dhe mungeses se fushave te grumbullimit. Ne zonat urbane te qytetit menaxhimi i mbeturinave është ne nje nivel me te mire se ne ne zonat rurale. Ne disa komuna behet mbledhja e mbeturinave vetem ne qendrat kryesore dhe ne disa te tjera nuk ofrohet fare sherbimi i mbledhjes se mbeturinave nga njesia vendore. Por problemi me kryesor ne sistemin e menaxhimit te mbeturinave ne qarkun e Tiranës është mungesa e fushave te grumbullimit. Bashkia e Tiranës dhe disa njesi vendore qe ndodhen afer bashkise si komunat e Farkes, Petreles, Ndroqit, Kasharit i grumbullojne mbeturinat ne fushen e Sharres. Bashkia e Kamzes ka fushen e saj te mbetjeve.

Por shumica e njësive vendore si Kavaja, Gosa, Synej, Berzhit, Berxull dhe te tjera e konsiderojne si problem shume te rendesishem, mungesen e nje fushe te mirefillte për grumbullimin e mbeturina. Koordinimi i punes midis njësive vendore dhe zgjidhja e çështjes se mungeses se fushave te mbeturinave kerkon nje angazhim me te madh te Institucionit te Keshillit te Qarkut Tirane. Qarku i Tiranës është nga qarqet e pakta ne te cilin ka filluar aktiviteti i riciklimit te disa mbeturinave. Ne kete qark opërojne disa kompani qe merren me riciklimin e letres, plastikes dhe disa metaleve. Pavaresisht nga rritja e aktivitetit te ketyre kompanive gjate viteve te fundit, procesi i riciklimit akoma është ne fillimet e veta.

4.10. Mjedisi dhe burimet natyrore ne Qarkun e Durrësit

4.10.1 Relievi

Relievi i teritoreve te ineresuara është kryesisht fushor dhe kodrinor dhe jo i thyer, me lartësinë më të madhe 178 m kodra e Durrësit. Kodrat janë përgjithësisht të veshura me shkurre mesdhetare, bimë arash të kultivuara kullota dhe toka djerë ku mungojnë pyjet dhe grumbujt e drurëve Relievin tokësor e bejnë me te larmishem fushat dhe relievi kodrinor që alternohen në mënyrë të butë. Territoret e qëndrave të banuara shtrihen mbi reliev të rrafshët dhe kodrinor, në toka me përbërje argjillore dhe

suargjlore (kafe dhe kafë në gri. Në të dy anët e rrugëve rurale gjenden qendrat e banuara Arapaj, Xhafzotaj, Rashbull.

Qarku i Durrësit përshkohet nga dy lumenj, që derdhen brenda kufijve të tij, ndërsa burime të shumta sjellin gjithë vitin ujëra të ftohta e me vlera kurative. Një numër i madh ujëmbledhësish, të shpërndarë në gjithë territorin, shtojnë vlera pozitive për ekonominë, peisazhin dhe klimën. Larmia e relievit, afërsia me detin, ujrat e shumta rrjedhëse, shkurret dhe pyjet i japin jetë një flore dhe faune shumë të pasur.



Sektorët me ndikimin më të madh mbi mjedisin e që duhen marrë parasysh si faktorë përgjegjës në ndryshimet mjedisore janë industria e rëndë, industritë kimike, transporti, turizmi dhe bujqësia. Në rajonin e komunës Rashbull si në të gjithë rajonin e sipërpërmëndur, gjëndja mjedisore është një përfundim direkt i gjëndjes së përgjithshme socio – ekonomike, ritjes së shpejtë të popullatës, ritjes së paparë të vëllimit të ndërtimeve, ritjes maksimale të numrit të mjeteve.

4.10.2 Flora dhe Fauna

Territoret e interesuara nga projekti janë një pjesë e ngushtë e bonifikuar e pjesës kodrinore- fushore në afërsi të fshatrave Pejze dhe Arapaj (të Komunës Rashbull). Tashmë nuk ekzistojnë më habitate natyrore përgjatë brigjeve si rripat e mbjella me pisha, tokat e lagura të kripura, kënetat e përkohshme dhe shtretërit me shkure. Për shkaqe të ndryshme (perfitim tokash bujqësore, bonifikim i tokave të lagura, dëmtim/prerje drurësh, aktivitet ndërtimor njerëzor dhe gjuetia e pakonrolluar), aktualisht cilësia dhe shtrirja e mjedisit natyror të zonës së interesuar nga projekti vazhdojnë të përkeqësohen.

Bimesia e kultivuar. Kushtet klimaterike te zones me vere te nxehtë e të thatë dhe dimer te butë diktojnë llojet e pakta të bimesise spontane natyrore. Tokat me përdorim bujqësor në rajonin e prekur nga projekti, shtrihen ne fusha me pjerresi 0-5%, sistemuar sipas parametrave teknike ne ngastra me kanale kullues dhe vadites (31%). Ne pjerresi 0-25% rreth 65 ha te sistemuara ne taraca (30%), siperfaqja tjetër shtrihet ne zonen kodrinore qe pjeserisht mund te ujitet. Nga bimet e arave kultivohen shumica e kulturave (gruri, misri, jonxha, fasulja, perimet). Nga druret frutore kemi pakësim pas viteve 90^o, por aktualisht vihet re një shtim. Siperfaqet e mbjella më vreshta po njohin gjithashtu rritje në vitet e fundit.



Fauna e egër dhe llojet. Shfaqja faunistike ne territoret e interesuara është e varfër dhe veçanërisht për gjitarët. Kjo për shkak të mungesës së pyjeve dhe pranisë në ritje të aktiviteteve prodhuese ekonomike, bujqësore, turistike dhe jetësorë të njerëzve. Zona e interesuar nga projekti është e përfaqësuar me më pak lloje se të gjitha zonat e tjera në Rajonin e Durrësit Të dhënat tregojnë për një rëndim të cilësive mjedisore.

4.10.3. Klima

Pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit, afërsia nga deti Adriatik ka mundësuar natyren e klimes. Shprehja me e dukshme e këtij fenomeni është dimri i lageshtë/i butë dhe vera e gjatë, e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore regjistrohet 16°C, kurse temperatura maksimale e regjistruar me 14.08. 2006 është 40.7°C. Temperatura minimale e regjistruar ne vitin 1968 është -9.7°C.

Mbeshtetur ne Atlasin e Klimes se Shqiperise, rajoni i propozuar ndodhet ne Zonen Mesdhetare Qëndrore. Kjo karakterizohet nga vera e nxehtë dhe dimer i butë i lagët. Mesatarja vjetore e reshjeve është rreth 1100 mm/vit (950-1200 mm), ku shumica dermmuese bie gjate periudhes Tetor-Mars. Temperatura mesatare vjetore shkon nga 12 deri ne 32°C; temperaturat me te larta jane regjistruar gjate periudhes Korrik – Gusht me nje maksimum prej 35 deri 40 grade celcius. Temperaturat me te ulta jane ne muajin Janar dhe mund te ulen deri ne - 5°C. Diferencat e temperaturave midis nates dhe dites jane rreth 7-8°C. Reshjet e debores nuk jane prezente.

Krahina rihet nga erëra të forta dhe përgjithësisht brigjet janë pjesa më me erëra e gjithë vendit. Në dimër era që mbizotëron është ajo nga jug-lindja (Durrës) me shpejtësi 1.6 – 5.7m/s (janar). Në seonin e verës, mbizotërojnë erërat nga veri-lindja, por me inensitet më të ulët.

Periudha e vegjetacionit (temperatura mesatare 10°C) fillon në ditët e para të marsit dhe zgjat deri ditët e para të Dhjetorit, gjë që bën të mundur rritjen e një numri të madh llojesh.

Ajri në Komunat Rashbull dhe përeth është i cilësisë të mirë. Në vitet e fundit vihet re përmirësim i rrjetit rugor që ka ulur ndjeshëm ndotjen nga grimcat pezull dhe pluhuri, por edhe ekzistenca e aktiviteteve jo industriale të rajonit, kanë bërë që cilësia e ajrit të jetë në parametrat më të mirë. Në sezonin e verës vihet re një shtim i rëndësishëm i trafikut për shkak të rritjes të numrit të vizitorëve dhe turistëve që përdorin plazhet. Në të ardhmen e afërt në të rajonin përeth parashikohen rritje të vëllimit të aktiviteteve ndërtimore, kryesisht me ndërtime me qëllime tregtare /industriale dhe lehtësira të karakterit turistik.

4.10.4. Toka, Gjeomorfologjia

Rajoni i Shqipërisë ka në përgjithësi një ndërtim të nderlikuar gjeologjik. Strukturat gjeologjike përbëhen nga 5 zona tektonike të cilat nga Lindja në Perëndim formojnë Zonat :

1. Mirdita (Triassic/Jurassic limestones);
2. Krasta nënzonë (Cretaceous limestone and Paleogene sediments);
3. Kruja (Cretaceous and Eocene limestones and sedimentary deposits);
4. Joniane;
5. Ulja Para-Adriatike.

Nga ana tektonike, Rajoni Durrës –Tiranë bën pjesë në Zonën tektonike të Ultësirës Adriatike, midis Matit në Veri dhe Vlorës në jug. Nga pikëpamja tektonike ajo karakterizohet nga rudhje pak a shumë të regullta dhe me lëvizje orogjenike që kanë formuar këto ruddhje me moshë të re, e që vazhdojnë në ditët e sotme. Në këtë zonë fundi i detit adriatik vazhdon të ngrihet akoma edhe sot duke u rudhosur. Formacionet e kësaj zone janë të reja, kryesisht të Terciarit të Sipërm, të përbëra prej argjilave, mergeleve dhe ranorëve, të cilët formojnë antiklinale kodrinore prej disa dhjetra metash deri në disa qindra metra lartësi të drejtura nga VP në JL.

Teritori i Shqipërisë karakterizohet nga një strukturë gjeologjike dhe nga shfaqje tektonike mjaft të ndërlikuara, e cila nuk i bindet gjithmoinë tektonikës dinarike. Mund të themi se nga ana gjeomorfologjike teritoret e Komunës Rashbull dhe rajoni i prekur nga projekti bëjnë pjesë në Ultësitrën Perëndimore me shtresa sedimentare. Fusha nuk shfaqet uniforme Midis saj ngrihen kodra dhe vargje kodrash flishore dhe

shtufore me drejtimin nga jugu Fusha përshkohet nga lumenj të shumtë (Erzeni) me prurje që është risin nivelin e fushave në kurriz të detit. Duket se edhe procesi i formimit të kodrave nuk ka mbaruar.

Tokat në teritorin e Komunes së Rashbullit përgjithësisht paraqiten me origjinë aluviale ndërsa një pjesë e madhe e tyre janë depozitime nga prurjet e lumenjve Erzen si edhe shkëmbinj konglomeratë e të dekompozuar (në pjesën kodrinore) Tokat kafe dhe kafe të hirta përbëjnë së bashku rreth 2/3 të teritoreve. Tokat aluviale janë 19.0% dhe tokat e kripura 6.3% të teritoreve të inkuadruara nga projekti Tokat e kripura që përmbajnë klorin dhe kripë natriumi, të varfëra në elementë ushqyes dhe të kufizuar në prodhueshmëri janë pjesë e mirë e brigjeve të Lalzit dhe të bashkisë së Sukthit dhe Komunave që preken nga projekti.

Vihet re që toka në pjesën kodrinore të rajonit vuan nga fenomeni i erozionit (reth 20T/ha/vit) fenomeni është në rritje për shkak të aktivitetit të rritur njerëzor si shpyllëzimi, zjarret, mbikullotja dhe krijime taracash jo në mënyrën e duhur. Përgjithësisht, tokat në Bashkinë Vorë, Komunitet Rashbull, Ishëm dhe Bërshull janë 65% plazhe aluviale (depozita solide nga lumenjtë) dhe 35% janë shlif aktie. Teritorin shlifor kodrinor janë subjekt erozioni që duket se tenton që të përparon edhe në të ardhmen në një shkallë prej 0.2 -0.5m/vit. Erozioni tenton të shkojë për në jug (bishti i pallës) si pasojë më shumë e ndryshimeve dhe lëvizjeve të deltës së lumit Erzen se sa nga rritja e sedimenteve të transportuara.

Sizmiciteti. Rajoni i durrësit si pjesë e teritorit shqiptar. është i vendosur brenda rrethit sizmik Mesdhetaro-Alpin. Bazuar në të dhëna historike dhe dokumentime insruimentesh të stacioneve sizmologjike, Rajoni i Durrësit është i përfshirë në një zonë sizmike me magnitudë që shkon nga MS VII në MSVIII sipas shkallës MSK-64. Megjithatë në teritorin e qytetit të Durrësit dhe rrethinat e tij për shkak të kushteve të tokës, intensitetit i tërmeteve mund të arrijë MS IX. Shiko Fig. 3.5 dhe Fig 3.6.

4.10.5. Ujrat/Ekosistemet

Karakteristika hidrogeologjike. Në rajonin e Tiranë- Durrësit shfaqen katër lloje basenesh ujëmbajtëse nëntokësore;

- Baseni karstik (struktura e Dajtit)
- baseni i aluvial /poroz i quaternarit (fusha e Tiranës dhe lugina e Erzenit)
- baseni poroz i miocenit (kodrat e gropës së Tiranës)
- baseni poroz i pliocenit (ultësiira para Adriatike)

Ekosistemet tokësore. Një ndër karakteristikat themelore të rajoneve të zonës së projektit është mungesa e tipeve të habitateve. Kjo vërehet në një seksion edhe pse i shkurtër duke marrë në konsideratë pozicionin gjeografik dhe rrethin hidrologjik Duhet nënvizuar fakti se habitatet predominues, pyjet e zonës së makies paraqiten në sipërfaqe të konsiderueshme me një degradim si pasojë e ndërhyrjeve humane. Në vështirimin ekologjik, (vetëm me pak përjashtime) nuk mund të flitet për një vazhdimësi ekologjike të mirëfilltë, dhe kjo për shkak të ndërhyrjeve të vazhdueshme humane si shfrytëzime të pyjeve, mbikullotje, kthimit në toka bujqësore të sipërfaqeve kullësore, zënjes së tokës me ndërtime për qëllime banimi, rrugëve shërbyese të

tyre etj. Ngjarjet më të rëndësishme që ndikojnë në ndryshimet negative mbi ekosistemet në rjonin e Dutrësit janë:

- krijimi i tokave të reja për qëllime bujqësore;
- dëmtimi i pyjeve dhe kullotave natyrale;
- Shfrytëzimi i brigjeve dhe shtratit të lumenjve;
- zonat e pyllëzuara janë minimale, nuk ka investime përmirësuese;
- habitatet që shfaqen janë të varfëra ose ne zhdukje;

Mund të themi së *nuk kemi prezencë të llojeve të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura nga Konventa Për Ruajtjen e Florës Dhe Faunës Së Egër Dhe Mjedisit Natyror Të Evropës (KE, Bernë, 19.9.1979)*

5. Pershkrim i Projektit

5.1 Hyrje

Ne kerkesen e Drejtorise se Pergjithshme te Ujesjelles Kanalizimeve - Tirane Dt.25.03.2011 kerkohet studim hidrogjeologjik per mundesine e furnizimit me uje te pijshem te zonave te plazhit te Durrësit dhe Kavajes nga pus-shpimet e Çermes. Shpimet e Cermes jane shfrytëzuar me pare per furnizimin me uje te pijshem te qytetit te Lushnjes. i cili aktualisht furnizohet me uje nga ujesjellesi i Konjatit. Qyteti i Lushnjes me pare eshte furnizuar me uje te pijshern nga ujesjellesi i Konjatit dhe ai i Çermes. Me rikostruktimin e ujesjellesit te Konjatit, u kryen 6 shpime te reja me prurje $Q = 216$ l/sek qe plotesojne te gjithë nevojat per uje te pijshem te qytetit te Lushnjes (ujesjellesi i ri eshte ndertuar ne vitin 2009). Vlen te theksojme se rritja demografike e qytetit te Lushnjes dhe zonave perreth mund te kerkoje shtim te sasi se se ujit qe duhet patur parasysh ne hfrytezimin e rezervave te ketij akuiferi.

Ujesjellesi i Çermes aktualisht perdoret per furnizimin me uje te disa fshatrave, nga te cilet shfrytezohen 2 shpime me ndërprerje nga 7 shpime egzistuese te ketij ujesjellesi. Nga ky sektor jane rekomanduar per shfrytëzim ne vitin 1986 sasia e ujit $Q = 5$ l/s per qytetin e Lushnje dhe 55.5 l/sek per fshatrat dhe ndermarrjen bujqesore. Ne zbatim te kerkeses u krye nje rikonjicion i hollesishem i punimeve te kryera - shpime hidrogjeologjike te shfrytezimit te kryera ne zonen Çermes dhe studimi i materialeve te arkivit.

Ne zonen Çerrne - Konjat jane kryer punime hidrogjeologjike me karakter studimi dhe shfrytezimi per furnizimin me uje te pijshern e teknologjik te qytetit Lushnje dhe fshatrave.

Gjithashtu ne kete zone eshte kryer monitorimi hidrodinarnik e hidrokimik i ujerave nentokesore qe nga viti 2000 e ne vazhdim i ujesjellesit Konjat dhe Çerre. Meqenese kjo zone ka rezerva te ujerave nentokesore qe nuk shfrytezohen dhe vetite fizike-kimike te ujrave jane te mira si dhe plotesojne standartet e ujit te pijshern rekomandojme qe sasia e ujit qe kerkohet per zonat e plazhit te

Durresit dhe Kavajes te merret nga zona e Çërnes sic kerkohet ne shkresen e DPUK.

Per plotesimin e kerkeses u pergatit studimi hidrogjeologjik per furnizimin me uje ne sasine e kerkuar $Q = 300$ l/sek nga zona Çërme - Lushnje.

Studimi eshte bazuar ne rezultatet e shpirneve studimore dhe te shfrytezimit te kryera nga Ndërmarrja Hidrogjeologjike ne akuiferin ujembajtes te kuaternarit ne zonen Çërme - Konjat. Gjithashtu ky studim bazohet ne te dhenat e shfrytezimit te sasise dhe cilesise te ujesjellesit Çërme per furnizimin me uje te pijshëm te qytetit Lushnje.

5.2 Situatat aktuale e furnizimit me uje ne kete zone

Furnizimi i zonave te plazheve te rajonit Durres dhe Kavaje eshte realizuar pjeserisht nga ujesjellesi i Fushe - Kuqes. Me rritjen demografike te popullsisë ne zonen Durres - Kavaje jane rritur nevojat per uje te pijshëm. Sasira te konsiderueshme merren nga zona e Fushe Kuqes por ato nuk realizojne furnizimin e plote te qytetit te Durresit dhe zonave perreth. Zona e plazheve te Durresit dhe Kavajes ka probleme te medha ne furnizimin me uje te pijshëm sidomos ne stinen e veres kur shtohen shume nevojat per uje si rezultat i shtimit te numrit te pushuesve dhe turisteve. Rajoni Durres - Kavaje nga pikparnja hidrogjeologjike ka kushte jo te favorshme per furnizimin me uje te pijshem sipas normave te sotme. Qyteti i Kavajës eshte furnizuar me uje nga ujesjellesi i Durresit - Fushe Kuqe. Ne vitin 1995 u ndertua ujesjellesi i ri qe shfrytëzon shpimet e kryera ne serine Rrogozhina duke plotesuar nevojat e qytetit te Kavajes. por kjo sasi eshte e pamjaftueshme per te furnizuar zonen e plazheve.

Bazuar ne kerkesen e D PU K nr. 660 te dt. 25.03.20 studimi ka rekomanduar me s i zone prioritare per furnizimin me uje te pijshemzonen e Çërnes ne sasine $Q = 300$ l/sek. Kjo zone eshte shfrytezuat per furnizimin me uje te pijshern te qytetit te Lushnjes se bashku me ujesjellesin e Konjatit. Me rikonstruksionin e ujesjellesit te Konjatit qe perfshin kryerjen e 6 shpimeve te reja qe realizuan detyren per furnizimin e qytetit te Lushnjes. Ujesjellesi i Çërmes aktualisht shfrytëzohet vetem pjeserisht per furnizimin e disa fshatrave.

5.3 Ujesjellesi Çërme - Lushnje Ana Teknologjike

Ky ujesjelles eshte ndertuar ne vitin 1989 dhe si burime te furnizimit me uje kane sherbyer puset te emertuara si me poshte duke filluar nga pusi me i larg et ne drejtim te Divjakes:

- Pusi 281
- Pusi 282
- Pusi 283
- Pusi 285
- Pusi 286

Ne cdo pus ka qene ndertuar nje godine e thjeshte 3.5×3.0 m me mure tulle te suvatuara. Puset 281, 283, 285, 286 kane qene parashikuar te dergonin uje ne sasine 60 l/s ne drejtim te stacionit qendror te pompimit me tubacione celiku 273×7 mm. Per momentin pusi 284 s'ka godine dhe s'ka linje. Ne pusin 282 pervec

godines se pompes ka dhe ambiente per transformatorin, nga ku furnizohen me energji elektrike, stacionet ne puset 281 dhe 283.

Idea e ketij ujesjellesi ka qene qe uji qe grumbullohet nga puset te pompohej per ne vaskat e stacionit qendror te pompimit, pese linja me tubacion celiku 273x10mm, ku edhe do te behej klorinimi i ujit. Nga vaskat uji kalonte me vete rrjedhje me ane te nje tubacioni DN-500 per ne rezervuarin grumbullues me volum 400m³.

Pompat e vendosura ne godinen e stacionit qendror, thithnin uje nga rezervuari grumbullues me ane te nje kolektori DN-600 dhe e dergonin pjeserisht per ne qytetin e Lushjes dhe pjeserisht per fshatin. Per momentin kjo ide funksionon vetem per fshatin pasi Qyteti merr uje nga Stacioni i Pompimit Konjat.

5.4 Ana ndertimore

Strukturat ndertimore te ketij ujesjellesi perbehen nga:

- Stacioni Qendror i Pompimit
- Godinat e puseve
- Furnizimi me energji elektrike

Stacioni Qendror i Pompimit eshte nje godine pjeserisht me nje kat dhe pjeserisht me dy kate, me themele butobetoni dhe mure tulle te suvatuara. Ne kete godine jane bazamentet e pompave per qytetin e Lushjes nga ku merr uje dhe fshati, gjithsej 5 bazamente.

Po ne kete godine jane dhe vaskat e ardhjes se ujit ne katin perdhe dhe ato te klorit ne katin e pare. Ne kete godine jane dhe ambientet per pajisjet elektrike, transformator, panele etj.

Godinat e puseve 281, 282, 283, 284 dhe 285 kane nevojte per rikonstruksion te thelle. Ketu mund te permendim dyert dritaret, shtresat suvatimet etj, te cilat pothuaj mungoj ne. Vetem godina e pusit 286 eshte pjeserisht ne rregull e rikonstruktuar.

5.5 Studimi Hidrogjeologjik

Bazuar ne Detyren e Projektimit te permbledhur me siper eshte hartuar studimi i Hidrologjik per te siguruar sasine e ujit prej 300 Lis. Sipas studimit rekomandohen dy mundesi;

E para te shfrytezohen 5 shpimet ekzistuese 281, 282, 283, 284 dhe 285, te cilet sipas ketij studimi mund te shfrytezohen per sasine e ujit 60 lis. Per kete variant konkluzioni eshte qe:

- Shpimet ekzistuese jane te vjetra dhe tubat mund te jene te korroduar
- Pastrimi i tyre mund te kete veshtiresi
- Ulja e pompave zhytесе per nivele me te thella dinamike ne kushtet e shfrytezimit e bashkeveprimt nuk mund te realizohet

E dyta te hapen 5 shpime te reja si dublime ne shpimet ekzistuese 281, 282, 283, 284 dhe 285, per te marre sasine e ujit prej 300 lis. Per kete variant theksohen keto avantazhe:
Sigurohet sasia e ujit si dhe ka rezerva per fshatrat.

- Cilesia e ujit eshte e mire
- Eshte me afer zones se ushqimit
- Ky sektor eshte larg ujrave te kripura
- Shtresa zhavorrore ka trashesi te madhe dhe ujepercjellshmeri te larte
- Rezervat e shfrytëzuaradhe te rekomanduara jane te lira.

Per kete variant jepen nivelet dinamike per te gjithë puset per sasine e ujit 60 l/s nga -14,25m deri ne -17.94 m. Rezultatet perfundimtare do te jepen ne raportin hidrogjologjik perfundimtar.

5.6 Projekti i zbatimit

5.6.1 Te pergjithshme

Ky ujesjelles parashikon furnizimin me uje te plazheve Durres Kavaje ne sasine prej 250 l/s me dergim te sasi se se ujit 80 l/s ne depon Kavaje dhe 170 Lis ne depon Arapaj.

Projekti i linjes se ujesjellesit nga fusha e puseve te meparshem deri per tek konsumatoret eshte njelloj si ne projektin e pare. Subjekt i kesaj shtese te projektit jane

- Marrja e ujit nga puset e Cermes
- Dergimi i sasise se ujit ne stacioni qendror te Ujesjellesit Cerme Lushje
- Dergimi i ujit nga stacioni qendror Cerme per ne depot e ujit Kavaje dhe Arapaj (duke u lidhur me linjen e dergimit te projektit te meparshem)

5.6.2. Linja kryesore e dergimit

Linja kryesore e dergimit merr ujin nga stacioni qendror i pompimit dhe e dergon per ne depot Kavaje, Manskuir dhe Arapaj. Kjo linje do te jete njelloj si ne Projektin e pare me keto dy ndryshime:

- Shtohet gjatesia e linjes kryesore te dergimit, pjesa nga stacioni qendror i pompimit Cerme deri ne piken e lidhjes me linjen e dergimit te Projektit te pare, qe ka qene ne fushen e puseve
- Rritet sasia e ujit nga 200l/s ne projektin e pare ne 250 Lis ne kete shtese te Projektit

Si rezultat i ndryshimit te gjatesise se linjes dhe te sasise se ujit ndryshoj ne dhe karakteristikat e stacionit te pompave qe do te instalohen ne stacionin qendror te pompimit ne Cerme.

Edhe ne detyren e pare te projektimit, kur burimi ishte fusha ujembajtëse Rrogozhines dhe prurja llogaritese $Q=200$ l/se k, aftesia percjellese e linjes Kavaje Arapaj eshte pranuar 200 l/sek pamvaresisht

se ne Kavaje do te liheshin 601/sek. Kjo per aresye te elasticitetit te skemes se furnizimit te plazheve te zones Durres-Kavaje.

Me ndryshimin e burimit te furnizimit dhe rritjes se prurjes llogarite se te ujesjellsit nuk ka ndryshuar aftesia percjellese e linjes Kavaje-Arapaj. Pra pavaresisht se ne drejtim te depos egzistuese Kavaje dot jepet 80 l/sek dhe ne drejtim te Arapajt do te jepet 170 l/sek, aftesia percjellese e ujesjellsit Kavaje -Arapaj mbetet 200 l/se k.

5.6.3. Marrja e Ujit nga Puset

a. Pus Shpimet

Nga variantet e paraqitura ne studimin hidrogeologjik dhe duke u bazuar ne konkluzionet e ketij studimi eshte vendosur per hapjen e puseve te reja. Kjo me idne se do te ishte jo racionale perdorim i i puseve ekzistues te cilet nuk kane sigurine e duhur per kete investim potencial dhe per rendesine qe ka ky ujesjelles.

b. Ana Teknologjike

Puset qe do te zhfrytezohen do te jene Pusi 281, Pusi 282, Pusi 283, Pusi 284 dhe Pusi 285, me sasi te ujit 601/s per cdo pus, po ashtu dhe pusi 286 si pus rezerve. Marrja e ujit nga puset do te behet me pompa te reja zhytese qe do te futen ne thellesi -20 m nga siperfaqja e tokes. Tubacioni brenda ne pus do te jete DN-150 celiku inoksidabel me pjese 2m me flanaxha ose material i ngjashem me ate te perdorur ne ujesjellesin e Lushjes, ose ekuivalent. Ne dalje te pusit do te instalohen saracineske, kontravalvolvol, mates uji, saracineske per larjen e pusit, valvol per kontrollin e prurjeve dhe presionit.

Pompat do te jene me "frekuence inverter". Me poshte po japim llogarit jet hidraulike per pjesen nga pompa brenda ne pusin hidrogeologjik deri ne dalje te stacionit te pompim it ne pusin hidrogeologjik. Uji do te dergohet ne vaskat ekzistuese me pese seksione duke shtuar dhe nje seksion tjeter, gjithesej gjashte seksione. Nga ketu uji do te dergohet per ne rezervuarin e ri V- 1000m³ me nje tubacion te ri DN-500 dhe ne rezervuarin ekzisatues me tubacionin ekzistues DN-500, duke instaluar dy saracineska DN-500 ne daljen nga vaskat.

c. Ana ndertimore

Bazuar ne gjendjen ekzistuese ndertimore ky projekt ka nderhyre per permiresimin e kesaj gjendje. Per sa i perket anes ndertimore te stacionit kryesor te pompim it mendohet qe te perdoret godina ekzistuese e cila do te rikonstruktohet. Per anen ndertimore te stacioneve te vegjel ekzistues ne kete projekt zbatim jepen shpjegimet si me poshte:

- Rikonstruksioni i i Godines se pusit 282
- Prishja e tyre atje ku ekzistojne ne puset e tjere dhe ndertimi i godinave te reja.per te gjithë puset e tjere

Me poshte jepen te dhenat per ri konstruksionet e anes ndertimore

Punimet e rikonstruksionit qe jane parashikuar per stacionin qendror dhe per gosinen e pusit 282 perfshijne rikonstruksion si per godinat brenda dhe jashte po ashtu edhe sistemim te jashtem dhe kryesisht rrethimin.

Rikonstruksioni i godinave brenda merr parasysh:

- Heqjen dhe zevendesimin e te gjitha dritareve
- Heqjen dhe zevendesimin e te gjitha dyerve, me perjashtim te dyerve me xhaluzi, per te cilat eshte parashikuar lysterje me boje vaji.
- Prishjen dhe ri berjen e te gjitha suvatimeve te brendshme, te jashtme si dhe te tavan eve.
- Heqjen dhe zevendesimin e te gjitha instalimeve elektrike

Te gjitha godinat jane parashikuar te vishen me pllake terrakote ngajashte. Ne veshtrim te te pare duket sikur pllaka terrakote do t'ia rrise vleren objektit, por eshte nje investim i cili do te vleje per nje kohe te gjate.

Duke veshur fasadat me cilesi te mire, godinat do te kene nje pamje me cilesore jene me higjienike dhe nuk do te kerkojne shpenzime per suvatim dhe lysterje ne te ardhmen.

5.6.4. Linjat dhe stacionet e pompimit

Sipas projektit te zbatimit behet ri konstruksion i godines se stacionit qendror dhe godines se pusit 282. Godinat e te gjitha puseve te tjere, 281, 283, 284 dhe 285 behen te reja. Te gjitha linjat e ujesjellesit nga puset per ne stacionin qendror qe jane ekzistuese do te perdoren dhe ndertohen linja te reja vetem per pusin 284 dhe pusin 285. Llogaritjet hidraulike te linjave jepen ne tabelne e meposhtme.

Sipas kerkeses se detyres se projektimit duhet te realizohet nje stacion pompimi qe me anen e elektropompave zhytесе dhe shtytесе te dergoje prurje ne dy drejtime me parametrat e meposhtem:

a. Ne zonen e plazhit Kavaje-Durres me prurja $Q=250$ Litralsek dhe lartesi $H=150$ m

b. Ne zonen e fshatit me prurje $Q=50$ Litralsek dhe lartesi $H=90$ m

Pra sasia e pergjitheshme e ujit qe do te dergohet ne dy drejtime eshte 300 Litralsek. Sipas studimeve hidroteknike ne projekt jane parashikuar te vihen ne pune 6 pusecptime me 60 Litralsek me prodhimtari totale 360 litralsek

5.6.5. Dezinfektimi i Ujit

Dezinfektimi i ujit, do te realizohet ne menyre automatike me klor te lenget duke vendosur nje rezervuar te klorit ne stacionin kryesor te pompimit, ne vendin ku sot eshte dhoma e operatoreve, ndersa vaskat dote jene per kontrollin vizual te sasise se ujit duke shtuar dhe nje vas ke tjetër per te bere te mundur kalimin e gjashte linjave ne stacionin qendror te pompimit. Sistemi dezinfektimit do te jete automatik dhe do te funksionoje duke marre sinjal ne tubacionin e dergimit.

6. Ndikimet ne mjedisi dhe masat e parashikuara per parandalimin e tyre

6.1. Hyrje

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe në mënyrë më analitike ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Në këtë kapitull jepet informacion për ndikimet e mundshme negative në mjedis të veprimtarisë së trajtimit të mbetjeve spitalore që synon të realizojë Qendra Spitalore Universitare me anë të Hidroklavës. Mbas vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis propozohen gjithashtu edhe disa masa me karakter teknik dhe organizativ që duhet të ndërmerren nga shoqëria me qëllim që të garantohet mbrojtja e mjedisit sipas kërkesave ligjore. Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimeve në mjedis të veprimtarisë është e rëndësishme të kuptohet natyra e proceseve që e përbëjnë atë dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis,
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis.

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve natyrore dhe rigjenerim të ekosistemit.

6.2. Punimet e dheut dhe masat e nevojshme

E gjithë sipërfaqja që ka të bëjë me zonën e punimeve duhet të pastrohet nga rrenjet e pemeve, shkurret, trungjet dhe grumbujt e tyre duhet të largohen.

Ky rregull duhet të veproje edhe 6 m me larg rrotull sipërfaqes ku do të kryhen punimet. Përgjeth do të digjen; produktet që mbeten nga ky proces do të largohen nga zona e punimeve.

Per këto lloj operimi duhet të përdoren paisjet e duhura. Kontraktori nuk duhet të lejojë heqjen e pikave fikse, të cilat janë ndertuar për të qenë të ekspozuara. Nqs ndonjë pikë fikse do të prishet, Kontraktori është i detyruar ta restaurojë e atë.

Pastrimi konsiston në pastrimin e tokës nga të gjitha pemet, shkurret, trungjet dhe bimesi të tjera, të gjitha mbeturinat dhe çfarëdo materiali tjetër të panevojshëm si dhe nga gardhet apo rrethimet.

Gjithashtu përfshihet shkulja e të gjitha rrenjeve, nqs nuk kërkohej parandalimi i erozionit ose gërryerjes, dhe në rastet kur kërkohej, të gjitha gropat e hapura nga pastrimi dhe shkulja, do të mbushen me material të përshtatshëm. Materiali mbushës poshtë strukture s do të ngjishet deri sa të arrihet densiteti sic specifikohet aty ku përkruhen nënshtrësat në Piken 304. Gardhet dhe guret e vecuar me të mëdhenj se 0.25 (një e katërta) m³ do të depozitohen në vendet e depozitimit të materialeve të tepërta dhe të përshtatshme.

6.3. Përgatitja e bazës për konstruksionin

Si rregull bazamenti i rrugës, kantierit dhe argjinaturave si dhe çdo lloj bazamenti tjetër duhet të ngjishen në breza të ngushta me thellesi 10 cm. Ky operim përfshin heqjen e shtresës së sipërme të tokës, barishtet, mbetjet e bimesisë dhe dheut që ngjishet.

Brezat mund të mos jenë të domosdoshëm vetëm sipas instruksioneve të Inxhinierit, kur ato konsiderohen të panevojshme, në baza të karakteristikave të dheut.

Në këto rast, vëllimi i dheut i hequr poshtë thellesisë 10 cm do të konsiderohet si germim i përgjithshëm në tokat e zakonshme (Pika 303.1.).

Të gjitha materialet e brezave do të largohen nga vendi i punës dhe nuk do të përdoren për punimet e konstruksionit.

6.4. Germimi

Për kryerjen e punimeve të germimit, ngarkimit dhe transportit do të sigurohen paisjet e nevojshme. Germimi për punimet do të kryhet i tillë që gjëresia, gjatësia, thellesia drejtimi dhe pjerresia të jenë sic specifikohen ose tregohen në Projektin e Zbatimit.

6.4.1 Germimi per kanale ose themele.

Termi "germim kanali" tregon germimet poshte nivelit te tokes ose nivelet e germimeve ne pergjithesi per te siguruar seksione te vogla te nevojshme per lejimin e ndertimit te mureve ose themeleve te kolonave ose vendosjen e tubave.

Ne pergjithesi, anet e germimeve duhet te perforcohen sipas natyres se dheut ose sic specifikohet apo tregohet ne Projektin e Zbatimit. Kur eshte e nevojshme germimi duhet te perforcohet mjaftuesherisht per te parandaluar rreshqitjet ose levizjen e materialeve ku po germohet, per te ruajtur dhe siguruar punetoret dhe strukturat afer.

Duhet te merren masat e nevojshme per parandalimin e rreshqitjeve gjate germimeve dhe cdo demtim ose defekt duhet te korigjohet. Materialet e teperta duhet te largohen per ne vendin e grumbullimit. Per kete pune nuk do te kete pagese te vecante.

Duhet te merren te gjitha masat e nevojshme per te ruajtur te gjitha materialet pertej kufirit dhe pjerresise te zones se ndertimit ne kushte te pa prekura sic specifikohen ose tregohen ne Projektin e Zbatimit

Materialet e shkaterruara pertej caqeve te germimit si rezultat e operimit te ndertimit duhet te largohen nga shtresat e paprekura dhe kur eshte e nevojshme te zevendesohen me material te pershtatshem te ngjeshur. Nuk do te kete pagese per germimet shtese te materialit per zevendesim me perjashtim te rastit kur thyerja e gurit eshte plotesisht per shkak te formacionit te karaktersitikave te shkembtit.

Germimi perfundimtar, te pakten 15 cm, i bazamentit te themelit duhet te kryhet vetem perpara mbeshtetjes se struktures qe do te ndertohej. Siperfaqja e nivelit te themelit nuk do te lejohet te priset nga asnje shkak, nqs ndodh, te gjitha materialet te cilat behen te paqendrueshme duhet te largohen dhe te zevendesohen me materialin e pershtatshem dhe te ngjeshur. Nuk do te behet pagese per punimet e germimit dhe materialin zevendesues, te cilat jane bere per shkak te shkaterrimit te bazamentit.

Kuotat e themeleve, nivelohen sic tregohet ne Projekt Zbatim, ato duhet te miratohen nga Inxhinieri, i cili mund t'i ndryshoje ato sipas karakteristikave te dheut te bazamentit; vendimet e Inxhinierit nuk do te diskutohen.

Perpara fillimit te punimeve te ndertimit, Kontraktori do t'i paraqese kuotat e themeleve Inxhinierit per aprovim. Baza e themelit duhet te jete horizontal ose e shkallezuar kur profili i tokes nuk mund te nivelohet.

6.4.2 Germimi i kanalit per shtrirjen e tubave

Germimi do te kryhet duke ndjekur ekzaktesisht radhen dhe seksionet e treguara ne Vizatime ose sipas udhezimeve te Inxhinierit. Kontraktori do te jete pergjegjes per te gjitha demtet e mundshme qe mund t'i shkaktohen godinave ose infrastruktures per shkak te mos respektimit te te dhenave per seksionet e kanalit.

Pro fil et e dhena sipas vizatimeve paraqesin vetem nje tregues te pergjithshem dhe Inxhinieri mund t'i ndryshoje ato, duke u bazuar ne karakteristikat gjeo teknike te vendit. Kontraktori nuk mund te kerkoje pagese ekstra per ndonje perjashtim ose kerkese, keshtu ai do te marre pagese per punen sic eshte fiksuar ne kontrate.

Edhe nese germimi eshte bere duke ndjekur tipin e seksionit te dhene ne projekt, nqs eshte e nevojshme Kontraktori, duhet t'i forcoje ato me pajanda, pa ndonje pagese shte se dhe do te jete pergjegjes per cdo demtim te shkaktuar ne rast rreshqitje.

Fundi i kanalit duhet te jete i drejte dhe i niveluar. Tubat do te vendosen me pjerrresine e kerkuar sipas Vizatimeve.

Cmimi i ofertes perfshin germimin, mbushjen e kanalit si dhe perfshin te gjitha kostot per ndricim naten dhe sinjalistika te tjera te nevojshme per te garantuar sigurine e njerezve dhe trafikun lokal gjate gjithë periudhes se punimeve, si naten ashtu edhe ditën. Kurdo qe Kontraktori gjen ne kanal linja ujesjellesi, linja telefonike, kablo elektrike ose tuba per sherbime te tjera publike ai duhet te informoj e menjehere Inxhinierin dhe Agjensine qe ka lidhje me to si dhe duhet te siguroje zgjidhjen me te mire per t'i mbeshtetur ato ne menyre te mjaftueshme dhe me materiale, duke aplikuar kontrolle te vazhdueshme per te menjanuar cdo rrezik ose demtim, duke ndjekur instruksionet e dhena nga Inxhinieri dhe agjensite publike qe kane lidhje.

Materiali i germuar

Pa ndonje cmim shtese, materiali i germuar qe gjykohet nga Inxhinieri i pershtatshem per mbushje duhet te ndahet ne grumbuj te tipeve te ndryshem, bazuar ne karakteristikat e tyre. Germimi duhet te kryhet mundesi sht ne faza te ndryshme, keshtu qe materialet e pershtatshme mund te ruhen para thellimit te kanalit.

Zakonisht grumbujt e dheut vendosen pergjate kanalit, duke patur kujdes shmangien e cdo pengese te aktiviteteve te punes ose trafikut. Kontraktori do te marre te gjitha masat e nevojshme per parandalimin e cdo kullimi te ujrave siperfaqsores brenda ne kanal dhe cdo rreshqitje.

Materiali qe nuk mund te perdoret ose qe eshte teper duhet te transportohet direkt ne vendin e autorizuar, ose sipas udhezimeve te Inxhinierit. Kostot e ngarkimit dhe transportit jane menduar te perfshihen ne cmimin e ofertes per germimin e kanalit

Mbushja

Mbushja e kanalit do te kryhet ne kete menyre:

Tubat dhe bashkimet nuk duhet te pesojne ndonje goditje, levizje ose ngritje, ne rastin kur tubat jane me elemente ekziston mundesia qe ato te cvendosen

Dheu dhe materiali mbushes duhet te ngjishen qe ne saje te faktorit lageshti ngarkesa mbi tuba te reduktohet.

Mbushja ndahet ne dy faza: rrethimi i tubit dhe mbushja e kanalit. Rrethimi i tubit fillon nga fundi kanalit deri ne lartesine 15cm mbi faqen e siperme te tubit. Ajo duhet te behet me rere te paster ose material te paster pa gure dhe nuk mund te ngjishet ne shtresa me te trasha se 50 cm ngjeshja duhet te behet me paisje te pershtatshme, ne te dy anet e tubit ne te njejten kohe, duke shmangur goditjet dhe ndonje levizje te tubit.

Sapo te kete mbaruar mbulimi i tubit, duhet te filloje mbushja e kanalit, ngjeshja e materialit ne shtresa te ndryshme duke perdorur paisjet e duhura per dheun present ne vend, pa shkaktuar demtime te tubave.

Ne rastin kur Inxhinieri nuk gjykon si te pershtatshem materialin e germuar per mbulimin e tubit dhe mbushjen e kanalit, duhet te perdoret material tjetër, karakteristikat e te cilit klasifikohen sipas normave A.A.S.H.O. ne grupin A l.a.

6.4.3. Germimi ne prezence uji

Ky term nen kupton germimet e kryera poshte nivelit te ujrave netokesore. Do te merren te gjitha masat dhe paisjet e nevojshme per tharjen e ujit qe te mundesohet shtrirja e tubave dhe derdhja e themeleve.

Karrierat

Te gjitha materialet e kerkuara per:

- Ndertimin e kanalit dhe bazamentit te rruges;
- Mbushjen;
- Coptimi i agregateve te trasha dhe rera per beton;
Baza e rruges dhe nenbaza

mund te merren nga punimet e germimit dhe/ose prej zones se treguar nga Inxhinieri dhe verifikuar nga Kontraktori ose prej burimeve te tjera te sigurta, keshtu qe zonat ne te cilat Kontraktori ka ndermend te hape karriera duhet t'i paraqiten perpara per miratim Inxhinierit. Venndodhja dhe shtrirja e te gjitha karrierave duhet te miratohen.

Inxhinieri rezervon te drejten te ndryshoje kufite dhe/ose vendndodhjen e karrierave brenda kufive te zones se karrierave me qellim marrjen e materialit te duhur. Inxhinieri duhet te caktojte thellesine e prerjes se te gjitha pjeseve ne vendin e karrieres, dhe prerja te behet sipas thellesise se projektuar.

Tipi i pasijeve te perdorura dhe operimi nga ana e Kontraktorit per germimin e materialeve nga karrierat duhet te jerte te tilla qe te sigurojne prodhimin me nje uniformitet te kerkuar te materialeve te perzierjes. Kontraktori do t'i jepet e drejta per t'iu lejuar cmim shtese nga oferta, per cdo ndryshim te urdheruar nga Inxhinieri, per sasine e materialeve te sigururara nga karriera ose per sasi ne e urdheruar nga Inxhinieri te pjeseve te ndryshme te karrierave prej te cilave jane marre materialet ose per ndryshimin e thellesise ku eshte marre materiali. Siperfaqet e karrierave te germuara do te kene pjerresine e projektuar nga Inxhinieri, por jo me te madhe se 2: 1.

Karriera do te shfrytezohet aq sa te mos demtohet, ose te behet e padobishme cdo pjese e vepres ose pronesise te Autoritetit Kontraktues. Siperfaqet e mbetura bosh do te lihen ne nje forme te sheshte te arsyeshme.

Per largimin e formacioneve te tokes ne karriera gjate ose mbas gerrumrt, kanalet e drenazhimit te cilat do te shkarkohen ne piken me te afert do te kryhen nga Kontraktori, kur Inxhinieri mendon se drenazhimetjane te nevojshme.

Nuk do te kete pagese direkte per germimin e kryer per kanalet e drenazhimit ose per cdo punim tjeter te nevojshme per te lene materialet ne kushte sic duhet. E gjithë kostoja per punime te tilla do te perfshihet ne cmimin njesi me m3 ne oferte per materialet mbushese.

Vendet e karrierave do te hapen sic pershkruhet ne Piken 301. (Punimet pergatitore per pastrimin). Karrierat do te projektohen nga Inxhinieri aq sa progresi i punimeve dhe vepimet e largimit do te kufizoj ne karriera e projektuar.

Kontraktori do te prese ne rripa me kujdes vendin e projektuar per karriere te shtresave te punueshme, vendeve me bar, dhe cdo material tjeter te huazuar i cili nuk eshte i pershtatshem per qellimet per te cilat eshte germuar karriera.

Kontraktori do te mirembaje brezat ne rripa te karrierave te lira nga bimesia derisa germimet ne karriere te

kene perfunduar. Kontraktorit nuk do t'i jepet e drejta per t'iu lejuar ndonje cmim shtese nga oferta per shkak te kesaj kerkese.

Materialet qe dalin nga prerja ne breza do te depozitohen ne karrierat e perdorura sic parashikohet ne Piken 303.4. (Depozitimi I Materialeve te Germuara). Nuk do te behet pagese direkte per pastrimin, prerjen ne breza te karrieres. Kostoja per punime te tilla do te perfshihet ne cmimin e ofertes tek punimet perkatese, aty ku do te prodoren materiale te tilla.

6.5. Depozitimet e materialeve te germuara

Te gjitha materialet e germuara te cilat nuk mund te prodoren do te ngarkohen per ne vendin e grumbullimit jashte zonen se punes ne cdo distance te miratuar nga Inxhinieri. Si rregull, pervecse kur specifikohet ndryshe, depozitimi ne vendet e grumbullimit do te kryhet ne perputhje me kushtet e meposhteme:

- Per germimin qe ka lidhje me drenazhet, kanalet kryesore dhe rruget; minimumi ne nje distance prej 5 metra nga ana e jashtme e struktures:
- Per strukturat e themeleve, etj., jashte zones se punimeve.

6.6. Mbushja

Termi "mbushje" tregon formacionin e bazamenteve te ngjeshur ose te pangjeshur, ose te gjithe punimeve te mbushjeve te ngjeshura ose te pangjeshura. Material mbushes do te merret, kur eshte e mundur, nga germimet per kanale, rruge ose drenazhime ose kur mungesa e materialeve te tille ose kur karakteristikat e ket yre materialeve nuk jane sic kerkohet, do te merren nga guroret ose karrierat. Mbushjet per punimet e perhershme do te behen ne gjeresine, gjatesine, thellesine drejtimin dhe pjerresine sic specifikohet ose tregohet ne Projekt Zbatim, me cfaredo materiali qe mendohet i pershtatshem.

Para fillimit te mbushjes, Kontraktori do t'i paraqese Inxhinierit propozimet e tij programin per punimet e dheut per perdorim optimal te materialeve te germimit. Punimet e dheut nuk do te fillojne pa marre miratimin e propozimit nga Inxhinieri.

Te gjitha materialet per mbushje duhet te jene te lira nga guret dhe materiale te tjera te demshme organike.

Materiali mbushes per ngjeshje duhet te kete nje permbajtje lageshtie rreth + 1 te optimalet te percaktuar nga Prova No. 12 e B.S. 1377. Lageshtimi duhet te kryhet ne menyre te tille per te siguruar shperndarjen e mundshme te ujit plotesisht ne shtresat qe do te ngjishen dhe operim i l ngjeshjes do te zbatohet derisa permbajtja e lageshtise te mbetet brenda nromave te specifikuara.

Para mbushjes me materialin e duhur, siperfaqe e germimit dhe cdo shtrese pasuese e mbushjes do te shkri ftohet. Mbushja do te behet ne shtresa jo me shume se 250mm trashesi do te ngjeshet plotesisht per te arritur nje densitet jo me pak se 95 e maksimumit te mbikqyrur te densitetit te thate sic percaktohet ne Prova No. 12 e B.S. 1377. Densiteti i thate ne vend i mbushjes se ngjeshur do te percaktohet nga zevendesimi i reres me metoden e pershkruar ne B.S. 1377 me te pakten nje prove te tille te kryer per 1000 m² per cdo shtrese.

Eshte e rendesishme qe materiali mbushes te jete i lire nga tretesirat e kripes (sulfatet dhe kloridet), te cilat nuk duhet te kalojne vleren 2% te peshes se materialit. Kendi l ferkimit te brendshem jo me pak se 28° kur provohet me densitetin qe o korrpondon atij te arritur ne konstruksionin aktual.

Kur kanalet sekondare dhe terciare do te vendosen mbi nivelin e tokes, materialet mbushese do te vendosen dhe ngjeshen si nje i vetem. Volumet e materialeve te germuara me pas nuk do te maten per pagese.

Strukturat mbajtese te ndara do te vendosen kur gjerresia ndermjet dy strukturave mbajtese arrin me shume se 4 metra. Kur strukturat mbajtese kerkohen te ndara, ato do te vendosen 0.5m mbi gjeresine e te dy faqeve dhe me pas do te pritjet ne drejtimin e kerkuar. Volumi i tepert qe do te vendoset nuk do te matet per efekt pagese.

Kontraktori do te marre te gjitha masat e nevojshme per parandalimin e cdo demtimi ose defekti te Punimeve te cilat mund te shkaktohen nga, aktivitetet njerzore, rreshqitja ose renia e dherave dhe do t'i rregulloje ato nese ndodhin deri ne permbushje te udhezimeve te Inxhinierit.

6.6.1 Mbushja me material germimi

Materiali mbushes i ngjeshur perbehet nga material i pershtatshem i hedhur dhe ngjeshur sic specifikohet ne kete ceshtje pas ose rrotull strukturave, tombinove dhe tubave ose per cdo mbushje tjeter sic specifikohet ose tregohet ne Projekt Zbatim si mbushja ose mbushja e ngjeshur.

Mbushja per punimet e muratures do te kryhet me materiale te palidhura ose zhavorre, duke shpallur perdorimin e dherave argjilore ose ne cdo rast tjeter, ato te rrezikuara per rritjen e volumit kur jane me lkageshti ose absorbimin e ujit. Eshte e ndaluar te kryhen mbushje mbas mureve te sapo ndertuara. Mbushja per germimet do te behet me nje permbajtje lageshtie jo me pak se 14%, sipas shtresave horizontale 25 cm te trasha dhe ngjeshur me dore ose me perdorimin e plateve vibruese.

Kontraktori do te mbushet dhe ngjeshet me kujdes rrotull strukturave, themeleve dhe tubave dhe do te marre masa te tilla, duke perfshire kur eshte e nevojshme, hedhjen me dore te materialit mbushes, derisa Inxhinieri te sigurohet qe nuk do te shkaktohen demtime.

Kur materiali mbushes duhet deri lart ose mbi strukture, mbushja duhet te behet e barabarte ne cdo ane, ose perndryshe sic eshte rene dakort me Inxhinierin, ne menyre qe te mos kete presione te ndryshme qe mund te shkaktoj ne demtime ne strukture.

Kur tregohet ne Vizatime ose kur udhezohet nga Inxhinieri, materiali mbushes poshte themeleve do te perbehet nga rera te ngjeshura ose zhavorr pergjithesisht I vendosur mbi nje cipe pelhure, me qellim permiresimin e tabanit te themelit.

Materiali mbushes poshte strukturave do te kete te njejta karakteristika sic specifikohet per materialet e nenbazes se rrugeve.

Per mbushjen e strukturave kryesore, si stacione pompimi, materiali i vendit, per nje thellesi minimale 2 mposhte kuotes se themelit, do te zevendesohet me material te perzgjedhur nga zona e karrieres. Karakteristika minimale e kerkuar eshte kendi i ferki mit 30°.

6.6.2. Skrapatet, Argjinaturat

Vendi do te pastrohet nga te gjitha materialet e demshme te ndertimeve te meparshme.

Skarpata dhe mbushjet do te behen si zakonisht me material me strukture te grimtuar te qendrueshme per qellimin e menduar dhe te lire nga materialet e demshme.

Kontraktori do t'i paraqese Inxhinierit listen e burimeve prej te cilave ai propozon te marre materialin mbushes dhe metodet e propozuar prej tij per transportimin e ketij materiali ne Kantier, nqs materiali i duhur nuk eshte ne vend.

Kontraktori do te zbatoje metoden e vzhgimit dhe te testimi te materialeve sic kerkohet, per te siguruar mjaftueshmerine dhe kosistencen e duhur te materialit.

Skarpataet dhe bazamentet mbajtese do te ngjeshen ne shtresa te cilat nuk duhet te jene te trasha me shume se 150 mm mbas ngjeshjes dhe materiali I ngjeshur te kete nje densitet jo me pak se 95% te te maskimuit te densitetit te thate te percaktuar sipas Proves No. 13 BS 1377. Gjate ngjeshjes materiali duhet te jete i shpemdare uniformisht dhe i mirembajtur jo me i thate se 3% poshte perqindjes optimale te lageshtise sic percaktohet nga Prova No. 13 BS 1377, dhe jo me te lagura se ajo e kerkuar per punimet e zbatueshme praktike sic percaktohet sipas provave te ngjeshjes ne fushe.

Skarpatat, argjinaturat do te ndertohen barabar ne te gjitha gjeresine dhe duhet te ruhen me nje densitet ne siperfaqed dhe pjerresi te mjaftueshme te seksionit per ne shkarkimin e ujrave. Kontraktori do te programoje punen e tij qe shtresat pasuese te mbushen ne kohe per te eliminuar tharjen dhe plasaritjet e shtresave te ngjeshura me pare, deri sa shtresa e poshtme eshte mbuluar nga shtresa e siperme.

6.7. Ndikimet me te rendesishme gjate zbatimit te ketij projekti

Ky projekt do te ndikoj ne mjedis ne tre fazet kryesore, te cilat jane:

1. *Gjate ndertimit.*
2. *Pasi perfundon se funksionuari.*

a) Ne cilesine e ajrit

- Nga pajisjet operuese gjate aktiviteteve ndertimore.
 - Aktivitetet operuese gjate ndertimit te objektit mund te shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne zone, te cilat shkaktohen si rezultat i çlirimit te gazeve te makinerive te ndertimit dhe mirembajtjes.
 - Emetimet ne ajer mund te shkatohen nga gazrat e motoreve me djegie te brendshme te makinerive te ngarkimit(me rendesi emetimi i Pb-it nga motore me lende djegese benzine) dhe te transportuesve qe do te perdoren gjate ndertimit(prania e impiantit te cimentos, betonieret, etj).
- Nga punimet ne sheshin e ndertimit.
 - Do te kete prishje e objekteve ekzistese ne kete zone pasi ka objekte ne kete prone, dhe zbatuesi i punimeve duhet te beje kujdes gjate prishjes.
 - Punimet e germimit mund te shkaktojne shperndarjen e pluhurave ne atmosfere dhe uljen e cilesise se ajrit ne zone.
 - Gjate transportimit te mbetjeve ndertimore(inerteve) dhe gjate depozitimit te materialeve te nevojshme gjate ndertimit.

b) Vibrimi dhe zhurmat

Zhurmat janë një ndikim i pashmangshëm mbi mjedisin gjatë ndërtimit. Zhurma mund të kufizohet duke ndjekur praktikat e mirë-administrimit (pajisje/makineri të kalibruara) që nënkuptojnë se punimet do të kryhen vetëm gjatë orarit të rregullt të turneve të punës.

Pajisjet e ndërtimit do të plotësojnë të gjithë standartet e zbatueshme të Direktivës së BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Kjo Direktivë zbatohet për prodhuesit e pajisjeve që shkaktojnë zhurmë. Të gjithë pajisjet duhet të mirëmbahen në gjendje të mirë pune.

Oraret e transportimit të materialeve të ndërtimit në rrugët e daljes do të caktohen me kujdes në mënyrë që të mënjanohet çdo shqetësim i trafikut lokal. Funksionimi i sheshit do të ndalohej nga ora 19.00 – 7.00, çdo ditë.

Ndotja nga zhurmat mund të vijë nga përdorimi i makinerive në ambientin e punës. Në projektin tonë të marre në studim, zhurmat do të shkaktohen kryesisht nga puna gjatë fazës së ndërtimit e mjeteve të renda të germimit, të transportit, të ngarkimit shkarkimit.

Megjithatë, niveli i zhurmave të krijuara do të jetë në përputhje me udhezimin e përmenduar më sipër, dhe nuk do të kalojë këtu kufi.

Zhurma do të jetë e perkohshme dhe nuk do të ketë akumulim të saj nga receptori tjetër.

Paksa të ekspozura nga këto zhurmave do të jenë punonjësit që do të punojnë në kantiere, për të cilët do të kërkohej zbatim i masave të sigurimit teknik në punë dhe misdis të tjerash dhe përdorimi i kufjeve. Zona e banuar ndodhet larg objektit ku do të ndërtohet

Disa burime që do të shkaktojnë zhurmat dhe vibrimet janë të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- *Si pasojë e punës së mjeteve të ngarkimit dhe të transportit të materialeve apo inerteve:* Ndikime nga zhurmat do të shkaktohen nga mjetet e ndërtimit siç mund të jenë; vinci, buldozëri, betonier, betonierat e vegjel, eskavatore, kamionat që transportojnë materialet e ndërtimit, etj.
- *Të shkaktohen gjatë ndërtimit të karabinasave dhe gjatë përfundimit të objektit:* Gjatë ndërtimit të karabinasave do të ndikojnë në rritje të nivelit të ndotjes akustike, por ndikimi i tyre do të jetë i perkohshëm vetëm gjatë ndërtimit. Do të shkaktohet zhurmë dhe gjatë montimit të pajisjeve të nevojshme për këto objekt.
- *Të shkaktohen nga prania e punonjësve në kantiere:* Prania e punonjësve do të ketë ndikim në rritje të nivelit të zhurmave nga bisedat e tyre sidomos gjatë orëve të natës.
- *Të shkaktohen gjatë kalimit të mjeteve të ndërtimit të tonazhit të lartë:* Do të ndihen vibrime në mjedisin aty pranë. Do të shkaktohen vibrime dhe nga vibratori i llacit që do të përdoret për të realizuar shpërndarjen e llacit mirë nëpër kalëpin e kollonave, etj.

Gjate ndertimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjesve te ndertimit dhe si dhe ne mjedis e banuar aty prane sheshit te ndertimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta.

Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma e pergjithshme e krijuar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit aplikojne teknologjine me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritje te shpenzimeve operative. Matjet shkencore kane treguar nje ulje prej te pakten 35-40% te nivelit te impaktit te vibrimeve.

c) Ndotja e tokes dhe e ujrave

Nuk pritet ndotje e dheut dhe ujit, meqenese ajo mund te parandalohet. Megjithate, disa rritje te ndotjes se ujit dhe dheut mund te shkaktohen nga ndotjet e drejtperdrejta apo te terthorta per shkak te derdhjeve aksidentale apo perdorimit te pakujdesshem te materialeve te rrezikshme si karburantet, lubrifikantet e pajisjeve, bojrat, verniqet, etj.

Ndikimet e mundshme dhe pasojat e tyre mbi ujrat sipërfaqësore gjatë ndërtimit, përfshijnë: magazinimin e pasaktë të karburanteve nga kotnraktori dhe veprimtaritë në shesh që mund të sjellin ndonjë derdhje aksidentale të lëngjeve apo rrjedhjeve të ndotura, dhe përkeqësimi si pasojë e cilësisë së ujrave sipërfaqësore. .

Sheshi do të ketë masa të përshtatshme për kontrollin e erozionit dhe sedimenteve, siç janë dengjet e kashtës dhe rrethimet me baltë për të parandaluar lëvizjen e sedimenteve dhe shkaktimin e turbullirave të tepërta në kanalet e afërta.

Mbajtja e materialeve të stivosura të ndërtimit duhet të shmanget. Nëse kërkohet përkohësisht, duhet të krijohet kushte të përshtatshme magazinimi në sheshin e ndërtimit, si p.sh. përdorimi i mbulesave për mbrojtjen ndaj kushteve atmosferike. Materialet e rrezikshme (lubrifikantët, vajrat, etj.) duhet të mbahen mbi sipërfaqe të papërshkueshme, dhe absorbentët si rëra apo tallashi duhet të jenë të disponueshme për trajtimin e shpejtë të derdhjeve aksidentale. Të gjithë materialet duhet të trajtohen në përputhje me udhëzimet e përfshira në Material Safety Data Sheets (MSDS) të ndodhura në sheshin e ndërtimit. Trainimi i personelit operativ si dhe personelit ndërtues do të vazhdojë.

Nëse do të ketë nevojë për instalimin e depozitave për karburantet, ato do të kenë depozita dytësore me volum të mjaftueshëm për të mbajtur një derdhje nga depozita më e madhe në strukturë. Zona e mbajtjes do të ketë një mjet (pompa) për të hequr ujin e grumbulluar.

Për burimet e materialeve do të përdoren vetëm veprimtari të licensuara të gurorëve, asfaltit dhe çakullit.

Nuk duhet të hidhet dhe sipërfaqësor i hequr, por të ruhet në shesh për rehabilitim pas përfundimit të punimeve. çdo pemë ekzistuese dhe bimësi e vlefshme duhet të ruhet gjithashtu dhe të përdoret më vonë për rehabilitim

Disa ndikime ne toke:

- *Ndikime nga efekti i erozionit:* Kjo zone nuk ka predispozim te theksuar per erozion ne sipërfaqe, eshte ne nivele te paperfillshme pasi territori eshte i rrafshete. Ky fenomen mund te haset gjate germimit te dheut per ndertimin e themeleve. Per te parandaluar kete fenomen(ne raste se e hasim gjate germimit te dheut) duhen marrim masa ne menyre qe te sigurohen te gjithë veprimet e nevojshme qe jane parashikuar per te siguruar qendrueshmerine e objekteve perreth.
- *Ndikimet fizike te projektit me ndryshime topografike lokale:* Gjate shfrytezimit nuk do te kete ndryshime te medha ne topografine lokale pasi ne pergjithesi sheshi eshte i rrafshet dhe nuk do te behet nivelim i sheshit te ndertimit. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtim i tille shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare si te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne ndryshime topografike.
- *Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve ne toke dhe rrethina:* Ndertimi i objektit parashikon vetem shfrytezimin e inerteve, nuk ka derdhje apo shkarkime te ngurta ose te gazta ne ambient te elementeve kimik ose te tjere element te demshem apo te rrezikshem per mjedisin. Ndikim nga lendet djegese mund te shkatohen vetem ne raste te carjeve te serbatorit te mjeteve te ndertimit, apo pikimeve te tyre gjate qarkullimit ne sheshin e ndertimit.
- *Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore:* Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit ka qene truall toke i llojit are, ishte toke e lene djerre. Zone ne studim nuk eshte zene nga ndertime apo objekte banimi. Ndikimi ne kete sipërfaqe, nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore sepse toka e kesaj zone e ka koeficientin e humusit te ulet dhe pak acid e cila çon ne nje rendiment te ulet te kesaj zone per kultivime bujqesore me kapacitet te lart.
- *Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones:* Projekti i parashikuar nuk ndikon ne modelin e drenazhimit se nuk ekzistojne vepra drenazhimi ne zonen e projektuar perreth zones, ne kufirin prane kesaj zone ndodhet veten nje segment i vogel i nje kanali ekzistues per kullimin e ujerave qe mbidheshin nga keto sipërfaqe toke. Ky kanal nuk eshte ne gjendje te mire pasi nuk eshte kujdesur askush per pastrimin e tij nga llumrat qe vijne se bashku me prurjet nga rrekete ujore te kesaj zone. Ne kete zone nuk do te ndikohet ne rrjetin e drenazhimit pasi ujerat e ndryshme qe do dalin gjate hapjeve te themeleve do te largohen nga zona me ane te autoboteve dhe do te shkarkohen ne nje mjedis prites qe ka te njejta parametra, pra vendi ku do te shkarkohen keto ujera do te percaktohet nga institucionet pergjegjese per kete veprimtari. Ndersa ne raste avarie nuk do te ndikohet sepse do te

perdoret rrjeti rezerve i emergjencave (do te ndertohet vetem kur te jete e nevojshme dhe e domosdoshme dhe do te percaktohet nga kontraktori).

6.8. Ndikime te tjera indirekte qe shoqerojne projektin

6.8.1 Ndikime nga trafiku qe lidhen me projektin

Efektet mbi infrastrukturen perreth parashikohen te jene edhe pozitive edhe negative. Ne pergjithesi mund te thuhet se perdorimi i rrugeve te caktuara per aktivitetin e nderimit apo transportin e mbetjeve inerte do te kete efekte negative mbi cilesine e rrugeve te perdorura. Persa i perket rrjedhave te tjera te trafikut, kjo s'mund te shihet si nje efekt i rendesishem. Nje efekt pozitiv mund te evidentohet gjate fazes ndertimore ne rastet e perfshirjes se restaurimit dhe forcimit te infrastruktures rrugore (kontroll erozioni, drenazhe per ujrart e stuhive, mure mbajtese, rregullim terreni, etj.)

Gjate ndertimit te objektit do te kete ndikime ne trafikun rrugor, por jo ne trafikun ajror, hekurudhor dhe lumor. Objekti lidhet me rrugen dytesore, pra transporti i materialeve te ndertimit nuk do te behen pengese per qarkullimin ne kete zone.

Ne menyre te permbledhur po paraqesim efektet kryesore qe ndikojne ne mjedis.

6.8.2 Gjenerimi i mbetjeve gjate fazes se ndertimit

Prodhimi i mbetjeve pritet te ketë ndikimin më të rëndësishëm mjedisor. Punimet e parashikuara në kuadrin e projektit do të prodhojnë disa lloje mbetjesh. Ato janë klasifikuar sipas katalogut evropian të mbetjeve dhe listës së mbetjeve të rrezikshme meqënëse Republika e Shqipërisë po përafron legjislacionin me atë të BE-së. Në këtë kapitull janë paraqitur vetëm emri i grupeve të mbetjeve, të shënuar me numra sin ë katalogun evropian të mbetjeve. Në secilin grup, llojet e mbetjeve mund të shënohen me yll (*) i cili përfaqëson mbetjet e rrezikshme. Nën-grupi i saktë i mbetjeve me numrin e tij identifikues do të identifikohet në vendndodhje.

Llojet e grupeve kryesore të mbetjeve që mund të priten në zonë mund të jenë si më poshtë por nuk përjashtohen mbetje të tjera:

- 08 Mbetjet nga prodhimi, formulimi, furnizimi dhe përdorimi i shtresave (bojra, verniqeve dhe smalteve të qelqta), izolantëve dhe bojrave të printimit;
- 13 Mbetjet e vajrave dhe mbetjet e karburanteve të lëngshme (siç janë vajrat hidraulike nga pajisjet)
- 15 Mbetjet e paketimeve; absorbentët, leckat për fshirje, materialet e filtrave dhe veshjet mbrojtëse, të cilat nuk specifikohet ndryshe;
- 17 Mbetjet e ndertimit dhe shembjeve (përfshirë dheun e gërmuar nga vendet e ndotura);

20 Mbetjet bashkiake (mbetjet e familjeve, dhe mbetje të ngjashme tregtare, industriale dhe institucionale) përfshirë copat e mbledhura veçmas.

Mbetjet e rrezikshme priten në sasi të vogla. Në ndërtimet e reja ato do të përfshijnë mbetje të ndryshme të verniqeve, bojrave, si dhe mbetjet e vajrave nga pajisjet. Këto mbetje nuk duhet të përzihen me mbetjet e ngurta. Kontraktori është i detyruar të ketë kontejnerë të veçantë të etiketuar për këto lloj mbetjesh.

Për mbetjet e rrezikshme, kontraktori duhet të ndjekë procedurën e ndarjes së mbetjeve të rrezikshme në vend. Kontraktori duhet t'i dorëzojë mbetjet tek kompania e autorizuar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të plotësojë dokumentacionin shoqërues i cili duhet të mbahet si provë e praktikës së mirë në administrimin e mbetjeve.

Është shumë e rekomandueshme të ndahen llojet e ndryshme të mbetjeve (ambalazhet plastike dhe të qelqit), për të cilat ekzistojnë sisteme të veçanta grumbullimi/riciklimi në vend, nga ato mbetje që janë të pariciklueshme dhe të dërgohen në pikat e përshtatshme të grumbullimit së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar. Sheshi i ndërtimit do të pastrohet dhe të gjithë hedhurinat dhe materialet e mbetjeve do të eliminohen në përputhje me klauzolat e specifikuar në preventivat. Djegia apo hedhja e paligjshme e mbeturinave është rreptësisht e ndaluar. Mbetjet bashkiake dhe mbetjet e tjera do të duhet të mblidhen në kontejnerë të veçantë për këtë qëllim dhe të largohen rregullisht.

Dheu i gërmuar nga sheshi, për shkak të përqendrimit të lartë të Cr dhe Ni duhet të hiqet dhe të depozitohet në një vend i cili do të miratohet së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe autoritetet në Komune. Përpara largimit të dheut të gërmuar, sheshi duhet të vizitohet edhe nga konsulenti mjedisor i i cili do të informojë MM në lidhje me zgjedhjen, duke dhënë një justifikim të shkurtër për sheshin.

Administrimi i mbetjeve gjatë fazës së ndërtimit duhet të behet në përputhje me kërkesat dhe rregullat e vendosur autoritetet lokale. Të sunohet ripërdorimi i mbetjeve të ngurta, por edhe kur kjo nuk është e mundur depozitimi i tyre të behet me leje të institucioneve perkete dhe në vendin e caktuar për këtë qëllim.

6.8.3. Zbulimet arkeologjike rastesore

Nuk ka zona të rëndësishme arkeologjike në afërsi të sheshit, prandaj nuk kërkohen masa të veçanta mbrojtëse arkeologjike. Megjithatë, nëse gjatë gërmimeve zbulohen disa mbetje arkeologjike, punimet do të ndërpriten menjëherë dhe do të informohet autoriteti lokal kompetent. Punimet do të rifillojnë vetëm pasi

të jenë marrë masat e duhura, të kërkuara nga autoriteti përkatës dhe të jetë marrë konfirmimi që punimet mund të vazhdojnë.

6.8.4. Impakti ne toke dhe ujrat nenetokesore

Punimet e ndertimit nuk do te shkaktojne prishje te regjimit te ujrave nentokesore te zones ku dhe ndodhet sheshi i ndertimit dhe ne sistemin e kullimit dhe drenazhimit. Kanalet e kullimit te zones do te lidhen me kanalet e shkarkimit te sheshit te projektit por pa nderhyrje qe do te prishe sistemin e funksionimit te tyre. Ujrat qe do te shkaktohen nga germimet ne themel do te jene te se njejtës natyre me ate te kanaleve kulluese te zone, pak me shume te ngarkuara me llumra argjile per shkak te perberesjes gjeologjike te zones. Ujrat nuk do te jene te ngarkuara nga emulsione hidrokarbure ose shkarkime te lendeve kimike te ndryshme. Ato nuk do te prishin cilesine e ujrave te kanaleve ekzistuese.

Gjate ndertimit do te kemi vetem ndryshime siperfaqesore te topgrafise se terrenit, nga germimet dhe zhvendosjet e dheut

6.8.5. Flora and Fauna

Sheshi dhe territori perreth ku do te zbatohet projekti nuk perben ndonje zone me ndjeshmeri dhe me status te vecante mbrojtje.

Territori mbi te cilin eshte percaktuar sheshi i ndertimit do te zhvishet komplet nga shtresa e vegjetacionit, keshtu qe habitati i flores ne kete zone do te shkatërrohet. Por, pas perfundimit te punimeve te ndertimit, zona do te rehabilitohet dhe do te mbillet me bar.

Projekti nuk parashikon perdorimin e substancave ose materialeve qe jane te rrezikshme ose toksike per shendetin e njerezve dhe floren e faunen, si dhe furnizimin me uje.

Sidoqofte veprimtarite ndertuese qe do te shoqerojne realizimin e ketij projekti nuk do te kene ndikim te rendesishem ne mjedis. Ndikim minial pritet te kete mbi zvarraniket e zones dhe mbi shpendet.

6.9. Efektet kryesore negative

- *Gjate periudhes se zbatimit te projektit shfaqen keto efekte:*
 - a) Çlirimi i pluhurave gjate germimit te themeleve te godines.
 - b) Gjate kohes se kryerjes se ndertimit do te kete zhurma te cilat shkaktohen si rezultat i perdorimit te makinerive te renda dhe qe do te vazhdojne deri ne momentin e perfundimit te punimeve, te cilat afersisht mendohen te zgjasin per nje periudhe 25 mujore.
 - c) Prania e grumbujve me dhe ne mjedisin e zones prish imazhin e zones perreth.
 - d) Ne nivelin e ujerat nentokesor gjate germimit te tokes per hapjen e themeleve, etj.

- a) Prishja e imazhit te zones gjate periudhes se ndertimit nga prania e mjeteve te tonazhit te rende, si hapja e gropave e shume te tjera.
- e) Konsumimi i energjise elektrike.
- f) Kosumimi i materialeve te ndertimit dhe i burimeve te tjera te nevojshme per ndertimin e ketij objekti.

6.10. Efektet kryesore pozitive

- a) Investitori nje pjese te truallit do ta shfrytezoj me koeficient racional urbanistike, per ta shfrytezuar ne menyre optimale si dhe gjelberim i mjedisit perreth me koeficient te larte gjelberimi.
- b) Me ndertimin e objektit aktivizohet me tej plani i sistemimit te jashtme, ku perfshihen hapesira te gjelberuara, rruge te brendshme dhe rrjet inxhinierik dhe ndricim te jashtem.
- c) Aktiviteti i ndertimit nuk do te shkaktoje ndotje tokes, pasi nuk ka dhe as do te kete shkarkime ne mjedis te hapur dhe do te jene gjithmon nen kontroll te supervizorit te punimeve.
- d) Ndertimi do te kete realizohet konform kushteve teknike dhe planit te menaxhimit te mjedisit(PMM).
- e) Nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore, pasi te gjitha ujerat e nxjera gjate germimit do te shkarkohen ne vendin perkates qe do te percaktohen nga institucionet pergjegjese.
- f) Punesim gjate fazes se ndertimit.

6.11. MASAT MBROJTESE

Masa mbrojtese dhe parandaluese qe rekomandohen gjate fazes se ndertimit

Kërkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësisë e vlerave të tokes, të territoreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave të gjelbëruara

- *Rrethimi* i zones se ndertimit do te behet me llamarine ne te gjithe perimetrin e saj per te shmangur daljen e gjithfare mbeturinash inerte, per te bere nje plan organizimi sa me te mire te objektit dhe per te shmangur gjithashtu impaktin negativ qe krijojne punimet.
- *Largimi i dherave qe do te dalin gjate hapjes se themeleve*, do te kryhet brenda nje kohe shume te shkurter nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje ne ambientin perreth. Largimi i tyre te behet naten duke marre masa per te mos ndotur rruget. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat qe transportohen dhe duke i lare gomat e makinave para se te dalin nga sheshi i ndertimit. Mbetjet urbane do te grumbullohen ne perfundim te objektit ne vende te caktuara nga Komuna.
- *Rrjetat mbrojtese* per minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve do te vendosen ne perfundim te karabinase.
- *Realizimi i infrastruktures* se brendshme rrugore do te realizohet ne perputhje me studimin urbanistik te zones perkatese duke i lene vend edhe siperfaqes se gjelbert sipas projektit.

- *Nga sipërfaqja totale* e sheshit të ndërtimit 62% e saj do të jetë e zënë me ndërtim. Pjesa tjetër do të jetë e gjitha zona funksionale që do t'i shërbejë objektit me sip. parkimi, gjelberimi dhe rrugë kryesore e dytesore.
- *Kantieri i ndërtimit* do të jetë i rrethuar me llamarinë deri në përfundimin e rifiniturës dhe ambjentëve për rreth objektit.
- *Mbeturinat në përfundimin e ndërtimit* do të grumbullohen, transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Komuna.
- *Ndërhyrjet në rrjetin e infrastrukurës* do të kryhen me lejen e institucioneve përkatëse sipas ligjeve në fuqi.
- Ndërtimi do të kryhet nën kontrollin e inspektoreve të mjedisit të Komunes, për të matur ndotjet në mjedis të cilat nuk duhet t'i kalojnë parametrat e lejuar.

Masat konkrete për mbrojtjen e cilësisë së ajrit

Me qëllim që shkarkimet në ajër që emeton veprimtaria ndërtuese të jenë vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjektet ndërtues, marrin këto masa:

- a. të përdoren mbulesa të përkohëshme dhe të lagen sipas nevojës, një deri dy herë në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave;
- b. për lëvizjen e materialeve në kantier e në sheshe ndërtimi, të përdoren konvejerë të mbyllur;
- c. të mirëmbahet sheshi i ndërtimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të nivelimit, ndërtimit dhe transportit;
- d. të gjitha ngarkesat të sigurohen nëpërmjet rregullimit, lagies ose mjete të tjera për të parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- e. të gjitha materialet e transportuara jashtë sheshit të ndërtimit të jenë të lagura në mënyrë të mjaftueshme ose të mbuluara mirë;
- f. të gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndërtimit dhe transportit të ndërpriten gjatë periudhave me erë të fortë;
- g. të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së kamionëve në kalimet e sheshit të ndërtimit, deri në 30 km/orë;
- h. të ndalohet përgatitja dhe përpunimi i bitumeve në temperatura të larta në kantieret e ndërtimit dhe të përdoren bitume që kanë shkallë të vogël çlirimesh të ndotësve në ajër;
- i. të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbeturinat e ekspozuara ndaj erës;
- j. gjatë kryerjes së proceseve të rifiniturës (suvatim, lyerje, veshje fasade), objekti të jetë i mbuluar me rrjeta mbrojtëse.

Masat konkrete për administrimin e mbetjeve të ngurta

Subjektet ndërtues të godinave, rrugëve, urave, shesheve, trotuareve, administrojnë mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtuese, duke marrë këto masa:

- a. mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndertimore, të sistemohen të ndara e të veçuara sipas llojit të tyre, në vende të paracaktuara që më parë për qëndrimin e tyre provizor;
- b. mbetjet të largohen çdo ditë nga sheshi i ndertimit dhe të dërgohen në vendgrumbullimet e përcaktuara nga pushteti vendor;
- c. transportimi i tyre të bëhet në orët me trafik të pakësuar;
- d. për transportin e materialeve dhe të mbetjeve të përdoren makina të mbulura dhe që nuk rrjedhin;
- e. mbetjet toksike të dërgohen në një vend depozitim të miratuar posaçërisht për to;
- f. të pastrohen menjëherë rrjedhjet, derdhjet, pikimet për të parandaluar ndotjen e tokës;
- g. të shtrohen me zhavorr dhe të mirembahen rrugët brenda sheshit të ndertimit;
- h. shërbimet dhe riparimet e makinerive e të pajisjeve të bëhen sipas grafikut dhe në vende të përcaktuara për këtë qëllim;
- i. të lahen gomat e automjeteve para daljes nga sheshi i ndertimit.

Masat konkrete për mbrojtjen nga zhurmat

Në çdo kantier ose shesh ndertimi, subjektet ndertues, hartojnë dhe zbatojnë programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat, i cili synon:

- a. të respektohen standardet për nivelin e zhurmave;
- b. aktivitetet e prishjes dhe të ndertimit, të kufizohen në orët që sjellin shqetësime për banorët përreth;
- c. aktivitetet e prishjes dhe ndertimit të programohen sipas një grafiku në mënyrë që të evitohet operimi i disa pajisjeve e makinerive në të njëjtën kohë i cili shkakton nivele të larta zhurmash;
- d. makinerite e pajisjet e fuqishme të ndertimit, si dhe ato që gjenerojne zhurma mbi kufijtë e lejuar, të jenë të pajisura me ekrane mbrojtës për zhurmat.

6.12. Masa mbrojtese gjate funksionimit.

6.12.1. Instalimi i sistemit te klorinimit (IE- 10).

Ky sistem ndryshon nga ekzistuesi dhe eshte i perbere nga:

- Rezervuari i klorit 6000 Litra
- Grupi prej 3 el/pompa per klorin.
- Injektoret dhe sistemi i tubacioneve te klorit.

Klori i perdorur duhet te jete i lengeshem dhe me 15% perqendrim.Klori vjen ne objekt me autobot klori dhe me tubacion lidhet me saracinesken ne hyrje te impjantit te klorit ku me anen e pompes se ngarkimit klori dergohet ne rezervuarin 6000 Litra qe paraqet konsumin mujor te klorit ne stacion.

Impjanti i klorit perbehet nga tre pompa klori me 15 Litra/ore dhe $P=20\text{bar}$ sejcila dy do te perdoren per dy linjat derguese te ujit dhe e treta eshte rezerve.

Parimi i punes i ketij sistemi klorinimi eshte si me poshte :

Pompat e klorit injektojne klor ne tubin e dergimit dhe mbas 30-50 m sistemi merr kampion nga uji i klorinuar dhe ben analizen e klorit ne uje dhe duke kombinuar me kerkesat e perfaqesueseve te higjenes ne qytet korrigohet perqindja e klorit ne sistemin e pompave sipas kerkeses, ky rregjistrim behet nje here dhe pastaj ne menyre automatike sistemi bene rregullimin e klorit sipas kerkesave te zyrat e higjenes qe kontrollojne cilesine e ujit.

6.12.2. Impjanti rrufeprites dhe tokezimit (IE-12,13)

-Impjanti rrufeprites (1E-12)

Do te realizohet me anen e nje konturi me shirit celiku te zinguar 30x4 mm qe mbulon taracen e godines duke e ndare ne kuadrate 4x4 m. Ne kater kendet e konturit lidhet me impjantin e tokezimit me anen e perciellsit te cveshur bakri me seksin 35mm². Ne lartesisin deri 2m ky percelles mbrohet me anen e kanalave izoluese. Per kontrollin e rezistences se tokezimit jane dhe puseta kontrolli. Impjanti tokezimit eshte i realizuar per TM dhe TU ne menyre te perbashket.

6.12.3. Impjanti tokezimit (IE-13)

Do te realizohet ne forme konturi me percielles te cveshur bakri 35 mm² i futur ne kanal me thellesi 50 cm rreth godines. Ky kontur tokezohe nga 12 elektroda te vendosura ne distance 5m nga njera tjetra. Konturi lidhet me dy perciellsa te cveshur 1 x35mm² me tre zbarre bakri 500x50x5mm qe vendosen ne dhomen e TM IOKV dhe dy dhomat e transformatoreve gjithashtu po me dy perciellsa te tjere lidhet zb arra e tokes se PSHTU ne dhomen e TU.

Ne keto zbarra lidhen:

-Tokezimet e PTM 10kV me percielles 1x35mm²

-Nuli i transformatorit me percielles 2x240mm²

-Zbarra e tokezimit te transformatoreve me nulin e automateve te PHTR-1 dhe PHTR-2 me percielles 2x1x240mm².

-Kazan i transformatorit me percielles 1x95mm²

-Pjeset metalike te paneleve te TU me percielles 1x95mm²

- Tokezimi i elektropompave me percielles 1 x95mm²

Si dhe gjithë pjesët metalike që nuk janë nën tension që për ndonjë arsye të prishjes së izolimit mund të bien nën tension. Nga mat jet duhet të rezultoi që rezistenca e tokezimit nuk duhet të jete me e madhe se $R_{tok} < 4\Omega$.

6.12.4. Masat mbrojtese kunder renies nen tension

Per te mbrojtur personelin qe do te kryej sherbimn ne stacionin e pompave paisjet elektrike te TM dhe TU jane te mbrojtura me shkalle mbrojtje IP3X dhe jane te paisura me celes.Paisjet e TM dhe TU nuk mund te hapen pa u ckycur celesi kryesor i panelit dhe pastal mundet te hapet porta e panelit.Pjeset nen tension te paisjeve jane te mbrojtura me barriera isolante ndersa kabllot e TM dhe TU jane te futura ne kanalina metalike. Per nevojat e stacionit qendror te pompave per energji elektrike si ndricim,priza automatet shperndares te energjise elektrike duhet te jene te tipit diferenzial me rryme ckycje 30 mA.

7. Monitorimi i mjedisit

7.1. Monitorimi i Mjedisit

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet ende një ndër çështjet parësore për institucionet shtetërore në vendin tonë. Pavarësisht nga puna për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë drejtim, mungesa e një sistemi të plotë monitorues për komponentet e ndryshme mjedisore dhe të shtrirë në të gjithë vendin, bashkëshoqërohet me një pamje të mangët mbi gjendjen e mjedisit dhe prirjet e tij në kohë.

Një sistem monitorimi i përshtatshëm dhe në përputhje me standardet më të përparuara europiane do të ndihmojë për grumbullimin e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e prirjeve të zhvillimit, jo vetëm të mjedisit, por edhe të atij kombëtar në tërësi. Për më tepër, ai do të jetë një mundësi e mirë për dhënien e informacionit të saktë dhe të shpeshtë publikut të interesuar, duke ndihmuar përfshirjen e më shumë subjekteve dhe individëve në vendimmarrjen mjedisore.

Nga ana tjetër, përvoja e grumbulluar përgjatë disa dhjetëvjeçarëve, në nivelin e institucioneve me traditë në vlerësimin e gjendjes mjedisore është një bazë e mirë për ngritjen dhe përshtatjen e njësisistemi të ri monitorues.

Analizimi i propozimeve të bera nga propozuesi në lidhje me objektivat ka ndihmuar për identifikimin e rreziqeve kryesore gjatë zbatimit si dhe nevojën për të marrë masa për zbutjen e pasojave negative.

Objektivat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm janë thelbësore në rekomandimet e bera për zhvilluesin e aktivitetit.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimin, tashmë, universal të zhvillimit të qëndrueshëm, marrin rëndësi të veçantë evidencimi dhe gjetja e rrugëve dhe e teknologjive më efikase, si për shfrytëzimin sa më racional të pasurive natyrore, ashtu dhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit mbi mjedis dhe sidomos në burimet ujore.

Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 1189, datë 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin e zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit", ndër të tjera, ka përcaktuar treguesit mjedisorë: të gjendjes së mjedisit, të ndikimit në mjedis dhe të trysnisë në mjedis.

Mbi këte baze janë hartuar edhe Indikatoret Kombetar per Monitorimin e Mjedisit dhe eshte duke u punuar per hartimin e Planit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit.

7.1 MONITORIMI MJEDISOR /SOCIAL

PJESA 2: MONITORIMI MJEDISOR /SOCIAL			
A do të përfshijë/përmbajë veprimtaria tek vendi i ndërtimit, ndonjë nga pikat e mëposhtme:	Veprimtaria	Statusi	Referenca shtesë
	A. Rehabilitimi i ndërtesës	[X] Po [X] Jo	Shih seksionin B më poshtë
	B. Ndërtim i ri	[X] Po [] Jo	Shih seksionin B më poshtë
	C. Sistem i vecantë i trajtimit të ujrave të zeza	[] Po [X] Jo	Shih seksionin C më poshtë
	D. Ndërtesë(a) dhe rrethe historike	[] Po [X] Jo	Shih seksionin D më poshtë
	E. Marrje e tokës ¹	[] Po [X] Jo	Shih seksionin E më poshtë
	F. Materiale të rrezikshme ose toksike ²	[] Po [X] Jo	Shih seksionin F më poshtë
	G. Impaktet mbi pyjet dhe/ose zonat e mbrojtura	[] Po [X] Jo	Shih seksionin G më poshtë
	H. Trajtimi / menaxhimi i mbetjeve mjekësore	[] Po [X] Jo	Shih seksionin H më poshtë
	I. Kujdesi ndaj trafikut dhe mbrojtja e kalimtarëve	[X] Po [] No	Shih seksionin I më poshtë

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
A. Kushtet e Përgjithshme	Njoftime dhe Masa mbrojtëse për Punëtorët	(a) Inspektoriatet vendore të ndërtimit dhe të mjedisit janë njoftuar për veprimtaritë e ardhshme (b) Publiku është njoftuar për veprat ndërtuese nëpërmjet publikimeve në media dhe/ose nëpërmjet qendrave të disponueshme publike duke përfshirë edhe vendin e ndërtimit. (c) Janë marë të gjitha lejët e kërkuara ligjërish për ndërtim dhe/ose rehabilitim. (d) Gjithë veprimtaria do të kryhet në një mënyrë të kujdesshme dhe të disiplinuar duke synuar minimizimin e impaktit tek banorët përreth dhe tek mjedisi. (e) PPE të punëtorëve do të respektojnë praktikën e mira ndërkombëtare (duke mbajtur gjithmonë kapele mbrojtëse, maska sipas nevojës dhe syze mbrojtëse, litarë dhe çizme sigurie.) (f) Tabela njoftimesh në vendet e ndërtimit do t'i njoftojnë punëtorët për rregullat thelbësore si edhe rregulloret që duhen zbatuar.
A/1. Demolimi i dy ndërtesave	Cilesia e ajrit	(a) Identifikimi i materailave me permbajtje asbesti (MPA dhe veshjeve me pllaka plumbi brenda ndërtesës që do të demolohet;

¹Marrja e tokave ka të bëjë me zhvendosjen e njerëzve, ndryshimin e kufijve të tokave dhe të pronave private në tokat e blera/ të transferuara që prek njerëzit që jetojnë atje dhe/ose të zaptuesve dhe/ose që merren me një biznes(kioska) në tokën e marë.

² Maeriali toksik / I rrezikshëm përfshin dhe nuk kufizohet tek azbesti, bojrat toksike, largimi I bojrave të plumbit, etj.

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
ekzistuese		(b) Veprime per te minimizuar perhapjen e pluhurave; (c) Masa parandaluese per te siguruar heqjen dhe depozitimimin e sigurve te materialeve me permbajtje asbesti
	Zhurma	(d) Zhurmat gjate ndertimit do te kufizohen ne kohen ne te cilen do te percaktohet ne lejen e dhene nga autoritetet (e) Gjate ndertimit dhe demolimit motorret e gjenaratoreve, kompresoreve te ajrit dhe pajisjeve dhe makinerive te tjera duhet e jene te mbuluar dhe pajisjet duhet te vendosen sa me larg te jete e mundur nga zonat e banuara.
	Cilesia e Ujit dhe e Tokes	(f) Kontrolli i sedimenteve dhe erpzionit gjate demolimit, per te minimizuar feneomenente e erozionit. (g) Menaxhimi i ujrave te shiut per te minimizuar erozionin dhe furnizimi me sediment nga jashte sheshit te ndertimit per te stabilizuar ujrat.
B.Rehabilitim i Përgjithshëm dhe /ose Veprimtari Ndërtimi	Cilësia e Ajrit	(a) Gjatë prishjeve të brendshme përdorni mbrojtëse nga mbeturinat e prishjeve të ndërtesës mbi katin e parë. (b) Mbani mbeturinat nga prishja e ndërtesës në vende të kontrolluara dhe spërkatini ato me ujë me qëllim që të ulet niveli i pluhurit nga mbeturinat e prishjeve. (c) Mos lejoni shpërndarjen e pluhurit gjatë gërmimeve pneumatike/shkatërrimeve të mureve, duke spërkatur vazhdimisht me ujë ose duke instaluar mbrojtëse nga pluhuri ne vendin e ndërtimit. (d) Pastroni mjedisin rrethues (trotualet, rrugët), nga mbetjet me qëllim që të minimizoni pluhurin. (e) Nuk lejohet që të bëhen djegje materialesh apo mbetjesh në vendin e ndërtimit. (f) Duhet mbajtur nën kontroll lëvizja e tepruar e makinave të ndërtimit në vendin e ndërtimit.
	Zhurma	(a) Zhurma e ndërtimeve duhet kufizuar në orët e kufizuara për këtë punë sipas lejës. (b) Gjatë funksionimit të tyre, kapakët e gjeneratorëve, kompresorët e ajrit dhe pajisje të tjera mekanike duhet të jenë të mbyllura dhe pajisjet duhen vendosur sa më larg zonave të banuara që të jetë e mundur.
	Cilësia e Ujit	(a) Vendi i ndërtimit duhet të marrë masat e duhura kundër erozionit dhe sedimentit, si p.sh. ngritjen e pengesave dhe ta gardheve për të penguar daljen e sedimentit nga vendi i ndërtimit duke shkaktuar kështu turbullira në lumenjtë dhe përrenjtë perreth.

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
	Menaxhimi i Mbetjeve	<p>(a) Grumbullimi i mbetjeve dhe vendshkarkimet e tyre do të identifikohen për të gjitha llojet e mbetjeve që do të krijohen nga prishjet dhe nga veprimtaritë ndertuese.</p> <p>(b) Mbetjet nga ndërtimet minerale dhe nga prishjet e ndërtesave, duhet të ndahen nga mbetjet e përgjithshme organike, të lëngjeve, dhe kimike, duke bërë seleksionimin e tyre në vend dhe duke i vendosur në kontenerë të përshtatshëm.</p> <p>(c) Mbetjet nga ndërtimet do të grumbullohen dhe do të shkarkohen në mënyrën e duhur nga kolektorë të licencuar.</p> <p>(d) Do të ruhet dokumentacioni për shakrkimin e plehrave si provë për menaxhimin e mbetjeve sipas kërkesave..</p> <p>(e) Sa herë që kjo do të jetë e mundur, kontraktori do të ripeërdorë dhe do të riciklojë materialet e duhura dhe të përdorshme me perjashtim të azbestit.</p>
C. Sistemi i trajtimit të vecantë ujrave të zeza	Cilësia e Ujit	<p>(h) Qasja për trajtimin e mbetjeve sanitare dhe të ujrave të zeza nga vendet e ndërtimit (instalimi ose rindërtimi) duhet miratuar nga autoritetet vendase.</p> <p>(i) Para se të shkarkohet në ujrat pritëse, duhen trajtuar mbetjet nga sistemet e ujrave të zeza me qëllim që të përmbushin kriteret minimale të cilësisë sipas përcaktimeve të udhëzimeve kombëtare mbi cilësinë e mbetjeve ujore dhe trajtimin e ujrave të zeza.</p> <p>(j) Do të kryhet monitorimi i sistemeve të reja të ujrave të zeza (para/pas)</p>
D. Ndërtesë (a) historike(s)	Trashëgimia kulturore	<p>(a) Në se ndërtesa është një strukturë me rëndësi historike apo shumë pranë një strukture të tillë, apo që ndodhet në një zonë të përcaktuar me rëndësi historike, duhen njoftuar dhe duhen marrë lejë miratimi nga autoritetet vendore dhe duhen kryer gjithë veprimtaritë ndertuese sipas legjislacionit kombëtar.</p> <p>(b) Sigurohuni që të respektohen gjithë dispozitat me qëllim që veprat e artit apo “zbulime të rastit” që bëhen gjatë gërmimeve ose gjatë ndërtimeve, të mbahen shënim, të kontaktohen zyrtarët dhe të pezullohen punërat ndërtimore apo të modifikohen ato duke u marrë parasysh zbulime të tilla.</p>
E. Marrja e tokës	Kuadri/Plani i Marrjes së tokës	<p>(a) Në se shpronësimi i tokës nuk ishte i parashikuar por nevojitet të bëhet, ose në se nuk pritej por mund të ndodhë humbja e aksesit ndaj të ardhurave i përdoruesve të ligjshëm apo të paligjshëm, atëhere duhet konsultuar me Udhëheqësin e Ekipit të Projektit.</p> <p>(b) Do të zbatohet Plani/Kuadri i miratuar i Marrjes së tokës.</p>

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
F. Materiale Toksike	Menaxhimi i Azbestit	<p>(a) Në se azbesti ndodhet në vendin e projektit, duhet paraqitur qartë si material i rrezikshëm.</p> <p>(b) Kur të jetë e mundur, azbesti duhet mbyllur si duhet dhe duhet vulosur me qëllim që të minimizohet ekspozimi i tij.</p> <p>(c) Para se të hiqet, (në se kjo është e nevojshme), azbesti duhet trajtohet me një lëndë lagëse me qëllim që të minimizohet pluhuri i tij.</p> <p>(d) Azbesti duhet trajtuar dhe të shkarkohet nga profesionistë të aftë/me përvojë.</p> <p>(e) Në se materiali i azbestit, depozitohet perkohësisht, mbetjet duhen mbyllur brenda objekteve të mbyllura të etiketuara si duhet.</p> <p>(f) Azbesti që është hequr nga vendi, nuk do të përdoret.</p>
	Menaxhimi i Mbetjeve Toksike / të rrezikshme	<p>(a) Depozitimi i përkoshëm i të gjitha substancave të rrezikshme në vendin e ndërtimit, duhet bërë në kontenierë të sigurt me etiketa që të tregojnë detaje të përbërjes, komponentëve dhe trajtimit.</p> <p>(b) Kontenierët e substancave të rrezikshme duhen vendosur në kontenierë me mbrojtje nga rrjedhja me qëllim që të mos lejohet derdhja dhe rrjedhja.</p> <p>(c) Mbetjet transportohen nga mjete të licencuara posacërisht dhe shkarkohen në një vend të licencuar.</p> <p>(d) Nuk duhet të përdoren bojra me përbërës apo solventë të rrezikshëm, ose me bazë plumbi.</p>
G. Dëmton pyjet dhe /ose zonat e mbrojtura	Mbrojtja	<p>(a) Të gjitha mjediset natyrore dhe zonat e mbrojtura përreth vendit, nuk do të dëmtohen apo të shfrytëzohen, për gjithë stafin do të ndalohet rreptësisht që të gjuajë, të kullojë bagëtinë, të presë dru apo të kryejë veprimtari të tjera dëmtuese.</p> <p>(b) Kur ndesheni me pemë të mëdha në afërsi të vendit të akivititetit, shënoni vendin dhe rrethojeni me kordon të madh, ruani sistemin e rrënjëve dhe shmangni cdo dëm që mund t'ju bëhet pemëve.</p> <p>(c) Duhet mbrojtur ligatinat dhe përrenjtë në afërsi të vendit të ndërtimit, nga rrëshkitjet e ndërtimeve, duke ngritur objekte që mbajnë nën kontroll erozionin dhe sedimentin, duke përfshirë por jo duke u kufizuar tek gardhet për depozitat dhe mullarët e barit.</p> <p>(d) Nuk do të lejohen gropa guroresh të palicencuara apo hedhje të mbetjeve në zonat e afërta, vecanërisht në zona që janë të mbrojtura.</p>

VEPRIMTARIA	PARAMETRI	ÇEKLISTA E MASAVE ZBUTESE
<p>H. Shkarkimi i mbetjeve mjekësore.</p>	<p>Infrastructura për menaxhimin e mbetjeve mjekësore</p>	<p>(a) Në përputhje me rregulloret kombëtare, kontraktuesi do të sigurohet që objektet e porsandëtuara dhe/ose të rehabilituara të qendrave shëndetësore të kenë infrastrukturë të mjaftueshme për trajtimin e mbetjeve mjekësore dhe shkarkimin e tyre. Kjo përfshin por nuk është e kufizuar tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Godina të vecanta për mbetjet e vecanta të kujdesit shëndetësor (duke përfshirë instrumenta të ndotura “pinceta”, dhe mbetje njerëzore ose lëngje) nga shkarkime të tjera mbetjesh; dhe ▪ Mjedise të përshtatshme shkarkimi të mbetjeve mjekësore dhe ▪ Në se veprimtaria përfshin trajtim në mjedis, të sigurohet që të ketë opsione të përshtatshme dhe operacionale për shkarkimin e tyre.
<p>I Kontrolli i trafikut dhe Mbrojtja e Këmbësorëve</p>	<p>Rreziqet e drejtpërdrejta ose indirekte për tradikun e publikut dhe të këmbësorëve nga veprimtaritë e ndërtimit.</p>	<p>(a) Në përputhje me rregulloret kombëtare, kontraktuesi duhet të sigurohet që vendi i ndërtimit të jetë i mbrojtur mirë dhe trafiku që ka lidhje me ndërtimin të jetë i kontrolluar mirë. Kjo përfshin por nuk është e kufizuar tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendosja e shenjave dhe tabelave të qarkullimit, shenja paralajmëruese, pengesa dhe shmangje të trafikut. Vendi i ndërtimit duhet të jetë qartësisht i dukshëm dhe publiku duhet të njoftohet për gjithë rreziqet e mundshme. ▪ Sistemi i menaxhimit të trafikut dhe trajnimi i stafit, vecanërisht për aksesin tek vendi i ndërtimit, dhe trafikun e ngarkuar pranë vendit të ndërtimit. Ofrimi i kalimeve të sigurta dhe rrugëve për këmbësorët aty ku ka ndërhyrje të trafikut për ndërtimet. ▪ Përshtatja e orëve të punës me modelet e trafikut lokal, p.sh. shmangja e veprimtarive të mëdha të transportit gjatë orëve të pikut të trafikut ose gjatë orëve të lëvizjeve të bagëtive. ▪ Menaxhim aktiv i trafikut nga staf i trajnuar dhe i dukshëm në vendin e punimeve, në se kërkohet për kalimin e sigurt dhe të përshtatshëm të publikut. ▪ Sigurimi i aksesit të vazhdueshëm dhe të sigurt për tek objektet e zyrës,, dyqanet, dhe rezidencat gjatë veprimtarive rinovuese, në se ndërtesat rrine hapur për publikun.

7.2 PLANI I MONITORIMIT

PJESA 3 : PLANI MONITORIMIT							
FAZA	CILI (A do të monitorohet parametri?)	KU (A do të monitorohet parametri ?)	SI (A do të monitorohet parametri ?)	KUR (Përcaktoni frekuencën / ose vazhdimësinë?)	PSE (A po monitorohet parametri?)	KOSTUA (në se nuk është e përfshirë në buxhetin e projektit)	KUSH (është përgjegjës për monitorimin?)
Gjatë përgatitjes së veprimtarisë	Lejët	Në vend	Duke kontrolluar në se i kanë të gjitha lejët e kërkuara nga ligji, në vendin e ndërtimit.	Para se të fillojnë veprat e ndërtimit	Rekomandohet që të sigurohet në se po aplikohen të gjitha praktikat e mira	Duhet të jetë pjesë e buxhetit të projektit	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit
	Organizimi i vendit	Në vend	Duke kontrolluar në se është bërë rrethimi i duhkur, instalimi i mjeteve të përkohshme sanitare.	Para se të fillojnë veprat e ndërtimit		Kontraktori është përgjegjës për koston totale, zakonisht kjo nuk identifikohet si kategori vecmas	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit
Gjatë zbatimit të veprimtarisë	Cilësia e ajrit (pluhuri)	Në vend	Vëzhgim Pamor	Në vazhdim por gjithsesi duhet kushtuar vëmendje e vecantë për ndjekjen e materialeve dhe të puneve të gjermimit	Mbajtja e nivelit të pluhurit në minimum me qëllim që të mbrohet shëndeti dhe të ruhen njerëzit nga acarimet e syve.	Kontraktori është përgjegjës për koston totale, zakonisht kjo nuk identifikohet si kategori vecmas	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit, Komuna
	Zhurma	Në vend dhe përreth	Zbulues i nivelit të tingujve	Në javën e parë të ndërtimit dhe	Të sigurohet që niveli i zhurmës	Kostua përballohet	Kontraktuesi, Inxhinieri

				pas cdo ankese nga popullata vendase.	është në nivel të pranueshëm ligjërisht	nga Kontraktuesi i Matjeve	mbikëqyrës i vendit
	Mbetjet (jo të rrezikshme dhe të rrezikshme të cilat mund të përfshijnë bojra, kimikate, patinime apo materiale ndërtimi që përmbajnë sa më sipër.)	Në vend	Dokumentacioni i cili shoqëron mbetjet i cili i paraqitet Ministrisë së Mjedisit për llojin dhe sasinë e mbetjeve të identifikuar.	Në vazhdimësi, d.m.th. sa herë që hiqen mbetjet na vendi.	Kërkohej nga një sërë rregulloresh mbi mbetjet.	Pjesë e praktikës së rregullt të kontraktuesit, mbulohej tërësisht nga kontraktuesi	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit Komuna, Ministria e Mjedisit (inspektimi)
	Objekte Arkitekturore	Në vend	Mbikëqyrje e plotë nga inspektori i vendit gjatë gjurmimeve.	Gjatë gjurmimeve për themelet	Të pengojë degradimin e objekteve të rëndësishme arkeologjike që mund të zbulohen.	Pjesë e inxhinierit mbikëqyrës dhe koston e kontraktuesit.	Inxhinieri mbikëqyrës i vendit Komuna, inspektimi
	Material toksik/i rrezikshëm	Në vend	Trajtimi i duhur dhe depozitimi kontrollohet sipas materialeve ISDS.	Në vazhdimësi	Të mos lejojë derdhjet aksidentale ose plagosjet	Pjesë e koston e rregullt të kontraktuesit	Koston për Inxhinierin mbikëqyrës, inspektimi
	Rreziku për trafikun publik dhe sigurinë e kembësoreve.	Ne sheshin e ndertimit dhe në rruget e lejueshme për t'u përdorur për të hyrë në sheshin e ndertimit.	Vëzhgim Pamor dhe ankesa të mundshme nga publiku	kontrolli i përditshëm i shenjave, gardheve dhe shenjave e modeleve sinjalizuese të trafikut.	Të ndalojë crregullimet në trafik dhe aksidentet	Pjesë e koston e rregullt të kontraktuesit	Koston për Inxhinierin Mbikëqyrës, inspektimi
	Masat	Në vend	Vëzhgim Pamor	Të kontrollojë	Të mos lejojë	Pjesë e koston	Koston për

	mbrojtëse për punëtorët			në vazhdimësi për përdorimin e pajisjeve të duhura.	aksidentet	së rregullt të kontraktuesit	Inxhinierin Mbikëqyrës , inspektimi
Gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë	Menaxhimi i mbetjeve (mbetjet bashkiake dhe kimikate të laboratorëve)	Mbetjet që shoqërojnë dokumentacionin që i paraqitet Ministrisë së Mjedisit	Pas raportimit mbi menaxhimin e mbetjeve në Ministrinë e Mjedisit	Në vazhdimësi gjatë veprimtarive	Kërkohej nga një sërë rregulloresh mbi mbetjet	Pjesë e kostos së rregullt të veprimtarive	Ministria e Mjedisit (inspektimi)

7.3 Kontrolli i punimeve të dheut

Paisjet laboratorike të fushës për kryerjen e vëzhgimit dhe testimit të dheut do të sigurohen ose nga Kontraktori ose nga institucione të tjera të kontraktuara nga Kontraktori dhe do të përfshijnë aparatet e vëzhgimit dhe testimit, të pranueshme për Inxhinierin, aq sa mund të jenë të nevojshme për gjetjen, trajtimin e testimin e kampioneve të marra.

Aparatet e tilla duhet të përfshijnë paisjet e nevojshme për të kryer testet e mëposhtme

- Analiza e madhësisë së grimcave të dheut
- Përcaktimi i lageshtësisë së dheut
- Testi i desnitetit në fushë
- Testi i treguesit të ngjeshjes
- Përkueshmëria dhe karakteristikat e dheut

Mbas përfundimit të instalimeve laboratorike, ose pas paraqitjes së të dhënave për institucionin që do të ndermarrë provat, operimi i aparateve të vëzhgimit dhe testimit do të tregojnë që përmbushen udhëzimet e Inxhinierit që qto janë të pershtatshme për qëllimin e menduar.

Kostoja e sigurimit të paisjeve dhe vendi i punës për gjetjen, trajtimin e kampioneve të dheut do të përfshihet në cmimin e ofertës në zërat respektive të dheut.

Mbas provave paraprake, numuri dhe tipi i të cilave do të jete sipas udhëzimeve të Inxhinierit me qëllim që të sigurohet që janë arritur rezultatet e kerkuara, do të kryhen testet sipas tipit dhe numurit të mëposhtëm.

Per mbushjen e ngjeshur ose për rimbushjen poshtë strukturave:

Ngjeshje me dore: nje prove densiteti ne fushe dhe nje test treguesi per cdo 50m³. Ngjeshje me rul: nje test per cdo 500 m³.

Ne test pershkueshmerie do behet ne laborator per cdo 10 prova densiteti ne fushe per skarpata dhe mbushjet.

Numuri i testeve te mesiperme mund te rritet, ose mund te kryhen edhe teste te tjera nqs kerkohet nga Inxhinieri.

Vendndodhja e testeve te fushes do te vendoset nga Inxhinieri dhe do te percaktohet nga Kontraktorit ne kuptimin e stacionit, pozicionin nga kanali, ose aksi i struktures dhe kuota ne lidhje me fundin.

8. Konsultimi me publikun dhe organet e qeverisjes vendore

Konsultimi me publikun do te behet sipas procedurave te percaktuara ne Ligjin shqiptar mbi VNM, siç eshte trajtuar me saktësi ne VKM Nr.994 date 02.07.2008 "Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimmarrje per mjedisin".

Konsultimet me grupet e interesit dhe me publikun do te kryhen ne rang sektori ose grup sektoresh ne varesi te llojit te tyre. Te dyja rastet do te perfshijne hartimin dhe zbatimin e nje sere masash per konsultimet te shtrira qe nga fillimi i aktivitetit/veprimit deri ne fund te tij. Kjo duhet gjithashtu te perfshije çdo procedure te kerkuar per fazen zbatuese veçanerisht ne lidhje me monitorimin e performances.

Konsultimet dhe pjesemarrja e publikut dhe grupeve te interesit do te realizohet nepermjet:

- 1) Informimit te publikut dhe grupeve te interesit mbi nje komponent, nenprojekt ose aktivitet perfshi aksesin ndaj te dhenave kryesore dhe treguesve ne kopje te shkruar ose elektronike;
- 2) Sigurimit te kushteve qe maksimizojne mundesite per te shprehur opinione dhe per te marre pjese ne procesin e vendim-marrjes nepermjet debateve publike dhe proceseve te tjera konsultuese:
 - a. takimeve publike
 - b. takimeve individuale me grupet e interesit
 - c. reklamave, njoftimeve, medias
- 3) marrjen ne konsiderate te çdo propozimi per permiresime si dhe rruget per ti realizuar ato;

Pergatitja dhe zbatimi i procesit te konsultimit do te perfshije hapat e meposhtme:

- identifikimi i grupeve te interesit dhe perfaqesuesve publik lokal sipas sugjerimeve te mesiperme;
- pergatitja e nje informacioni te thjeshte dhe te duhur mbi aktivitetin/veprimin me qellim qe ti paraqitet grupeve te interesit si dhe informacioni per publikun;
- facilitimi i evenimenteve;
- regjistrimi i informacionit dhe opinioneve si dhe marrja e keshillave.
- marrja ne konsiderate e informacionit te mesiperme ne finalizimin e projektit dhe operacioneve si dhe marreveshjeve te mirembajtjes etj.;
- koordinimi i tabelave/grafikeve per secilin prej hapave te mesiperme.

8.1. Berja Publike e Informacionit

Sipas legjislacionit shqiptar Bashkia Durres dhe Bashkia Kavaje, jane informuar nga propozuesi i projektit, per detajet e projektit dhe qellimin e tij. Propozuesi ka pregatitur nje informacion te thjeshte ne gjuhe jo teknike.

Eshte komunikuar dhe kontaktuar edhe me ARM- Durres e ARM Tirane cila ka:

- Siguruar nje program njoftimesh publike, takimesh dhe debatesh perfshi datat dhe vendndodhjet si pjese e nje Programi zyrtar Konsultimesh.
- Sigurohet se grupet e interesit jane njoftuar mbi programin e Konsultimeve perpara dates se organizimit te evenimentit te pare te programit dhe se informacioni ne lidhje me aktivitetin eshte dorezuar dhe eshte bere i disponueshem per tu marre dhe lexuar te pakten pes e dite perpara kesaj date.

Pergjegjesite e projektuesit, specialistit te licensuar mjedisor dhe/ose te kontraktorit do te jene:

- Te pergatisin ne kohen e duhur te gjitha informacionin qe lidhet me komponentin/nen-projektin/aktivitetin ne formen dhe sasi ne (numrin e kopjeve) e kerkuar nga ARM-ja.
- Te jene prezente se bashku me stafin teknik gjate gjitha evenimenteve te konsultimit.
- Te grumbullojne te gjitha verejtjet dhe sugjerimet e grupeve te interesit dhe publikut ne proces-verbalet e takimeve. .

ANKESI I

LIÇENCAT E EKSPERTEVE



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNATE SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit K81307011K
(NIPT)
2. Emri i Subjektit Arben Liçi
3. Te dhënat e identifikimit Subjektit
4. Vendi i ushtrimit te aktivitetit Tirane Tirane TIRANE Rruga Kajo Karafili, Pallati
Bimbashi, Shk.2, Kati II-te
5. Fusha e veprimtarisë Hartim raportesh te vleresimit te ndikimit ne mjedis,kryerje
auditimi mjedisor,hartim ekspertize per probleme te
ndryshme mjedisore,ekspert per te vleresuar raportet e
ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi mjedisor.
Projektim, instalime termoteknike te ngrohjes, ventilimit dhe
kondicionimit. Projektim i impjanteve te prodhimit dhe
shperndarjes te energjise elektrike nga burimet e energjise se
rinovueshme diellore, eres dhe hidro.
6. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit
7. Data e Regjistrimit 07/01/2008
8. Te dhëna njoftuar vullnetarisht Emri Tregtar: "ECA " STUDIO
Telefon: 0682090472
9. Statusi Aktiv

Datë: 08-08-2014


Emri, Mbiemri
(i nëpunësit të sportelit)



LICENCË

LN-6137-02-2013	NUIS/NIPT: K81307011K
Subjekti: Arben Liçi	
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga "Kajo Karafili", Pallati Bimbashi, Shkalla 2, Kati II-të.	
Kodi: III.2.A (1+2)	
Data e lëshimit: 12/02/2013	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose konsultime me ndikim në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis: Hartim i raporteve të ndikimit në mjedis, kryerje e auditimit mjedisor; Hartimi i ekspertizave mjedisore; Thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të V.N.M. dhe rezultatet e një auditimi mjedisor.

Kufizime specifike
Kufizime të cilat ushtrohet sipas kufizimeve në legjislativonin në fuqi

Detyrime specifike


Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativonin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Handwritten signature: Arben Liçi

Handwritten signature: Dajana Stoja



Nënskrimi i sportelit: Dajana Stoja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Rruga "Durrësi", Nr. 27, Tiranë, Tel. 04 224 572 Fax. 04 270 627 www.moe.gov.al

Nr. 675 Prot.

Tiranë, më 30.10.2006



Vendim nr. 9, Nr. 237 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

"Arben LIÇI"

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

L. Xhuvelli
Lufter XHUVELLI




*Për projektin "Hespelet Lokale"
 Propozim*

ANKESI II

PLANIMETRI TE UJESJELLESIT

PLANIMETRIA E PERGJITHSHME E LINJES SE UJESJELLESIT


St.P CERME deri takim me Ujesjellsin e pare nga puset RROGOZHINE



INVESTITORI:		D. P. U. K.	
RESHIKUAR	DATA	TITULLI I PROJEKTI:	NGA
H U K Consulting Engineers		FURNIZIMI ME UJE I PLAZHEVE DURRES - KAVAJE NGA PUS SHPIMET ÇERME LOTI 1 (Dublimi i puseve ekzistues, rikonstruksioni i stacionit qendror dhe ndertimi i rezervuarit, linja puse-stacion, linja stacion Çerme-Rrogozhine pik.426, rikonstruksion i linjave elektrike)	PROJEKTI NO.: Shkalla
Adresa: Bulevardi ZOGU I P-58, H.2, Ad.9 Tel: 4 2420 288 Fax: 4 2419 718 e-mail: hukprojekt@yahoo.com		Titulli i Vizatimit: PLANIMETRIA E PERGJITHSHME E LINJES SE UJESJELLESIT ST.QENDROR deri autostrade	DATA: 2012 Projektor: V.HICKA
		Faza: Projekt Zbatim	Kontrollor: Vizatimi: U-31



32



INVESTITORI:

D. P. U. K.

RISHIKUAR	DATA	NGA
HUK Consulting Engineers	TITULLI I PROJEKTIT: FURNIZIMI ME UJE I PLAZHEVE DURRES - KAVAJE NGA PUSHPIMET ÇERME LOTI 1 (Dublimi i puseve ekzistues, rikonstrukcion i stacionit qendror dhe ndertimi i rezervuarit, linjat puse-stacin, linja stacion Çerme-Rrogozhine pik.426, rikonstrukcion i linjave elektrike)	PROJEKTI NO.: Shkalla
Adresa: Bulevardi ZOGU I P 58 H 2 AP 9 Tel: 4 2420 288 Fax: 4 2419 718 e-mail: hukprojekt@yahoo.com	Titulli i Vizatimit: LINJA E UJESJELLSIT HARTA e Zones	DATA: 2012 Projektoi: V.HICKA
	Faza: Projekt Zbatim	Kontrolli: Vizatimi: U-04



SKEMA E UJESJELLSIT NGA PUSËT ÇERME

INVESTITORI: D. P. U. K.

RISHIKUAR	DATA	TITULLI I PROJEKTIT:	NGA
H U K Consulting Engineers		FURNIZIMI ME UJE I PLAZHEVE DURRES - KAVAJE NGA PUSHPIMET ÇERME LOTI 1 (Dublimi i puseve ekzistues, rikonstruksion i stacionit qendror dhe nertimi i rezervuarit, linjat puse-stacion, linja stacion Çerme-Rrogozhine pik 426, rikonstruksion i linjave elektrike)	PROJEKTI NO.: Shkalla
Adresa: Bulevardi ZOGU I P 58 H 2 AP 9 Tel: 4 2420 288 Fax: 4 2419 718 E-mail: hukprojekt@yahoo.com		Titulli i Vizatimit: SKEMA E UJESJELLSIT ME PUS NDERPRERJE KAVAJE	DATA: 2012 Projektoli: V.HICKA Kontrolloji: Vizatimi: U-05
		Faza: Projekt Zbatim	



SHPJEGUES

popullsia 2008-2028 34000 -62 000 banore
Nevojat per uje Vere 2008- Vere 2028 130-210 l/s

Burimet e sotme Kavaje -Plepa Durres jane:

1. Pusët Kavaje 50l/s
2. Impjanti i Makurse 70l/s

Burimet e prespektives 20 vjecare (2009-2028) Kavaje -Plepa Durres jane:

1. Pusët Kavaje 50l/s
2. Impjanti i Makurse 70l/s
3. Pusët e Cermes 250 l/s

Nevojat per uje Kavaje -Plepa Durres Periudha e Veres


Nevojat e sotme ne periudhen e veres jane 365 l/s
Nevojat e prespektives ne periudhen e veres jane 510 l/s

Nevojat per uje Kavaje -Plepa Durres Periudha e Dimrit

Nevojat e sotme ne periudhen e Dimrit jane 100 l/s
Nevojat e prespektives ne periudhen e Dimrit jane 155 l/s

Konkluzion:

Ne kohën e Dimrit, tani për tani mund të kohet me drejtim të Durresit rreth 150-200 l/s. Eshtë kjo një nga arsyet që po ndërtohet edhe depo e re në Arapaj e cila parvazohet nga ky fakt është mese e domosdoshme



----- LOTI 1
———— LOTI 2 DHE 3

LOTI 1 - Pusët CERME deri takim me LOTIN 2

L=1590ml

5 Puse cpimi

$H_p = H_{gj} + \Delta h_{gjat} + \Delta h_{pompes}$
 $H_p = (102-12) + 56.2 + 5 = 151$
 $N = 250 \text{ l/s} * 151 \text{ m} / 102 * 0.8 = 400 \text{ kw}$

PLAN VENDOSJA E PASARELES

Pik.426/1

12.30

PROGRESIVA 1592 ML
 LOTI 2
 LOTI 1

Pik.34

12.32

PASARELA

Koordinatat e aksit ne veri X-48314.45 , Y-84381.00

80.00

179.15

Koordinatat e aksit ne JUG X-48255 , Y-84331

AKSI I PASARELES
 121.76

172°

RRUGE QE ZBRET NE LUM

LUMI SHKUMBIN

ARGJINATURA

RRUGA

Pik.19

10.73

108.29

Pik.17 (PUS SHKARKIMI)

9.83

Pik.18

10.66

Pik.16

10.68

kanal

112.3

INVESTITORI:
 D. P. U. K.



RISHIKUAR	DATA	NGA
H U K Consulting Engineers		PROJEKTI NO.:
Adresa: Bulevardi ZOGU I P-58, H.2, Ap.9 Tel: 4 2420 288 Fax: 4 2419 718 e-mail: hukprojekt@yahoo.com	TITULLI I PROJEKTI: FURNIZIMI ME UJE I PLAZHEVE DURRES - KAVAJE NGA PUS SHPIMET ÇERME LOTI 1 (Dublimi i puseve ekzistues, rikonstruksioni i stacionit qendror dhe ndertimi i rezervuarit, linja puse-stacion, linja stacion Çerme-Rrogzihine pik.426, rikonstruksion i linjave elektrike)	Shkalla:1-500 DATA: 2012 Projektor: V.HICKA Kontrolloi: Vizatimi:U-38/1
	Titulli i Vizatimit: PLAN VENDOSJA E PASARELES	
	Faza: Projekt Zbatim	